



**Gjykata e Posaçme
e Shkallës së Parë për Korrupsionin
dhe Krimin e Organizuar**

ANALIZA VJETORE 2024



**Gjykata e Posaçme
e Shkallës së Parë për Korrupsionin
dhe Krimin e Organizuar**

ANALIZA VJETORE E PUNËS 2024

PËRMBAJTJA

I. HYRJE 5

 A. FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE PËR TË GJITHA INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT PARTNERE..... 6

 B. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE..... 8

 C. METODOLOGJIA..... 11

II. STRUKTURA ORGANIKE E GJKKO..... 13

III. VEPRIMTARIA GJYQËSORE 15

 1. BURIMET NJERËZORE 15

 2. MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE..... 16

 3. TREGUESIT E EFIÇENCËS 21

IV. VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE 51

 1. VEPRIMTARIA E ORGANEVE DREJTUESE 51

 1. MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E GJYQTARËVE 51

 2. KËSHILLI I GJYKATËS 52

 3. KRYETARI..... 63

 4. KANCELARI..... 65

 2. VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE..... 67

 1. KRYESEKRETARIA 67

 2. DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR..... 71

 3. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE..... 82

 4. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË..... 86

 5. SEKTORI I PROTOKOLL/ARKIVËS..... 100

V. AKTIVITETE BRENDË DHE JASHTË VENDIT 103

VI. OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME 112

SHKURTIME

- GJKKO – Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- GJAKKO – Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
- KLGJ – Këshilli i Lartë Gjyqësor
- SPAK – Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
- BKH – Byroja Kombëtare e Hetimit
- KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- OPDAT - Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training
- OSBE - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
- ASHSGJ – Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
- K. Pr. Penale – Kodi i Procedurës Penale
- ER – Rendimenti mesatar
- WR - Ngarkesa mesatare për gjyqtar
- CR - norma e likuidimit të çështjeve
- DT - koha mesatare për zgjidhjen e një çështjeje
- MD – Ministria e Drejtësisë

I. HYRJE

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe në kuadër të detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë nga instrumentet ndërkombëtar të ratifikuar, konkretisht neni 20 i Konventës Penale për Korrupsionin¹, neni 36 i Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit², si dhe neni 9 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj³, për krijimin e institucioneve të pavarura e të specializuara, me ndryshimet kushtetuese të bëra me Ligjin Nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, (të ndryshuar), janë parashikuar institucionet për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar ku bën pjesë dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Pra, Kushtetuta i ka dhënë kësaj Gjykate një personalitet juridik kushtetues, duke i njohur kompetencën kushtetuese për gjykimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar si dhe të akuzave penale ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit.⁴ Gjithashtu, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar organizohet dhe funksionon për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë,⁵ me seli në Tiranë⁶ duke filluar detyrën më datë 19 dhjetor 2019.⁷

Kjo gjykatë ka si mision themelor garantimin e funksionimit të drejtësisë, duke mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe duke siguruar zbatimin e ligjit për të gjithë qytetarët, pa dallim. Ajo ushtron funksionin e saj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë⁸, legjislacionin në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të një procesi të rregullt ligjor, veçanërisht, siç përcaktohet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁹, duke garantuar barazinë e palëve para ligjit dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të individit.

Objektivi i punës së gjykatës është zhvillimi i proceseve gjyqësore në mënyrë të paanshme, profesionale dhe transparente, si dhe shqyrtimi i çdo çështjeje brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin procedural penal, duke shmangur vonesat e panevojshme dhe duke

¹ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8778, datë 26.04.2001.
² Ratifikuar me Ligjin Nr. 9492, datë 13.03.2006.
³ Ratifikuar me Ligjin Nr. Nr. 8920, datë 11.7.2002
⁴Në nenin 135, pika 2 të Kushtetutës parashikohet se: “Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë 36 të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur”.
⁵ Shiko nenin 11 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
⁶Shiko nenin 10, pika 1 i ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.
⁷ Shiko vendimin Nr. 286, datë 18.12.2019 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
⁸ Shiko nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
⁹ Shiko nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

garantuar përfundimin e çështjeve në një kohë të arsyeshme, ashtu siç kërkohet edhe nga praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në përmbushje të misionit dhe objektivit të saj, Gjykata i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe krijimit të kushteve optimale për punonjësit e administratës gjyqësore, duke garantuar një mjedis pune të sigurt, të motivuar dhe profesional. Përmes përmirësimit të infrastrukturës, trajnimeve të vazhdueshme dhe qartësimit të procedurave të brendshme, është synuar rritja e efektivitetit të punës dhe përmbushja e objektivave institucionale në mënyrë të koordinuar dhe efikase. Administrata gjyqësore konsiderohet një hallkë thelbësore për funksionimin normal dhe cilësor të Gjykatës, ndaj mbështetja e vazhdueshme e këtij stafi mbetet prioritet i pandashëm në veprimtarinë e institucionit.

GJKKO mbetet e përkushtuar që, përmes profesionalizmit dhe integritetit, të ruajë besimin e publikut, të garantojë një proces gjyqësor të drejtë dhe efektiv, si dhe të sigurojë mbrojtjen e interesit publik, duke u bërë një model i mirëfunksionimit të drejtësisë në vend.

Hartimi i kësaj analize vjetore, përveçse një detyrim ligjor që buron nga ligji dhe aktet nën ligjore, është një obligim moral ndaj qytetarëve shqiptarë dhe partnerëve ndërkombëtarë që kanë mbështetur Reformën në Drejtësi. Për këtë arsye, hartimi i kësaj analize vjetore, nuk është vetëm për afirmimin e arritjeve, por më shumë se kurrë, të përgjegjësisë për llogaridhënie, transparencës, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, rritjes së aksesit të publikut, por edhe pavarësisë, profesionalizimit dhe integritetit të gjykatës.

A. FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE PËR TË GJITHA INSTITUCIONET DHE ORGANIZATAT PARTNERE

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO) shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin më të lartë për të gjitha institucionet dhe organizatat partnere që kanë kontribuar në veprimtarinë e kësaj gjykate dhe në mbështetjen e reformave në drejtësi. Mbështetja e vazhdueshme nga partnerët tanë vendorë dhe ndërkombëtarë ka qenë një shtysë e rëndësishme në përmirësimin e profesionalizmit, transparencës dhe efektivitetit të punës në këtë gjykatë, duke ndihmuar në fuqizimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri.

▪ Këshillit të Lartë Gjyqësor

Një falënderim i veçantë i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kryesor për administrimin dhe organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Roli i KLGJ-së ka qenë thelbësor në mbështetjen e GJKKO-së përmes garantimit të pavarësisë së saj institucionale, mbështetjes financiare, infrastrukturore dhe logjistike.

GJKKO vlerëson përpjekjet e KLGJ-së për të përmirësuar sistemin gjyqësor nëpërmjet reformave të rëndësishme që synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe besimit të publikut tek drejtësia. Mbështetja e KLGJ-së ka qenë e rëndësishme në përmirësimin e

cilësisë së shërbimit të drejtësisë për qytetarët dhe në rritjen e besimit të publikut tek institucionet gjyqësore.

Falënderojmë KLGJ-në për mbështetjen e vazhdueshme në përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve të kualifikuar në këtë gjykatë dhe për mundësimin e trajnimeve të vazhdueshme për zhvillimin profesional të tyre, mbështetjen financiare të nevojshme për funksionimin optimal të gjykatës dhe për përmbushjen e misionit të saj institucional, përmirësimin e infrastrukturës, duke mundësuar kushte të përshtatshme dhe moderne pune, si dhe duke siguruar mbështetjen logjistike të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit gjyqësor, ku përfshihet edhe sigurimi i mjeteve të transportit individual për gjyqtarët.

▪ Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri

Një tjetër falënderim i veçantë i drejtohet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri dhe të Ngarkuarës me Punë, znj. Nancy VanHorn, për mbështetjen e vazhdueshme dhe angazhimin e palëkundur në forcimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Roli i SHBA-së ka qenë dhe mbetet i pazëvendësueshëm në procesin e reformës në drejtësi dhe në garantimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, të ndershëm dhe efikas. Përmes asistencës së ofruar, Ambasada e SHBA-së ka ndihmuar në zhvillimin e institucioneve të reja të drejtësisë dhe në forcimin e mekanizmave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

▪ Programit OPDAT (Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training) të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës

GJKKO shpreh gjithashtu mirënjohje të veçantë ndaj Programit OPDAT, i cili ka luajtur një rol kyç në mbështetjen e reformës në drejtësi, duke ofruar asistencë të vazhdueshme me qëllim rritjen e efektivitetit të sistemit tonë gjyqësor.

GJKKO falenderon në mënyrë të veçantë OPDAT për organizimin e vizitës studimore në shtator 2024, në Distriktet Utah dhe Kolorado të SHBA-së për 9 (nëntë) gjyqtarët të GJKKO-së. Kjo vizitë ka qenë një mundësi e çmuar për të njohur më nga afër praktikat më të mira të sistemit të drejtësisë amerikan në trajtimin e çështjeve gjyqësore penale. Përmes takimeve me gjyqtarë, prokurorë dhe ekspertë të drejtësisë në këto distrikte, gjyqtarët shqiptarë kanë përfituar një eksperiencë të vlefshme që do të ndihmojë në rritjen e profesionalizmit dhe integritetit të tyre në ushtrimin e detyrës.

Mbështetja e OPDAT ka qenë thelbësore në modernizimin dhe zhvillimin e sistemit të drejtësisë shqiptare, duke e afruar atë me standardet më të larta ndërkombëtare. GJKKO vlerëson përkushtimin dhe mbështetjen e Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së dhe OPDAT për përmirësimin e funksionimit të sistemit tonë gjyqësor dhe thekson rëndësinë e vazhdimit të këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

▪ **Prezencës së OSBE-së në Shqipëri (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë)**

GJKKO shpreh mirënjohjen e saj për prezencën e OSBE-së në Shqipëri për mbështetjen e vazhdueshme dhe kontributin e dhënë në rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve të kësaj gjykate. Në veçanti, dëshirojmë të falenderojmë prezencën e OSBE-së në Shqipëri për organizimin dhe mundësimin e trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të gjyqtarëve në gjykimin e çështjeve komplekse. Këto iniciativa kanë ndihmuar në rritjen e standardeve të profesionalizmit, duke përfunduar më tej angazhimin e kësaj gjykate për sundimin e ligjit.

Përveç sa më sipër, GJKKO shpreh falenderime për të gjitha institucionet dhe partnerët e tjerë, brenda dhe jashtë vendit që kanë mbështetur veprimtarinë e kësaj gjykate. Kontributi dhe mbështetja e këtyre aktorëve ka qenë dhe mbetet e paçmueshme për misionin tonë të përbashkët për një sistem drejtësie të pavarur, transparent dhe të drejtë, duke ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë për të gjithë qytetarët shqiptarë.

B. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë analizë vjetore për vitin 2024, do të shqyrtojmë progresin e arritur, sfidat dhe arritjet e kësaj gjykate në trajtimin e çështjeve që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe do të paraqesim rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të funksionimit të saj.

Më poshtë paraqesim një përmbledhje të kësaj analize:

Veprimtaria gjyqësore:

Ky kapitull pasqyron gjendjen aktuale lidhur me punën e gjykatës. GJKKO e ka nisur punën në janar 2024 me 126 çështje në pritje të gjykimit (backlog), 26 çështje më pak, krahasuar me backlog-un në fillim të vitit 2023. Në gjykatë janë regjistruar 3459 çështje të reja, 684 ose 20% çështje më shumë krahasuar me vitin paraardhës. Rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve në vitin 2024, me gjithë rritjen e numrit të çështjeve në krahasim me vitin paraardhës, ka ruajtur tërësinë e treguesve të efikasitetit në gjykatë: ngarkesa mesatare për gjyqtar (WR) është 326 çështje; rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) është 310.5 çështje; norma e likuidimit të çështjeve (CR) është 99%; koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) e përgjithshme është 18 ditë. Në fund të vitit raportues 2024, në këtë gjykatë mbeten në pritje për t'u shqyrtuar 169 çështje, nga 126 që ishin në vitin 2023.

Çështjet e paraqitura në gjykatë, kohëzgjatja dhe statistika mbi ankimin: Në këtë pjesë të analizës janë paraqitur në formë tabelore dhe grafike të dhëna të detajuara për vitin 2024 mbi: numrin e çështjeve të gjykuara nga GJKKO, statistika mbi shpejtësinë e përfundimit të çështjeve penale, treguesit statistikorë sipas Bashkimit Evropian, volumi i çështjeve gjyqësore sipas secilit gjyqtar të GJKKO, volumi i çështjeve penale të reja dhe hetimeve paraprake, masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, analiza e masave të sigurimit të vendosura nga GJKKO ndër vite, analiza e seancave paraprake, detajimi i mënyrës së

përfundimit të çështjeve penale, detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale për numrin e personave të gjykuar për fajësi dhe pafajësi, detajimi i pafajësisë për personat e gjykuar në përfundim të çështjeve penale për vitin 2023 dhe 2024, detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale me gjykim të shkurtuar, lidhur me aplikimin e dënimeve alternative, detajimi i gjykimit të pandehurve për vitin 2024 sipas akuzave, neneve të Kodit Penal, detajimi i masave të dënimit të dhëna nga gjykata, detajimi i dënimeve të dhëna sipas gjinisë në %, çështje penale të regjistruara gjithsej sipas dispozitave përkatëse penale, disa prej çështjeve penale sipas llojit të vendimit, tabelat e cilësisë së gjykimit të çështjeve të gjykuara në apel, tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2019 nga ish Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2020-2024 nga GJKKO, tabelat e përmbledhura të vendimeve të sekuestrove dhe konfiskimeve, çështje të trajtuara në vitet 2023-2024 nga GJKKO në kuadër të ligjit antimafia, konfiskime sipas vendimeve të themelit, bazuar në nenet 36/1, shkronja “b” të K.Penal dhe në nenin 190/1, shkronja “a” të K.Pr.Penale përgjatë vitit 2024, sekuestro preventive.

Veprimtaria Administrative

Veprimtaria e organeve drejtuese: Kjo pjesë e analizës paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë e organeve drejtuese, duke parashtruar veprimtarinë e realizuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve, Këshilli i Gjykatës, Kryetari dhe Kancelari, si strukturat të cilët kanë pasur një rol kyç në menaxhimin dhe administrimin e veprimtarisë gjyqësore, duke siguruar funksionimin efikas dhe të organizuar të strukturave administrative të gjykatës.

Kryesekretaria: Gjatë këtij viti Kryesekretaria në bashkëpunim me sekretarinë gjyqësore kanë përballuar një ngarkesë të madhe pune krahasuar me gjithë vitet e tjera, gjë që vërehet nga statistikatat e çështjeve të ardhura për gjykim, kërkesave penale të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe kërkesat e tjera të paraqitura nga palët e tjera në proces, kërkesa që rezultojnë në rritje të dukshme krahasimisht me vitet e kaluara, si dhe nga natyra e zhvillimit të seancave gjyqësore me shume të pandehur dhe shumë akuza. Kryesekretaria ka siguruar raportimin dhe informimin në kohë të gjyqtarit/trupës gjyqësore në lidhje me aspekte që kanë të bëjnë me gjykimin e çështjes si dhe ka ndihmuar në lehtësimin e komunikimit midis aktorëve proceduralë, për marrje-dhënien e informacioneve të lejuara, duke vepruar si një ndërlidhës kyç midis trupës gjyqësore, përfaqësuesve ligjorë, palëve në proces, personave të interesuar etj.

Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar: Kjo drejtori ka pasqyruar në mënyrë të detajuar Raportin Financiar për vitin 2024. Buxheti i miratuar me vendimin nr. 743, datë 28.12.2023 “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për Sistemin Gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitin 2024 ka qenë në shumën 259,600 mijë lekë. Gjatë vitit 2024, në buxhetin e Gjykatës, sipas kërkesave të paraqitura nga vetë Gjykata janë bërë ndryshimet përkatëse. Në këtë kapitull janë paraqitur në formë grafike dhe tabelore fondet buxhetore të gjykatës, të rishikuara së bashku me realizimin e tyre 12-mujor, sipas grup shpenzimeve, analiza e shpenzimeve, situata buxhetore e gjykatës për tre vitet e fundit, të ardhurat dhe

nevojat buxhetore. Përgjatë vitit 2024, kjo drejtori ka ndërmarrë masa për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe optimizimin e burimeve, duke ndikuar pozitivisht në realizimin e objektivave institucionale të gjykatës.

Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve: Gjatë vitit 2024, ky sektor ka arritur me sukses një sërë objektivash të rëndësishëm, të përcaktuar në funksion të nevojave institucionale për këtë periudhë. Këto përfshijnë objektiva afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, ndër të cilat veçohen: Rritja e cilësisë dhe transparencës në proceset e rekrutimit dhe përzgjedhjes së stafit të administratës gjyqësore dhe mbështetës, duke garantuar meritokraci; hartimi dhe zbatimi i mekanizmave për promovimin e etikës dhe ndërgjegjësimin mbi standardet profesionale; përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe logjistike për mbështetjen e punës së përditshme; zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin e riskut dhe sigurisë, si dhe rritja e transparencës dhe efijencës në procedurat e prokurimit.

Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë: Ky sektor ka mirëmbajtur dhe përditësuar në mënyrë të vazhdueshme infrastrukturën teknologjike, përfshirë sistemin ARKIT për menaxhimin e çështjeve, sistemet e sigurisë dhe të aksesit në GJKKO. Në bashkëpunim me KLGJ-në (firmës së kontraktuar për rinovimin dhe mirëmbajtjen e programit), është realizuar në fund të vitit kalendarik 2024 integrimi me portalin e Gjykatave, www.gjykata.gov.al, shfaqja e informacionit të nevojshëm për rritjen e transparencës ndaj publikut dhe medias, duke ofruar shkarkimin e Vendimeve të Themelit në format PDF drejtpërdrejtë nga portali. Nëpërmjet këtij sektori Gjykata ka vijuar angazhimin për transparencë dhe komunikim të hapur me publikun dhe median, duke intensifikuar punën në drejtim të rritjes së transparencës përkundrejt mediave dhe publikut dhe përmirësuar mekanizmat e shpërndarjes së informacionit përmes publikimit në kohë reale, në faqen zyrtare të Gjykatës, në rubrikën “*Njoftime për mediat*” të të gjitha njoftimeve mbi vendimet e shpallura, publikimit të vendimeve të themelit të dhëna nga gjykata për vitin 2024, të plota, në zbatim të “Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median” dhe krijimit të një grupi të dedikuar komunikimi me mediat në rrjetin social “*WhatsApp*”. Po ashtu, raportet statistikore 3 mujore, vjetore dhe *ad hoc* janë raportuar në KLGJ dhe në Ministrinë e Drejtësisë, në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e këtyre dy të fundit, në bazë të të cilave është përpiluar më pas dhe analiza vjetore e punës së gjykatës.

Sektori i Protokoll Arkivës: Një nga përparësitë e punës në këtë sektor ka qenë lirimi i hapësirave të ambienteve të Arkivit të GJKKO-së. Për këtë vit u morën masat e nevojshme që të punësoheshin punonjës mbështetës me kontratë të përkohshme, të cilët kanë ofruar ndihmesën e tyre për përpunimin tekniko-shkencor dhe inventarizimin e dosjeve gjyqësore të fondit arkivor të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Një nga arritjet e sektorit është se, për herë të parë në bashkëpunim me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, kjo gjykatë dorëzoi fondin arkivor të dosjeve gjyqësore të themelit për periudhën 2004-2007, duke mbyllur me sukses një nga proceset më të vështira të punës me përkushtim dhe

profesionalizëm. Gjatë këtij viti janë përgatitur vëllimet penale për vitet 2012-2022 sipas çdo njësie dosje, jo vetëm duke i hedhur në mënyrë kronologjike në inventarë elektronikë por edhe duke i sistemuar në kuti arkivore. Po ashtu, është krijuar edhe regjistri elektronik i këtyre vendimeve në të cilin do të evidentohen afatet e asgjësimit të dosjeve gjyqësore.

Aktivite brenda dhe Jashtë Vendit: Në këtë kapitull paraqiten në mënyrë të përmbledhur disa nga aktivitetet kryesore të realizuara nga GJKKO, si dhe pjesëmarrjet e saj në aktivitete të ndryshme, si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë vendit. Përshkrimi i këtyre aktiviteteve shoqërohet me material ilustrues, përkatësisht fotografi të realizuara gjatë zhvillimit të tyre.

Objektivat dhe Rekomandimet: Në këtë kapitull janë përcaktuar objektiva të qarta për përmirësimin e performancës institucionale. Prioritet mbetet rritja e cilësisë dhe profesionalizmit në funksion të dhënies së drejtësisë, rritja e efektivitetit të proceseve gjyqësore, përmirësimi i aksesit të publikut dhe medias, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me institucionet e drejtësisë dhe partnerët ndërkombëtarë. Rekomandimet kryesore për zbatimin e këtyre objektivave përfshijnë rritjen e bashkëpunimit me KLGJ-në për plotësimin e pozicioneve vakante për gjyqtarë sipas organikës, rritjen e bashkëpunimit me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, lidhur me çështje të trajnimit të administratës gjyqësore dhe çështje të tjera, angazhimin e punonjësve të trajnuar dhe eksperteve të jashtëm për ato çështje ku vlerësohet e nevojshme, paraqitjen e raporteve periodike KLGJ-së, si dhe kërkesa kësaj të fundit në lidhje me problematikat që kërkojnë ndërhyrjen e KLGJ-së për zgjidhjen e situatave.

C. METODOLOGJIA

Analiza vjetore i jep mundësi lexuesit që të njihet në mënyrë të plotë dhe shteruese me veprimtarinë e GJKKO përgjatë vitit 2024 si nga pikëpamja cilësore ashtu dhe sasiore. Një vëmendje e dedikuar në raport i kushtohet analizës statistikore të indikatorëve të performancës së GJKKO, mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare, çertifikuar nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).


Metodologjia e përdorur në hartimin e kësaj analize dhe përpunimin e të dhënave është mbështetur në Udhëzuesin “*Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave*”, miratuar me vendimin nr. 47, datë 11.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky udhëzues përbën një instrument standardizues për mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave statistikore gjyqësore, duke mundësuar një analizë të strukturuar, të krahasueshme dhe të matshme të veprimtarisë së gjykatës.

Në këtë kuadër, statistikat gjyqësore sipas këtij udhëzimi kanë për qëllim të shërbejnë si burime të dhënash dhe informacioni që mund të përdoren për **menaxhimin efijent, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në aktivitetin e gjykatës**. Të dhënat statistikore pjesë

e tabelave standarde, synojnë të japin informacion gjithëpërfshirës për matjen e treguesve të produktivitetit dhe efijensës. Pra, metodologjia CEPEJ e përkthyer në vendimin 47, datë 11.02.2021 të KLGJ-së, përpunon disa indikatorë apo tregues bazë të funksionimit të gjykatës, të tillë si: (i) Ngarkesën e punës në secilën gjykatë; (ii) Gjendjen e backlog-ut në gjykatë; (iii) Prurjet e çështjeve të reja në gjykatë; (iv) Ngarkesën mesatare të gjyqtarëve (Treguesi WR); (v) Normën e efijencës (Treguesi ER); (vi) Raportin e qarkullimit të çështjeve (Treguesi RQC); (vii) Kohën e nevojshme për përfundimin e çështjes (Treguesi DT); (viii) Normën e zgjidhjes së çështjes (Treguesi CR); (ix) Vjetërsinë (moshën) e çështjes etj.¹⁰

¹⁰ Shiko Raportin Vjetor 2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, faqe 30.

A. STRUKTURA ORGANIKE E GJKKO
ORGANIGRAMA



Struktura Organizative

Nr.	Funksioni	Numri organik	Kategoria e pagës
1	Kryetar	1	G-2/Ib
2	Zv/Kryetar	1	G-2/Ib
3	Gjyqtarë	14	G-2/Ib
4	Kancelar	1	I-4
Shërbime Gjyqësore		22	-
5	Kryesekretar	1	III-1
6	Sekretar gjyqësor	17	IV-1
7	Specialist i Shërbimeve Gjyqësore	4	IV-1
Shërbime Administrative		10	-
Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar		3	-
8	Drejtor Drejtorie	1	II-1
9	Specialist Buxheti/Finance	1	IV-1
10	Magazinier	1	V
Sektori i IT, Statistikë dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median		4	-
11	Shef Sektori	1	III-1
12	Specialist IT	1	IV-1
13	Specialist Statistike	1	IV-1
14	Specialist Marrëdhënieve me Publikun dhe Median	1	IV-1
Sektori i Protokoll/Arkive		3	-
15	Shef Sektori	1	III-1
16	Specialist Protokolli	1	IV-1
17	Specialist Arkive	1	IV-1
Shërbime Mbështetëse		16	-
Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve		16	-
18	Shef Sektori	1	III-1
19	Specialist Burime Njerëzore/Prokurime	1	IV-1
20	Specialist S.SH.M.	3	IV-1
21	Punonjës i shërbimit të njoftimeve (Ftues)	1	III
22	Shofer Titullari	1	IV
23	Shofer	4	III
24	Punonjës i shërbimit të sigurisë	1	III
25	Mirëmbajtës	1	III
26	Sanitar	3	I
TOTALI		65	-

Sipas strukturës organizative të miratuar të GJKKO-së për vitin 2024 numri total i punonjësve është 65, ku 16 janë gjyqtarë¹¹ dhe 49 janë punonjës administrativ. Ndërkohë që numri i punonjësve efektivisht në detyrë është 11 gjyqtarë dhe 47 punonjës administrativ.

¹¹ Shiko nenin 15 pika 4, gemra “c” të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.

B. VEPRIMTARIA GJYQËSORE

Sikurse u theksua më lart, analiza statistikore e veprimtarisë gjyqësore e realizuar në mënyrë vjetore nga GJKKO në bazë të metodologjisë së CEPEJ-it, përpunon dhe analizon 5 indikatorë apo tregues të funksionimit të gjykatës, të tillë si ngarkesa mesatare për gjyqtar (treguesi WR), rendimenti mesatar për gjyqtar (treguesi ER), norma e zgjidhjes së çështjeve (treguesi CR), raporti i qarkullimit të çështjeve (treguesi RQC) dhe koha e nevojshme për evadimin e çështjeve (treguesi DT), mund të identifikohen më mirë sfidat dhe mundësitë për përmirësim në veprimtarinë e Gjykatës.

1. BURIMET NJERËZORE

Burimet njerëzore sipas CEPEJ-it llogariten mbi bazën e kontributit real dhe konkret të çdo gjyqtari.

Situata e burimeve njerëzore gjatë vitit 2024 paraqitet në tabelë, ku vihet re se Gjykata ka funksionuar me 69% të organikës së gjyqtarëve (13% më tepër se viti paraardhës) dhe me 96% të organikës së stafit mbështetës (2% më tepër se viti paraardhës). Raporti staf mbështetës për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë është 4.3. Ky raport është ulur krahasuar me një vit më parë për shkak të rritjes së numrit të gjyqtarëve në këtë gjykatë. Por krahasuar me raportin e planifikuar në organikë, ku një gjyqtar asistohet mesatarisht nga 4.3 (1 staf efektiv më pak se viti paraardhës) ky raport është më i lartë.

Situata tërësore e burimeve njerëzore për vitin 2024 paraqitet si vijon në tabelë:

Nr. Gjyqtar sipas dekretit	Nr. gjyqtar efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. Staf mbështetës sipas organikës	Nr. staf mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës/ gjyqtar organikë	Staf mbështetës/ gjyqtar fakt
16	11	69 %	49	47	96%	3.1	4.3

Megjithatë duhet theksuar fakti se situata e burimeve njerëzore nuk ka qenë njësoj gjatë vitit 2024. Deri më datë 29.05.2024 numri i gjyqtarëve efektiv në detyrë pranë GJKKO ka qenë 9. Kjo për faktin pasi plotësimi me dy gjyqtarë i GJKKO është bërë më datë 29.05.2024¹² dhe më datë 19.06.2024.¹³ Gjithashtu, për arsye shëndetësore gjyqtare znj.Atalanta Zeqiraj për disa muaj nuk është paraqitur në punë. Këto fakte tregojnë se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 Gjykata ka funksionuar me 56% të organikës së gjyqtarëve dhe me 94% të organikës së stafit mbështetës. Raporti staf mbështetës për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë ka qenë 5.1.

¹² Me vendimin Nr. 283, datë 29.05.2024 KLGJ ka vendosur: Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit **z.Bib Ndreca** në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

¹³ Me vendimin Nr. 282, datë 29.05.2024 KLGJ ka vendosur: Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit **z.Ardit Mustafaj** në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë **19.06.2024**.

Situata tërësore e burimeve njerëzore deri më datë 28.05.2024 paraqitet si vijon në tabelë:

Nr. Gjyqtarë sipas dekretit	Nr. Gjyqtarë efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. staf mbështetës organikës	Nr. staf mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës/ gjyqtar organikës	Staf mbështetës/ gjyqtar fakt
16	9	56%	49	46	94%	3.1	5.1

Sa më sipër, arrihet në përfundimin se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024, trupa gjyqësore me 9 gjyqtarë pranë GJKKO ka përballuar ngarkesën e punës për 16 gjyqtarë. Këtu duhet shtuar fakti se tashmë pranë kësaj Gjykate ende nuk është krijuar Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë¹⁴ të cilët nën drejtimin e gjyqtarit të çështjes, përveç detyrave të përcaktuara në ligj, përmbushin edhe detyrat e mëposhtme: a) Përgatit përmbledhjen e materialit të çështjes sipas formatit tip të relacionit, të miratuar nga Këshilli i Gjykatës pas marrjes së mendimit nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve; b) Identifikon elementët për trajtimin e çështjes nga gjykata; c) Identifikon dhe analizon legjislacionin e zbatueshëm dhe/ose jurisprudencën kombëtare dhe/ose ndërkombëtare; ç) Analizon faktet dhe jep mendim ligjor për zgjidhjen e çështjes; d) Kryerja e detyrave të tjera të përcaktuara nga gjyqtari i çështjes në përputhje me legjislacionin në fuqi.¹⁵

2. MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE.

Backlog-u


Backlog-u i mbartur nga një vit më pare përcaktohet nga numri i çështjeve në pritje të gjykimit në fillim të periudhës së raportimit. Sa më i madh të jetë backlog-u aq më pak eficient ka qenë sistemi gjyqësor/gjykata në menaxhimin e fluksit të çështjeve në vite dhe aq më shumë kohë do t’i duhet për të gjykuar çështjet.

¹⁴ Në nenin 42 të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, nën titullin “Ndihmësit ligjorë të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit” parashikohet shprehimisht se: “1. Pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund të funksionojë Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 1/1 Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton numrin e ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë duke u bazuar në domosdoshmërinë e tyre për mbarëvajtjen e punës në gjykatë, pasi ka vlerësuar kriteret e përcaktuara në nenin 15, pika 3, shkronja “b”, të këtij ligji, llojin dhe natyrën e çështjeve për t’u përpunuar dhe përgatitur nga ndihmësit ligjorë, si dhe pas marrjes së mendimit të Këshillit të Gjykatës, ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave. Numri i ndihmësve ligjorë nuk mund të jetë më i madh se numri i përgjithshëm i gjyqtarëve. 2. Ndihmësi ligjor në veçanti: a) analizon praktikën gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim; b) përpunon çështjen dhe përgatit çështje të thjeshta standarde me shkallë kompleksiteti të ulët për marrjen e vendimit nga gjyqtari; c) kryen detyra të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtari ose siç parashikohet në ligj.”.

¹⁵ Shiko vendimin Nr. 204, datë 10.04.2025 të KLGJ-së mbi miratimin e rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor”.

Çështje të mbartura BACK-log	2021	2022	2023	2024	2024
Krime	55	50	61	46	37%
Penale Administrative	95	124	77	69	55%
Çështje të ligjit Antimafia	8	7	14	11	9%
Totali	158	181	152	126	100%

Gjykata e ka nisur punën në janar 2024 me 126 çështje në pritje të gjykimit, përkatësisht 46 krime, 69 çështje penale administrative dhe 11 çështje të ligjit antimafia¹⁶ përkundrejt 152 çështjeve stok në fillim të vitit 2023. Kjo ulje vjen si pasojë e rritjes së numrit të gjyqtarëve efektiv në detyrë duke bërë të mundur shqyrtimin e një numri të konsiderueshëm çështjesh krahasuar me vitin paraardhës. Backlog-u vlerësohet në vlera të pranueshme dhe të justifikueshme si çështje të cilat janë efektivisht në gjykim



¹⁶Për sqarimin e termave “Krime”, “Çështje penale administrative” dhe “Çështje të ligjit antimafia” shiko Udhëzuesin “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”, miratuar me vendimin nr. 47, datë 11.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku parashikohet shprehimisht se: “**Rreshti A.: Kategoria e "Krime"** përfshin tërësinë e çështjeve penale të themelit për të gjitha veprat penale të cilat përbëjnë krime sipas parashikimeve të Kodit Penal ose ligjeve të tjera që parashikojnë vepra penale. Në nënkategoritë e çështjeve penale krime janë veçuar disa grup veprash penale krime sipas objektit ose subjekteve të procedimit penal...Rreshti C: kategoria “**Çështje penale administrative**” përfshin tërësinë e çështjeve penale administrative, të ndryshme nga çështjet penale të themelit. Në këtë kategori bëjnë pjesë **kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak, çështjet penale të seancës paraprake dhe kërkesat penale të fazës së ekzekutimit**. Në kategorinë e çështjeve penale administrative është veçuar një nënkategori sipas fazës së procedimit, përkatësisht: Masa sigurimi (C.1). Numri i çështjeve në Reshtin C, përbën numrin. Rreshti C.1: Në kategorinë “**Çështje penale administrative**”, nënkategoria “**Masa sigurimi**” përfshin **kërkesat penale të fazës së hetimit paraprak për caktimin, zëvendësimin, revokimin dhe shuarjen e masave të sigurimit personal ose pasuror**. Rreshti D: Në kategorinë “**Çështje të ligjit antimafia**” përfshihen çështjet me objekt konfiskimin e pasurisë sipas parashikimeve të Ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar (Ligji antimafia)”.

Natyra e Backlog-ut.

Nga analizimi i të dhënave, vërehet se GJKKO ka vijuar intensivisht punën në lidhje me reduktimin e çështjeve të prapambetura. Rezulton se 55 % e tyre i përket kategorisë së çështjeve penale administrative, 36% janë çështjet e krimeve dhe 9% për antimafian. Në total janë reduktuar në 126 çështje të mbartura, në krahasim me vitet e tjera janë mesatarisht 38 çështje me pak. Nga ana tjetër krahasim në përqindje mes kategorisë së çështjeve janë ulur, çështjet e krimeve të mbartura nga 40% në 36%, ndërsa çështjet administrative janë rritur nga 51% në 55%. Përsa i përket çështjeve të ligjit antimafia, ngelet e njëjta, 9%. Këto ndryshime vijnë kryesisht si rezultat i shtimit të numrit të gjyqtarëve nga 7.5 në 9 të vitit paraardhës, dhe si rezultat i numrit të lartë të çështjeve administrative në krahasim me vitet paraardhëse.

Çështje të reja të regjistruara


Numri i çështjeve që regjistrohen në gjykatë gjatë periudhës së raportimit, tregon trendin e çështjeve që pritet të regjistrohen në gjykatë përcaktuar nga ndryshime ligjore, demografike, ekonomike, sociale, etj. Krahasuar me vitin 2023, vërehet se gjatë vitit 2024 në GJKKO janë regjistruar 3459 çështje të reja, nga të cilat: 89 krime, 3316 çështje penale administrative dhe 54 çështje të ligjit antimafia.

Tabela më poshtë paraqet numrin e çështjeve të reja të regjistruara në katër vitet e fundit sipas kategorive të tyre.

Çështje të reja të regjistruara	2021	2022	2023	2024	2024
Krime	94	89	73	89	3%
Penale Administrative	2017	1942	2667	3316	96%
Çështje të ligjit Antimafia	35	28	35	54	2%
Totali	2146	2059	2775	3459	100%

Praktikat më të mira ndërkombëtare kërkojnë që analiza e performancës së gjykatës të përmbajë edhe një vështrim krahasimor mes çështjeve të gjykuara përkundrejt çështjeve të regjistruara në gjykatë. Edhe në këtë pasqyrë të përgjithshme vihet re prirja në rritje e çështjeve të reja të regjistruara dhe prirja në rritje e vendimmarrjes së gjykatës.

Krahasuar ndër vite për të dytin vit radhazi totali i çështjeve të reja është rritur në numër të konsiderueshëm. Për vitin 2024 kemi rritje të numrit të çështjeve të reja me 684 çështje ose rreth 25 % më shumë se viti 2023. Në krahasim me vitin 2022 kjo rritje e numrit të çështjeve të vitit 2024 është në masën 1400 çështje ose rreth 68% çështje më shumë.



Për sa i përket llojit të çështjeve të reja të paraqitura në gjykatë krahasuar me vitet e kaluara, numri i çështjeve të reja paraqitet grafikisht:

Ngarkesa e punës në gjykatë

Ngarkesa e një gjykate përbëhet nga tërësia e çështjeve në administrim të saj gjatë afatit kohor të përcaktuar. Ajo është shuma e *backlog*-ut të çështjeve nga vitet e mëparshme dhe çështjeve të reja të regjistruara në gjykatë. Grafikisht paraqitet si më poshtë:

Lloji i çështjeve	Të mbartura	Të reja	Totali
Krime	46	89	135
Penale Administrative	69	3316	3385
Çështje të Ligjit Antimafia	11	54	65
Totali	126	3459	3585

Siç shihet çështjet Penale Administrative zënë peshën kryesore prej 3,385 çështjesh, ose 94 % të numrit total të çështjeve të shqyrtuara përgjatë vitit 2024.



Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar (Treguesi WR).

Ngarkesa totale e gjykatës ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në treguesin WR, i cili shpreh tërësinë e çështjeve të mbartura (backlog) dhe të regjistruara rishtazi, të cilat janë për shqyrtim nga një gjyqtar. Pra, ky indikator tregon ngarkesën e punës në gjykatë në raport me numrin efektiv të gjyqtarëve. Shërben si element krahasues mes të njëjtit juridiksion dhe nivel gjykimi për të përcaktuar ngarkesën e gjyqtarëve në kushte të ngjashme.

Për vitin 2024 ngarkesa mesatare e punës rezulton 326 çështje për gjyqtar. Krahasuar me vitet paraardhëse kjo ngarkese është pothuajse e njëjtë me 2023 dhe 10 % më e lartë se 2022. Kjo rritje e ngarkesës është ndikuar kryesisht nga numri i kërkesave penale administrative të reja, të cilat krahasuar me vitin e kaluar 2023, është 684 çështje më shumë. Mbajtja e treguesit në të njëjtin nivel me vitin paraardhës është ndikuar edhe nga rritja e numrit efektiv të gjyqtareve, nga 9 në 11.

Numri gjyqtarëve efektiv 2021	Numri i gjyqtarëve efektiv 2022	Numri i gjyqtarëve efektiv 2023	Numri i gjyqtarëve efektiv 2024	WR 2021	WR 2022	WR 2023	WR 2024
7.16	7.5	9	11 ¹⁷	329.7	298.7	325	326

Vjetërsia e çështjeve në pritje të gjykimit.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në fund të vitit 2024 ka 169 çështje në pritje për t’u gjykuar. Në ndryshim nga viti i kaluar ka një rritje të vogël të numrit nga 126 çështje (2023) në 169 çështje (2024), edhe pse është rritur numri

¹⁷ Sikurse u sqaruar më sipër në gjashtë mujorin e parë të vitit 2024 numri i gjyqtarëve efektiv në detyrë ka qenë nëntë sa në vitin 2023.

efektiv i gjyqtareve në 69 %, vjetërsia e këtyre çështjeve duket qartazi që është e 6 muajve të fundit, të cilat nga kompleksiteti i çështjeve, shqyrtimi i tyre është i pamundur për t’u realizuar brenda 6 mujorit.

Vlen të theksohet se gjatë muajit Dhjetor 2024 janë regjistruar 9 dosje penale themeli, 10 seanca paraprake, 80 kërkesa penale si dhe janë regjistruar një numër i lartë për kërkesa për përgjim në datat e fund vitit, konkretisht 22 kërkesa, nga të cilat 14 janë shqyrtuar ndërsa 8 prej tyre janë mbartur për vitin pasardhës.

Nga 110 çështje të mbartura me vjetërsi 6 muaj, **~100 janë të regjistruara në muajin Dhjetor 2024¹⁸**.

Nga analizimi i të dhënave GJKKO ka shqyrtuar 3585, ku 3295 janë me vendim ndërsa 121 janë me disponime të tjera, si shpallje e moskompetencës lëndore, dërgimin e akteve për gjykim në gjykatën kompetente, bashkimin e çështjeve dhe kthim aktesh në prokurori. Nga këto, 169 janë mbartur për vitin pasardhës, 5% të çështjeve, ku vlen të theksohet se 65% e tyre janë të regjistruara në 6 mujorin e fundit të vitit, 16% brenda vitit, 14% brenda 2 viteve, 4 % mes dy dhe tre viteve dhe vetëm 1% janë me te vjetra se tre vjet.

VJETËRSIA E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT NË FUND TË VITIT 2024								
Lloji i çështjes		NUMRI I ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT						
		Totali në pritje të gjykimit	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	> 5 vjet
A	Krime	57	32	8	11	4	2	0
B	Kundërvajtje penale	0	-	-	-	-	-	-
C	Çështje penale administrative	96	76	13	7	0	0	0
D	Çështje të ligjit antimafia	16	2	6	5	3	0	0
Totali)		169	110	27	23	7	2	0

Në tërësi Gjykata ka ruajtur të njëjtën efektivitet pune si për vitin 2023, duke mbartur vetëm 4.7% të çështjeve për vitin pasardhës.

3. TREGUESIT E EFIÇENCËS

Rendimenti mesatar i punës për gjyqtar (Treguesi ER)

Shpreh numrin mesatar të çështjeve të përfunduara nga një gjyqtar, gjatë vitit të raportuar. Për vitin 2024, treguesi ER për GJKKO është 310.5 çështje për gjyqtar.

¹⁸ Vendimi Nr. 127, datë 24.12.2024, “Për pezullimin e shortit nga datat 30.12.2024 – 08.01.2025” të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Nga analizimi i të dhënave në tërësi, treguesi ka qenë pothuajse i njëjtë duke mbajtur një numër mesatar të njëjtë çështjesh me vitin e kaluar, kjo për arsye se ka patur 680 çështje më shumë se viti i kaluar me gjithë shtimin e trupës gjyqësore.

Gjyqtarë 2021	Gjyqtarë 2022	Gjyqtarë 2023	Gjyqtarë 2024	ER 2021	ER 2022	ER 2023	ER 2024	# në % i ER
7.16	7.5	9	11	304.5	278.4	311	310.5	0.0%


Norma e zgjidhjes së çështjeve (Treguesi CR)

Norma e zgjidhjes së çështjeve përcakton aftësinë e gjykatës për të ruajtur ritmin mes çështjeve të përfunduara dhe çështjeve të reja të regjistruara. Ky indikator përcaktohet për secilën kategori çështjesh civile, penale dhe administrative. Nëpërmjet treguesit CR dallohet lehtësisht aftësia e gjykatës për të ruajtur, rritur apo ulur nivelet e saj të *backlog*-ut.

Për GJKKO, në vitin 2024 ka pasur një normë të lartë likuidimi të çështjeve duke mbajtur vlerën 99%. Në ndryshim nga viti i kaluar, këta tregues janë më të ulët, për shkak të sasisë së lartë të çështjeve të reja dhe mbi të gjitha, kompleksitetit të tyre. Gjithsesi e shprehur në përqindje, treguesi është shumë i lartë duke mos krijuar stok për vitet në vazhdim, por duke vazhduar qartazi evadimin e çështjeve.

ADMINISTRIMI I ÇËSHTJEVE VITI 2024						
Lloji i çështjes	Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Të gjykuara	Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	Të regjistruara gjithsej	Treguesit e efikasitetit Norma e likuidimit të çështjeve (%)
Krime	46	89	78	57	135	88
Korrupsioni	19	41	41	19	60	100
Krimi i organizuar	26	39	30	35	65	77
Çështje penale administrative	69	3316	3289	96	3385	99
Çështje të ligjit antimafia	11	54	49	16	65	91
Totali	126	3459	3416	169	3585	99%

Grafiku i mëposhtëm paraqet në % normën e likuidimit të çështjeve sipas kategorive.



Gjykata duke mbajtur normën e lartë të gjykimit tregon që është në qëndrueshmëri të evadimit të çështjeve vjetore.

Koha e nevojshme për likuidimin e çështjeve (Treguesi DT)

Treguesi mat se sa shpejtë gjykata punon mbi çështjet e marra, nënkupton kohën mesatare që duhet për përfundimin e një lloji çështjeje të caktuar. Për vitin 2024 koha mesatare e zgjidhjes së çështjes është 18 ditë, pothuajse në të njëjtën sasi me vitin e kaluar.

- Viti 2024 – 18 ditë
- Viti 2023 – 16 ditë
- Vitin 2022 – 26.6 ditë
- Vitin 2021 – 30.3 ditë.

Referuar llojeve të çështjeve për të cilat ka interes, rezulton se për kategorinë krime nënkategoria "Korrupsioni"¹⁹ kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2024 është

¹⁹ Për sqarimin e termave “Krime”, nënkategoria "Korrupsioni" shiko Udhëzuesin “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave”, miratuar me vendimin nr. 47, datë 11.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku parashikohet shprehimisht se: “Në kategorinë "Krime", nënkategoria "Korrupsioni" përfshin çështjet për veprat penale si më poshtë: - Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 244 i Kodit Penal; - Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 244/a i Kodit Penal; - Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, neni 245 i Kodit Penal; - Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, neni 245/1 i Kodit Penal; - Përfitim i paligjshëm i interesave, neni 257 i Kodit Penal; - Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, neni 258 i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike, neni 259 i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë, neni 259/a i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, neni 260 i Kodit Penal; - Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit,

169 ditë, e ngjashme me vitin paraardhës, gjykimin mesatar brenda gjashtë muajve për korrupsionin.

Për llojin e çështjeve krime, nënkategoria "Krimi i organizuar",²⁰ kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2024 është 426 ditë, përsëri e ngjashme me vitin paraardhës, gjykim mesatar brenda katërmbëdhjetë muajve për krimin e organizuar.


Për llojin e çështjeve për kategorinë e “Çështje të ligjit antimafia”, kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2024 është 119 ditë, e ngjashme me vitin paraardhës, gjykimin mesatar brenda katër muajve për antimafian.

Më poshtë tabela dhe grafiku me të dhënat specifike.

Lloji i çështjeve	2021	2022	2023	2024
Korrupsioni	104	316	136	169
Krimi i organizuar	407	511	431	426
Çështje të ligjit antimafia	71	243	106	119
Totali	582	1070	673	714

neni 312 i Kodit Penal; - Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë, neni 319 i Kodit Penal; - Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/a i Kodit Penal; - Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj, neni 319/b i Kodit Penal - Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/c i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë, neni 319/ç i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare, neni 319/d i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj, neni 319/dh i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja, neni 319/e i Kodit Penal; - Korrupsioni aktiv në zgjedhje, neni 328 i Kodit Penal; - Korrupsioni pasiv në zgjedhje, neni 328/b i Kodit Penal; - Çështje të tjera;”.

²⁰ Për sqarimin e termave “Krimi”, nënkategoria "**Krimi i organizuar**" shiko Udhëzuesin “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave”, miratuar me vendimin nr. 47, datë 11.02.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku parashikohet shprehimisht se: “Në kategorinë "Krimi", nënkategoria "**Krimi i organizuar**" përfshin çështjet për veprat krime të kryera nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal1, të tilla si: - Organizatat terroriste, neni 234/a i Kodit Penal; - Banda e armatosur, neni 234/b i Kodit Penal; - Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale, neni 284/a i Kodit Penal; - Organizatat kriminale, neni 333 i Kodit Penal; - Grupi i strukturuar kriminal, neni 333/a i Kodit Penal; - Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, neni 334 i Kodit Penal; - Çështje të tjera; ...”.



GJETJET KRYESORE!

- ✓ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka nisur punën në janar 2024 me 126 çështje në pritje të gjykimit (backlog), **26 çështje më pak**, krahasuar me backlog-un në fillim të vitit 2023.
- ✓ Në gjykatë janë regjistruar 3459 çështje të reja, 684 ose **20% çështje më shumë** krahasuar me vitin paraardhës.
- ✓ Rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve në vitin 2024, me gjithë rritjen e numrit të çështjeve në krahasim me vitin paraardhës, ka ruajtur tërësinë e treguesve të efijencës në gjykatë:
 - Ngarkesa mesatare për gjyqtar (WR) është 326 çështje;
 - Rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) është 310.5 çështje;
 - Norma e likuidimit të çështjeve (CR) është 99%;
 - Koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) e përgjithshme është 18 ditë.

Në fund të vitit raportues 2024, në këtë gjykatë mbeten në pritje për t’u shqyrtuar 169 çështje, nga 126 që ishin në vitin 2023.

Çështjet e paraqitura në gjykatë, kohëzgjatja dhe statistika mbi ankimin.

Numri dhe lloji i çështjeve të gjykuara nga GJKKO për vitin 2024 paraqitet si më poshtë:

Lloji i çështjeve	Çështje Penale	Seanca Paraprake	Kërkesa Penale	OFL	Masa sigurimi	Kërkesa për përgjime	Sekuestro / Konfiski m sipas ligjit antimafia	Total
Çështje në pritje më 1 Janar 2024	46	39	22	8	0	0	11	126
Çështje në pritje më 31 Dhjetor 2024	57	52	34	2	0	8	16	169
Çështje të ardhura përgjatë viti 2024	89	128	745	1	159	2283	54	3459
Çështje të përfunduara përgjatë viti 2024	78	115	733	7	159	2275	49	3416

Tabela: Statistika mbi shpejtësinë e përfundimit të çështjeve penale

Shpejtësia e gjykimit të çështjeve penale, për vitin 2024					
Lloji i Çështjes	0 - 2 muaj	2 - 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 1 Vit	Total
Penale Themeli	2	50	15	11	78
Në %	3%	64%	19%	14%	-

1. Statistika penale (çështje penale, seanca paraprake, masa sigurimi, kërkesa te tjera penale).

Tabela: Treguesit Statistikorë sipas Bashkimit Evropian 01.01.2024 - 31.12.2024

Lloji i Çështjes	Nr. i çështjeve të përfunduar më 31 Dhjetor 2024	Nr. i çështjeve në gjykim më 31 Dhjetor 2024	Nr. i çështjeve të regjistruar gjatë vitit 2024
Dosje Penale Themeli	78	57	135
Seanca paraprake	115	52	167
OFL	7	2	9
Sekuestro/konfiskim sipas ligjit antimafia	49	16	65
Masa Sigurimi	159	0	159
Kërkesa penale	733	34	767
Përgjime	2275	8	2283
Totali	3416	169	3585

Tabela: Volumi i çështjeve gjyqësore sipas secilit gjyqtar të GJKKO

Nr.	Gjyqtar	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar)	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. çështjeve në shqyrtim
1	Erion Bani	11	362	364	9
2	Erjon Çela	12	484	474	22
3	Etleva Deda	13	422	425	10
4	Irena Gjoka	15	353	355	13
5	Flora Hajredinaj	12	362	356	18
6	Atalanta Zeqiraj	12	398	409	1
7	Flojera Davidhi	11	374	369	16
8	Elsa Ulliri	9	211	202	18
9	Rudina Palloj	19	266	272	13
10	Bib Ndreca	1	85	73	13
11	Ardit Mustafaj	0	95	78	17
12	Migena Laska (e deleguar)	1	0	1	0
13	Esmeralda Xhili (e deleguar)	1	1	1	1
14	Diamela Goxha (e deleguar)	1	0	1	0
15	Eglantina Mikani (e deleguar)	-	6	6	0
16	Aurel Arapi (i deleguar)	2	0	2	0
17	Albert Meçe (i deleguar)	1	0	0	1
18	Paulin Çera (i deleguar)	2	8	9	1
19	Artan Jahollari (i deleguar)	2	2	4	0
20	Matilda Llangozi (e deleguar)	1	14	13	2
21	Luljeta Kola (e deleguar)	-	1	0	1
22	Artan Çupi (i deleguar)	-	2	1	1
23	Alfred Konomi (i deleguar)	-	1	0	1
24	Engjëllushe Tahiri (e deleguar)	-	1	0	1
25	Kujtim Vraniçi (i deleguar)	-	2	1	1
26	Mbartur për short	-	9	-	9
TOTALI		126	3459	3416	169

Ngarkesa e gjyqtarëve të GJKKO, për çështje te gjykuara si kryesues e anëtare në trup gjykues.

Gjyqtar / e	Çështje të gjykuara	Penale		Kërkesa Penale
		I vetëm dhe kryesues	Trup Gjykues	
Erjon BANI	380	11	16	353
Erjon ÇELA	484	10	10	464
Irena GJOKA	369	5	14	350
Etleva DEDA	435	3	10	422
Flora HAJREDINAJ	369	4	13	352
Atalanta ZEQUIRAJ	415	7	6	402
Flojera DAVIDHI	384	5	15	364
Elsa ULLIRI	214	10	12	192
Rudina PALLOJ	282	12	10	260
Bib NDRECA	78	2	5	71
Ardit MUSTAJ	82	2	4	76
Albert MEÇA (i deleguar)	1	-	1	-
Alfred KONOMI (i deleguar)	1	-	1	-
Artan ÇUPI (i deleguar)	1	-	-	1
Artan JAHOLLARI (i deleguar)	4	1	-	3
Aurel ARAPI (i deleguar)	3	1	1	1
Diamela GOXHA (e deleguar)	1	-	-	1
Eglantina MIKANI (e deleguar)	7	1	-	6
Engjëllushe TAHIRI (e deleguar)		-	-	-
Esmeralda XHILI (e deleguar)	2	-	2	-
Kujtim VRANIÇI (i deleguar)	1	-	-	1
Luljeta KOLE (e deleguar)		-	-	-
Matilda LLANGOZI (e deleguar)	14	1	1	12
Migena LASKA (e deleguar)	2	1	1	-
Paulin ÇERA (i deleguar)	9	2	-	7
Adelajda GJUZI (e deleguar)	1	-	1	-
Gerd HOXHA (i deleguar)	1	-	1	-
Gilda HOXHA (e deleguar)	1	-	1	-
Gentjan MARKU (i deleguar)	1	-	1	-
Ilir PERDEDA (i deleguar)	1	-	1	-
Marcela SHEHU (e deleguar)	1	-	1	-
Olkide LIÇE (e deleguar)	1	-	1	-
Sokol PASHO (i deleguar)	1	-	1	-
Sokol SHEHU (i deleguar)	1	-	1	-
Besmir STROKA (i deleguar)	1	-	1	-
TOTAL	3538	78	132	3338

Tabela: Volumi i çështjeve penale ne vitin 2024

Volumi çështjeve penale të reja përgjatë vitit 2024							
Seanca paraprake	Çështje Penale	Kërkesa Penale	OFL	Sekuestro / Konfiskim	Masa Sigurimi	Përgjime	Totali
128	89	745	1	54	159	2283	3459

Grafiku: Volumi i çështjeve penale dhe hetimeve paraprake në vitin 2024




Tabela: Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata në vitit 2024

Masa Sigurie	Të Regjistruara	Të Përfunduara	Të Papërfunduara
Totali	159	159	0

Tabela: Analiza e masave të sigurimit të vendosura nga GJKKO-ja ndër vite.

Masat e Sigurimit Ndër Vite				
Llojet e masave		2022	2023	2024
Masë Sigurimi Arrest me Burg		189	184	165
Masë Sigurimi në mungese		22	28	97
Masë Sigurimi Arrest Shtëpie		37	51	38
Masë Sigurimi Detyrim paraqitje		15	41	36
Masë Sigurimi Ndalim Dalje Jashtë Vendit		1	1	6
Masë Sigurimi Pezullim Ushtrim Detyre		4	1	4
Total		268	306	346

Përgjatë vitit 2024 janë dhënë në total 159 vendime, nga të cilat: i) 43 vendime me objekt: “Caktim mase sigurimi në mungesë”; ii) 63 vendime me objekt: “Ekzekutimin e masave të sigurimit të dhëna në vitin 2024”; iii) 5 vendime me objekt: “Rivlerësim mase sigurimi”; iv) 11 vendim me objekt: “Vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi”; dhe v) 37 vendime me objekt: “deklarim ikje dhe ekzekutimin e masave të sigurimit për vendimet e viteve paraardhëse të pa ekzekutuara”.

Tabela: Analiza e seancave paraprake

Seanca Paraprake - Viti 2024						
Kaluar për gjykim	Pushuar	Kthim për plotësim hetimesh	Vendosur moskompetenca	Përfunduar	Papërfunduar	Totali
66	36	8	5	115	52	167

Rezulton se në kërkesat e sjella nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin e Organizuar, me objekt: “Për dërgimin për gjykim/pushimin e procedimit penal”, nga gjykata me vendime të ndërmjetme, është vendosur kthimi i akteve në prokurori dhe plotësimi i hetimeve, si më poshtë vijon;

- Për 3 (tre) dosje penale me objekt: “Dërgimin e çështjes për gjykim”, është vendosur plotësimi i hetimeve, për veprat²¹ penale të parashikuara nga nenet 248, 185, 180/2, 259 të Kodit Penal
- Për 8 (tetë) dosje penale me objekt: “Pushimin e hetimeve”, është vendosur kthimi i akteve dhe plotësimi i hetimeve, për veprat ²²penale të parashikuara nga nenet 319/ç, 248, 79/dh, 28/4, 333/a/2, 334/2, 186, 248, 259, 333/a, 328, 244/1 dhe 259/1, përkatësisht referoju vendimeve me nr.12/71, datë 13.12.2024, nr.22/112, datë 16.02.2024, nr.23, datë 26.03.2024, nr.61, datë 27.06.2024, nr.90, datë 10.07.2024, nr.90, datë 16.10.2024, nr.105, datë 24.10.2024, nr.129, datë 19.11.2024,

Tabela : Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale 2024

Viti 2024	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Vendim Pushimi	Kthim për plotësim hetimesh	Vendosur moskompetenca	Totali
Sasia në nr.	53	17	2	3	3	78
Sasia në %	68%	22%	3%	4%	4%	100%

Grafiku: Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale 2024

²¹ Referuar vendimeve me Nr.34, datë 10.12.2024; Nr.55, datë 17.09.2024 dhe vendimit Nr.69, datë 23.12.2024.
²² Referuar vendimeve me Nr.12/71, datë 13.12.2024; Nr.22/112, datë 16.02.2024; Nr.23, datë 26.03.2024; Nr.61, datë 27.06.2024; Nr.90, datë 10.07.2024; Nr.90, datë 16.10.2024; Nr.105, datë 24.10.2024 dhe vendimit Nr.129, datë 19.11.2024.




Tabela: Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale për numrin e personave të gjykuar për fajësi dhe pafajësi.

Nr. i Vendimit	Nr. i të pandehurve	Nr. i akuzave të gjykuara	Nr. i të pandehurve me vendim fajësie	Nr. i akuzave me vendim fajësie	Nr. i të pandehurve me vendim pafajësie	Nr. i akuzave me vendim pafajësie
1	3	6	3	6	0	0
2	2	2	0	0	0	0
3	1	1	1	1	0	0
4	2	1	1	2	0	0
5	5	16	5	16	0	0
6	1	1	1	1	0	0
7	1	2	1	1	1	1
8	2	3	2	3	0	0
9	3	6	3	6	0	0
10	1	1	1	1	0	0
11	4	12	4	12	0	0
12	1	3	1	3	0	0
13	6	10	4	8	0	0
14	2	2	2	2	0	0
15	1	1	1	1	0	0
16	1	1	0	0	0	0
17	2	2	2	2	0	0
18	25	34	25	32	1	2
19	3	3	3	3	0	0
20	1	3	1	3	0	0
21	4	6	3	5	1	1
22	4	8	3	7	1	1
23	1	1	0	0	1	0
24	9	9	9	9	0	0
25	1	1	1	1	0	0
26	1	5	1	5	0	0
27	1	1	0	0	0	0
28	14	43	14	38	5	5
29	1	1	0	0	0	0
30	4	4	4	4	0	0

31	1	2	1	1	1	1
32	3	3	0	0	0	0
33	3	5	3	5	0	0
34	1	2	1	1	1	1
35	1	1	0	0	0	0
36	1	5	1	5	0	0
37	6	13	4	9	1	2
38	1	2	1	2	0	0
39	10	29	10	25	2	2
40	3	6	3	6	0	0
41	7	9	6	8	1	1
42	12	25	11	24	1	1
43	13	26	2	4	11	11
44	1	2	1	2	0	0
45	1	1	1	1	0	0
46	2	4	2	4	0	0
47	1	1	1	1	0	0
48	6	7	6	7	0	0
49	6	46	6	45	0	0
50	1	1	0	0	0	0
51	3	6	3	6	0	0
52	32	70	30	62	2	3
53	5	5	0	0	0	0
54	1	1	1	1	0	0
55	1	1	1	1	0	0
56	1	1	1	1	1	1
57	2	2	2	2	0	0
58	3	3	3	3	0	0
59	11	15	4	4	4	4
60	1	1	1	1	0	0
61	5	16	5	15	1	1
62	4	8	4	8	0	0
63	1	1	1	1	0	0
64	1	1	1	1	0	0
65	2	2	0	0	0	0
66	1	1	1	1	0	0
67	1	2	1	2	0	0
68	2	3	2	3	0	0
69	1	1	1	1	0	0
70	1	2	1	2	0	0
71	1	2	1	2	0	0
72	16	31	14	28	2	2
73	2	4	2	4	0	0
74	1	2	1	2	0	0
75	2	3	2	3	0	0
76	1	2	1	2	0	0
77	3	6	3	6	0	0
78	4	4	1	1	2	2
Total	296	575	244	485	40	42

Tabela: Detajimi i pafajësisë për personat e gjykuar në përfundimit të çështjeve penale 2023 dhe viti 2024

Viti	Pafajësi	Me të dëmtuar akuzues	Në çështjet penale	E pjesshme/dënim për një vepër tjetër	Totali
2023		5	27	-	32
2024		1	20	19	40

Nga analiza e të dhënave statistikore rezulton se për vitin 2024 janë 17²³ (shtatëmbëdhjetë) çështje në të cilat janë dhënë nga GJKKO vendim pafajësie për 42 akuza për 40 të pandehur. Nga këta persona të akuzuar janë 21 (njëzet e një) të pafajshëm, dhe 19 persona pjesërisht të pafajshëm.

Nga këto çështje, 2 (dy)²⁴ çështje janë vendim pafajësie për veprat penale “Fyerja” dhe “Shpifja” parashikuar nga nenet 119 dhe 120/2 i Kodit Penal për 1 (në) të akuzuar pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe për 3 (tre) të akuzuar për veprën penale “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.

Për sa i përket 15 (pesëmbëdhjete) çështjeve të tjera vendimet janë të përbëra me vendime fajësie dhe pafajësie. Nga analiza e vendimeve rezulton se janë shpallur të pafajshëm për vepra të ndryshme penale si “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” parashikuar nga nenet 259 paragrafi i 2 i Kodit Penal; “Korrupsion aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” e kryer në bashkëpunim dhe “Korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” parashikuar nga nenet 319 – 25 dhe 319/ç i Kodit Penal; “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” kundër dy ose më personave, “Mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, dhe “Grup i strukturuar kriminal” parashikuar nga nenet 79/d, 278/1, 28/4, dhe 333/a i Kodit Penal; “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 283/1, 28/4 dhe 334/1 i Kodit Penal; “Grup i strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal; “Moskallëzim i krimit” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal; “Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje” e kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 80, 28/4 dhe 333/a/2 të Kodit Penal; “Trafikim i narkotikëve” e kryer në kuadër të grupit të strukturuar kriminal parashikuar nga nenet 283/a, 28/4 dhe 333/a/2 i Kodit Penal; “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” parashikuar nga neni 287/2 i Kodit

²³ Përkatesisht, Vendimi 18, datë 13.03.2024; Vendimi 21, datë 25.03.2024; Vendimi 22, datë 02.04.2024; Vendimi 28, datë 25.04.2024; Vendimi 31, datë 09.05.2024; Vendimi 34, datë 22.05.2024; Vendimi 37, datë 12.06.2024; Vendimi 39, datë 25.06.2024; Vendimi 41, datë 27.06.2024; Vendimi 42, datë 01.07.2024; Vendimi 43, datë 08.07.2024; Vendimi 52, datë 01.10.2024; Vendimi 59, datë 16.10.2024; Vendimi 61, datë 18.10.2024; dhe Vendimi 72, datë 05.12.2024 i GJKKO.

²⁴ Vendimi 23, datë 09.04.2023 dhe Vendimi 78, datë 20.12.2024 i GJKKO.

Penal; “*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal; “*Shpërdorim i detyrës*” kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 248 dhe 25 i Kodit Penal.

Nga analiza e detajuar e gjykitimit të çështjeve penale janë gjykuar 78 çështje penale, ku kanë qenë të pandehur 296 persona, dhe janë gjykuar për 575 akuza për vepra penale.

Nga gjykimi janë shpallur:

- (i) Të fajshëm, 244 persona për 485 akuza

(82.4%)
- (ii) Të pafajshëm, 40 persona për 42 akuza

(13.5%)
- (iii) Pushuar, 20 persona për 20 akuza

(6.8%)
- (iv) Kthyer për plotësim hetimesh, 6 persona për 6 akuza

(2%)
- (v) Moskompetencë, 10 persona për 10 akuza

(3.4%)
- (vi) Mjekimi i detyruar, 1 person

(0.3%)

Është kërkuar gjykim i shkurtuar nga 212 persona, është kryer bashkim dënimesh për 101 persona, dhe është pezulluar ekzekutimi i dënimit me burg apo shuarje e masës për 87 persona.

Vlen për tu theksuar se 8.4% të rasteve gjatë gjykimit, kanë pasur vendime të përbëra për persona qe në një pjese të akuzave kanë rezultuar të fajshëm dhe ne një pjese të pafajshëm.

Tabela: Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale me gjykim të shkurtuar.

Nr. i Vendimit	Nr. i të pandehurve	Nr. i akuzave të gjykuara	Nr. i të pandehurve me vendim fajësie	Nr. i akuzave me vendim fajësie	Aplikimi i nenit 406 (gjykim i shkurtuar)
1	3	6	3	6	3
6	1	1	1	1	1
7	1	2	1	1	1
8	2	3	2	3	2
9	3	6	3	6	3
10	1	1	1	1	1
11	4	12	4	12	4
13	6	10	4	8	4
15	1	1	1	1	1
17	2	2	2	2	2
18	25	34	25	32	25
19	3	3	3	3	3
20	1	3	1	3	1
21	4	6	3	5	3
24	9	9	9	9	9

25	1	1	1	1	1
28	14	43	14	38	14
31	1	2	1	1	1
33	3	5	3	5	3
34	1	2	1	1	1
36	1	5	1	5	1
38	1	2	1	2	1
39	10	29	10	25	10
40	3	6	3	6	3
41	7	9	6	8	7
42	12	25	11	24	12
43	13	26	2	4	2
44	1	2	1	2	1
46	2	4	2	4	2
47	1	1	1	1	1
48	6	7	6	7	6
51	3	6	3	6	3
52	32	70	30	62	30
54	1	1	1	1	1
56	1	1	1	1	1
57	2	2	2	2	2
58	3	3	3	3	3
59	11	15	4	4	4
61	5	16	5	15	5
62	4	8	4	8	4
63	1	1	1	1	1
64	1	1	1	1	1
65	2	2	0	0	0
66	1	1	1	1	1
67	1	2	1	2	0
68	2	3	2	3	2
69	1	1	1	1	0
70	1	2	1	2	1
71	1	2	1	2	1
72	16	31	14	28	14
73	2	4	2	4	2
74	1	2	1	2	1
75	2	3	2	3	2
76	1	2	1	2	0
77	3	6	3	6	3
78	4	4	1	1	1
Total	245	457	213	388	212

Tabela: Lidhur me aplikimin e dënimeve alternative

Nr. i Vendimit	Nr. i të pandehurve	Nr. i akuzave të gjykuara	Aplikimi i neneve 59 dhe 63 të K.Penal
1	3	6	3
4	2	1	1
6	1	1	1
13	6	10	3
14	2	2	1
15	1	1	1
17	2	2	2
18	25	34	16
19	3	3	3
21	4	6	3
24	9	9	9
25	1	1	1
30	4	4	4
33	3	5	1
40	3	6	1
41	7	9	3
42	12	25	1
43	13	26	11
47	1	1	1
48	6	7	4
52	32	70	1
54	1	1	1
55	1	1	1
56	1	1	1
58	3	3	3
60	1	1	1
63	1	1	1
64	1	1	1
71	1	2	1
72	16	31	2
74	1	2	1
75	2	3	1
76	1	2	1
78	4	4	1
Totali	174	282	87

Tabela: Detajimi i gjykimit të të pandehurve për vitin 2024 sipas akuzave, neneve të Kodit Penal.

Personat e gjykuar për vitin 2024, sipas neneve të Kodit Penal	Të dënuar	Pafajësi	Pushuar	Moskompetencë
Neni 76	3	-	-	-
Neni 78/2	9	-	-	-
Neni 79	1	1	-	-
Neni 80	11	-	-	-
Neni 113	1	-	-	-
Neni 119	-	1	-	-
Neni 120	-	-	2	-
Neni 139	3	-	-	-
Neni 130	1	-	-	-
Neni 140	1	-	-	-
Neni 143, 333/a	4	-	-	-
Neni 180	1	-	-	-
Neni 186	1	-	-	-
Neni 190	1	-	1	-
Neni 232/a	1	-	-	-
Neni 234	9	-	-	-
Neni 244/2	10	-	1	-
Neni 245/1/2	47	1	-	-
Neni 248	14	-	7	-
Neni 257/a/1	2	-	-	-
Neni 258	4	3	4	-
Neni 259	8	-	-	-
Neni 260	-	-	-	-
Neni 278/1/2	3	-	-	-
Neni 283/a/1, 283/a/2, 333/a	60	3	-	-
Neni 284	18	-	-	-
Neni 287/a/1	-	-	1	-
Neni 291	-	-	-	1
Neni 298	2	-	-	-
Neni 300, 301	3	-	-	-
Neni 312	-	-	-	-
Neni 319	3	1	-	-
Neni 328	9	-	1	-
Neni 333/a	9	11	8	-
Neni 334	10	-	-	-
Totali	249	21	25	1

Tabela : Detajimi i masave të dënimit të dhëna nga gjykata për vitin 2024

Me gjobë	Deri 2 vjet	2-5 vjet	5-10 vjet	10-25 vjet	25-35 vjet	Burgim i përjetshëm	TOTA LI
4	105	36	86	8	9	1	249

Grafiku: Detajimi i masave te dënimit të dhëna nga gjykata




Tabela: Detajimi i dënimeve të dhëna sipas gjinisë për vitin 2024

Sasia	Të dënuara femra	Të dënuar meshkuj	Të dënuar gjithsej
Në numër	18	231	249
Në %	7%	93%	100%

Grafiku: Detajimi i dënimeve të dhëna sipas gjinisë në %




Tabela: Çështje penale të regjistruara gjithsej sipas dispozitave përkatëse penale për vitin 2024

Nenet	Emërtimi i nenit	Çështje të regjistruara	Çështje të përfunduara me vendim	Çështje të mbartura në 2025
78/a; 78/2; 333/a	Vrasje për gjakmarrje; Vrasja me paramendim, e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje	5	3	2
79/a; 79/dh; 333/a	Vrasje e funksionarëve publik; Vrasje në rrethana të tjera cilësuese - kundër dy ose më shumë personave	4	2	2
109/3; 333/a	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë a shoqëruar me tortura fizike ose psikike, i kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë	1		1
134/3; 139; 140; 333/a	Vjedhja; Vjedhja me dhunë; Vjedhja me armë	1	1	
143; 143/b/1; 28/4; 333/a/1; 334/1	Mashtrim kompjuterik, në bashkëpunim. Krijim i grupit të strukturuar kriminal. Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal.	4	1	3
186/2; 186/1; 189/2; 190, 333/a	Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara; Falsifikimi i dokumenteve; Përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave të falsifikuara	3	2	1
244	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	3	2	1

245/1/2	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	10	9	1
248	Shpërdorimi i detyrës	8	5	3
258	Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	9	4	5
260	Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë	1	1	
259	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	12	8	4
278	Trafikim i armëve dhe municioneve	4	2	2
283/a/2; 333/a	Trafikimi i narkotikëve, në bashkëpunim ose më shumë se një herë	10	2	8
283/a/1; 333	Trafikimi i narkotikëve	14	9	5
283	Prodhimi dhe shitja e narkotikëve			
284/1; 333/a	Kultivimi i bimëve narkotike	4	1	3
287/a	Çelja e llogarive anonime	1	1	
291	Drejtimi i automjetit në gjendje të dehur	1	1	
298/3; 298/2, 333/a	Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me pasoja të rënda; Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, e dhënë për qëllime fitimi	5	2	3
319	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	5	4	1
334/1	Grupi i strukturuar kriminal, krijimi, organizimi ose drejtimi	8	4	4
119/1	Fyerja	1	1	
120/1; 120/2	Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	5	2	3
257/a/1	Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë	6	3	3
328/1	Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	6	5	1
130	Dhunë në familje	1	1	
230, 232, 234; 234/a/2; 265/a/1	Pjesëmarrje në organizate terroriste" dhe "Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj".	3	2	1
Totali		135	78	57

Përgjatë vitit 2024, nga Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë marrë në shqyrtim 167 seanca paraprake, të pasqyruara në tabelën e poshtëshënuar.

Grafiku : Çështje penale të regjistruara gjithsej sipas dispozitave përkatëse penale të K.P. për vitin 2023.




Tabela : Disa prej çështjeve penale sipas llojit të vendimit për vitin 2024

Lloji i veprave penale sipas neneve	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Pushuar	Moskompetencë/ plotësim hetimesh
Vrasje për gjakmarrje; Vrasja me paramendim, e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje	3	-	-	-
Vrasje e funksionareve publik; Vrasje në rrethana të tjera cilësuese - kundër dy ose më shumë personave	2	-	-	-
Vjedhja; Vjedhja me dhunë; Vjedhja me armë	1	-	-	-
Mashtrim kompjuterik, ne bashkëpunim.	1	-	-	-
Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara; Falsifikimi i dokumenteve; Përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave të falsifikuara	2	-	-	-
Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	2	-	-	-
Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	9	-	-	1
Shpërdorimi i detyrës	2	-	-	3
Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	3	1	-	1
Korrupsioni pasiv i funksionareve te larte shtetërore ose i te zgjedhurve vendore, "Korrupsioni aktiv i funksionareve te larte, shtetërore ose i te zgjedhurve vendore", "Pastrimi i produkteve te veprës penale ose veprimtarisë kriminale, ne bashkëpunim, parashikuar nga nenet 260 e 25, 245, 287/2 e 25 te Kodit Penal.	1	-	-	-
Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	8	-	-	-
Trafikimi i narkotikëve, në bashkëpunim ose më shumë se një herë	9	-	-	-
Trafikimi i narkotikeve, Grup i strukturuar	3	-	-	-
Kultivimi i bimëve narkotike	1	-	-	-
Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me pasoja të rënda; Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, e dhënë për qëllime fitimi	2	-	-	-
Korrupsioni pasiv i gjyqtareve, prokuroreve dhe funksionareve te tjerë te organeve te drejtësisë	4	-	-	-
Grupi i strukturuar kriminal, krijimi, organizimi ose drejtimi	4	-	-	-
Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	-	-	2	-
Fyerja	-	1	-	-
Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	5	-	-	-
Pjesëmarrje ne organizate terroriste" dhe "Pjesëmarrja ne veprime luftarake ne një shtet te huaj", parashikuar nga nenet 234/a/2 dhe 265/a/1 te K.Penal	2	-	-	-
Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi,	3	-	-	-
Drejtimi i automjetit ne gjendje te dehur	-	-	-	1
Dhune ne familje	1	-	-	-
Totali	68	2	2	6

Lidhur me cilësinë e gjykimit të çështjeve të gjykuara në apel për vitin 2024

(i) Detajimi i vendimmarrjeve të GJAKKO, në lidhje me çështjet penale të themelit të ankimuara.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbi ankimin e palëve në proces ndaj 50 (pesëdhjetë) çështjeve penale të themelit, për 20 (njëzet) vendime ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimeve të GJKKO”, ndryshimin për 7 (shtatë) vendime, si dhe prishjen dhe kthimin për rigjykim për 1 (një) çështje penale, si më poshtë vijon:

1. Për 1 (një) çështje penale ka vendosur ndryshimin e kualifikimit të veprave penale.²⁵
2. Për 2 (dy) çështje penale ka vendosur prishjen e pjesshme të vendimit të GJKKO dhe pushimin e çështjes penale për disa nga akuzat, për të cilat GJKKO kishte vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve.²⁶
3. Për 2 (dy) çështje penale ka vendosur ndryshimin e kualifikimit të veprës penale dhe deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën tjetër penale për të cilën GJKKO ka shpallur pafajësinë.²⁷
4. Për 1 (një) çështje penale ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurve për veprat penale për të cilat GJKKO ka shpallur pafajësinë.²⁸
5. Për 1 (një) çështje penale, për një nga të pandehurit ka vendosur heqjen e aplikimit të nenit 59 të K.Penal, “*Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë*”, si dhe shuarjen e masës “arrest në shtëpi”, në zbatim të nenit 261, pika 1, shkronja c) të K.Pr.Penale.²⁹
6. Për 1 (një) çështje penale ka vendosur prishjen e vendimit të GJKKO-së dhe kthimin e akteve pranë kësaj gjykate me trup tjetër gjykues, në referim të nenit 248, pika 1, shkronja “ç” të K.Pr.Penale: “Kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen ... me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori ...”.³⁰

²⁵ Referuar vendimit nr. 25, datë. 24.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsonin dhe Krimin e Organizuar.

²⁶ Referuar vendimit nr. 46, datë. 06.11.2024 dhe nr. 47, datë 18.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsonin dhe Krimin e Organizuar.

²⁷ Referuar vendimit nr. 41, datë 07.11.2024 dhe nr. 32, datë 16.09.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsonin dhe Krimin e Organizuar.

²⁸ Referuar vendimit nr. 42, datë. 08.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsonin dhe Krimin e Organizuar.

²⁹ Referuar vendimit nr. 54, datë. 18.12.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsonin dhe Krimin e Organizuar.

³⁰ Referuar vendimit nr. 22, datë 04.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsonin dhe Krimin e Organizuar.

Tabelat e cilësisë së gjykimit të çështjeve të gjykuara në apel për vitin 2024

Çështje penale të ankimuara				
Përfunduar në gjykatën e Apelit				Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Mos pranim Ankimi	
20	7	1	2	20
Sasia 30				
Totali 50				

Çështje penale administrative- Viti 2024

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbi ankimin e palëve në proces ndaj 163 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre) vendimeve të dhëna nga GJKKO, në çështjet penale administrative, për 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) vendime ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimeve të GJKKO” dhe ndryshimin e 8 (tetë) vendimeve të GJKKO-së, si më poshtë vijon:

- a. Ndaj kërkesave penale me objekt: “Ankim kundër vendimit të prokurorit për mosfillim procedimi penal”, Gjykata e Posaçme e Apelit në 4 (katër) raste ka vendosur ndryshimin e vendimit të GJKKO-së, duke shfuqizuar plotësisht apo pjesërisht vendimin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për mosfillimin e procedimit penal, duke udhëruar Prokurorinë e Posaçme të kryejë veprimet e nevojshme proceduriale.³¹
- b. Ndaj kërkesave penale me objekt “Sekuestro preventive”, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në 2 (dy) raste ka mbajtur qëndrim ashpërsues, duke sekuestruar pasuritë, sipas kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, të cilat ishin rrëzuar nga GJKKO. Ndërsa, në 1 (një) rast Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit të GJKKO-së dhe kthimin e një pasurie shtetasit nën hetim.³²
- c. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 1 (një) kërkesë penale me objekt “Zgjatje afati paraburgimi” ka vendosur ndryshimin e vendimit të GJKKO-së dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme.³³

³¹ Vendimi nr. 220, datë 08.11.2024; nr. 242, datë 04.12.2024; nr. 160, datë 29.07.2024; nr. 245, datë 06.12.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
³² Vendimi nr. 28, datë 31.07.2024; nr. 93, datë 17.05.2024; nr. 67, datë 17.12.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
³³ Vendimi nr. 246, datë 10.12.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Çështje penale administrative të ankimuara				
Përfunduar në gjykatën e Apelit				Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Mospranim ankimi	
138	8	-	-	17
Sasia 146				
Totali 163				

(ii) Detajimi i vendimmarrjeve të GJAKKO, në lidhje me kërkesat për sekuestrim sipas ligjit sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009.

Në lidhje me kërkesat me objekt “Sekuestrim pasurie” sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së, duke pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme.³⁴

Kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim pasurie sipas aktit normativ dhe ligjit antimafia të ankimuara/OFL				
Përfunduar në gjykatën e Apelit				Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Shfuqizuar	
9	1	-	-	
10				2
12				

(iii) Detajimi i vendimmarrjeve të GJAKKO, në lidhje me masat e sigurimit të ankimuara

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbi ankimin e palëve në proces, ndaj 62 (gjashtëdhjetë e dy) vendimeve të dhëna nga GJKKO për vitin 2024, me objekt: “Caktim mase/Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi”, për 58 (pesëdhjetë e tetë) vendime, ka vendosur: “Lënien në fuqi e vendimeve të GJKKO” dhe ka ndryshuar 4 (katër) vendimeve të GJKKO-së, me ndryshimet e mëposhtme:

- Për 3 (tre) persona nën hetim është lehtësuar masa e sigurimit e vendosur nga GJKKO dhe 2 persona nën hetim janë lënë pa masë sigurimi, me arsyetimet, në mënyrë të përmbledhur, se: “Lidhur me kriteret e përshtatshmërisë së masës së sigurimit që duhet të caktohet, gjykata mban parasysh se nuk ka rrethana subjektive që të tregojnë se personi nën hetim paraqet rrezikshmëri shoqërore. Masa e sigurimit e caktuar nga GJKKO është

³⁴ Vendimi nr. 225, datë 13.11.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- e papërshtatshme në raport me rrethanat subjektive dhe objektive të personit/personave nën hetim”.³⁵
- Mbi ankimin e Prokurorit, për 1 (një) person nën hetim, pa masë sigurimi nga GJKKO, është caktuar masë sigurimi personal, me arsyetimet, në mënyrë të përmbledhur, se: “Referuar parimeve të proporcionalitetit dhe vlerësimit të përshtatmërisë, pra në seleksionimin e masës së sigurimit, gjyqtari duhet të vlerësojë përshtatmërinë e vetë masës siguroese në raport me kërkesat ruajtëse që në rastin konkret duhet të përballet. Individualizimi i masës së sigurimit duhet gjithnjë të bazohet në parimin e nevojshmërisë”³⁶.

A. “Zëvendësim/revokim/shuarje mase sigurimi”

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mbi ankimin e palëve në proces, ndaj 67 vendime të dhëna nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt: “Zëvendësim/revokim/shuarje mase sigurimi”, për 59 (pesëdhjetë e nëntë) vendime ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimeve të GJKKO” , si dhe ndryshimi i 6 (gjashtë) vendimeve të GJKKO-së”, me ndryshimet e mëposhtme:

- Për 3 persona nën hetim është lehtësuar masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues nga “arrest ne burg” në masën e sigurimit “arrest në shtëpi”.³⁷
- Për 3 persona nën hetim është ashpërsuar masa e sigurimit personal me karakter shtrëngues nga “arrest ne shtëpi” në masën e sigurimit “arrest në burg”³⁸

Masa Sigurimi të ankimuara			
Përfunduar në gjykatën e Apelit			Aktualisht në Apel
	Lënie në fuqi	Ndryshuar	
A	58	4	-
B	59	6	-
	117	10	-
Totali 127			

³⁵ Vendimin, nr.19, datë 16.05.2024, nr.21, datë 29.05.2024, nr.42, datë 18.09.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

³⁶ Vendimi nr. 32, datë 07.08.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

³⁷ Vendimi nr. 163, datë 31.07.2024, nr. 144, dt. 16.07.2024, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

³⁸ Vendimi nr. 152, datë 25.07.2024, nr. 229, datë 18.11.2024, nr. 135, datë 05.07.2024, nr.11, datë 29.02.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

PARAQITJE DHE ANALIZË E TREGUESVE STATISTIKORË NË VITE

Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2019

Nëpërmjet kësaj tabele paraqesim të dhënat për treguesit e ngarkesës në vite që nga krijimi i gjykatës për të kuptuar dhe mënyrën e evoluimit të natyrës së çështjeve penale në kompetencën e gjykatës sonë, si dhe për të pasqyruar ngarkesën e gjykatës.

Tabela: Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2019 nga ish Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda

Tërësia e çështjeve të trajtuara në vite																
Në vite	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Çështje Gjyqsore	140	141	123	124	145	136	111	118	130	171	221	234	211	190	183	142
Masa sigurimi	237	257	266	266	277	181	354	217	312	332	584	535	451	446	198	173
Kërkesa të tjera	96	294	587	550	577	656	926	661	782	901	1432	1473	1333	1755	1749	1591
Sekuestro Konfiskim		14	41	27	22	18	22	17	21	13	31	35	35	33	27	20
Seanca paraprake														49	138	134
Total	473	706	1008	967	1021	991	1413	1013	1245	1417	2268	2277	2030	2473	2295	2060

Tabela: Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2020-2024 nga GJKKO

Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2020 - 2024					
Viti	2020	2021	2022	2023	2024
Çështje Gjyqësore	96	149	139	134	135
Masa sigurimi	126	106	96	140	159
Kërkesa të tjera	1541	1737	1745	2443	3050
Sekuestro Konfiskim sipas ligjit Antimafia	30	43	35	49	65
Seanca paraprake	102	127	153	129	167
Sekuestro konfiskime sipas Aktit Normativ Nr.1, viti 2020	240	199	72	32	9
Total	2135	2361	2240	2927	3585

Siç rezulton nga përmbajtja e tabelave më sipër, volumi i punës të çështjeve të shqyrtuara në vitin 2024 janë në total 3585, e cila ka pësuar një rritje me 22.5%.

Tabelat e përmbledhura për vitin 2024 të vendimeve të sekuestrove dhe konfiskimeve.

Gjatë vitit 2024 janë dhënë tre vendime për konfiskim pasurie sipas ligjit antimafia, nga ku rezulton që është vendosur konfiskimi i pasurive të për 20 (njëzet) subjekte, si dhe janë dhënë 10 vendime për sekuestrim pasurie ndaj 190 subjekteve.

Ligji Antimafia	Nr. i kërkesave të mbartura nga 2023	Nr. i kërkesave të reja në 2024	Nr. i çështjeve me vendim në 2024		Nr. i kërkesave të mbartura në vitin 2025
Kërkesa për sekuestrim pasurie	-	11	11	- 10 Pranuar - 1 Rrëzuar	-
Kërkesa për konfiskim pasurie	11	9	4	- 3 Pranuar - 1 Shpallje moskompetencë	16
Kërkesa për zgjatje afati sekuestroje	-	14	14	-	-
Kërkesa për heqje / revokim sekuestroje	-	20	20	-	-
Totali	11	54	49		16

Tabela: Çështje të trajtuara në vitet 2023-2024 nga GJKKO në kuadër të Ligjit Antimafia ³⁹

Sekuestrike - Çështje Antimafia - Viti 2023							
Nr. i vendimeve në 2023	Subjekt e tregtare	Të ardhura monetare		Prona të paluajtshme		Prona të luajtshme	
		Llogari bankare	Vlera monetare cash	42 - Apartament	24 - Troje	Automjete	Motoçikleta etj.
9	17	27	304,000 EU	Me sip. totale 3351.7m ²	Me sip. totale 78,001m ²	26	1
			2,344,500 Lekë				
			500 paund & 50 Franga				

³⁹ Ne vitin 2024, janë për tu theksuar Vendimet me Nr. 08 Datë, 01.02.2024 dhe Nr. 16, Datë 22.04.2024 me ane të se cilave gjykata e Posaçme ka sekuestruar pasuri të konsiderueshme.

Sekuestrike - Çështje Antimafia - Viti 2024									
Nr. i vendimeve në 2024	Subjekte fizike	Subjektet tregtare	Të ardhura monetare		Prona të paluajtshme			Prona të luajtshme	
			Llogj bank	Vlera monetare cash	55 - Apartamente	18 - Troje	8 - Ara / 4- Pembre	Automjete	Motoçikleta etj.
11	20	11	404	13,677,455.23 €	Me sip. totale 7485.59m ²	Me sip. totale 840 m ²	Me sip. totale 72436 m ²	73	4
				9,627,439.5 Lekë					
				1,912,442.75 EQ	Vlera për 13 Ap. - 1,207,200 Euro	110,00 0€ - Pemëto re			
Konfiskime - Çështje Antimafia - Viti 2024									
Nr. i vendimeve në 2024			Të ardhura monetare		Prona të paluajtshme	Prona të luajtshme			
			Llogari bankare	Vlera monetare cash	16 - Apartamente	Automjete	Mjete lundruese		
3			8	707.150.78 EU	Me sip. totale 1407.28m ²	4	3		

Konfiskime - OFL - Viti 2024					
Nr. i vendimeve në 2024	Prona të paluajtshme			Prona të luajtshme	
	22 - Apartamente	4 - Troje	8 - Ara	Automjete	Motoçikleta etj.
5	Me sip. Totale 2566.95 m ²	Me sip totale 2520.5 m ²	Me sip totale 11546.58 m ²	7	3

Tabela: Konfiskime sipas vendimeve te themelit, bazuar në nenet 36/1 shkronja “b” të K. Penal dhe në nenin 190/1 shkronja “a” të K.Pr.Penale përgjatë vitit 2024⁴⁰

Konfiskime sipas vendime të themelit - Viti 2024						
Subjekt e tregtare	Të ardhura monetare	Prona të paluajtshme		Prona të luajtshme		
	Vlera monetare cash	Apartament e	4 - Ara	Automjet e	Mjete elektronike , smartphon e laptop etj.	Mjete luftarak e
1	32,395 €	1	Me sip. totale 66,821. 5 m²	4	4	5 Armë, 3 Krëhër, 82 Fishekë
	53,700 Lekë					
	2,970 Dinar RNM & 100 Franga					

Për vitin 2024, në GJKKO janë paraqitur 12 kërkesa për caktimin e masës se sigurimit pasuror, “Sekuestro preventive”. Nga këto kërkesa, GJKKO, bazuar në parashikimet e neneve 112, neneve 274-276 të K.Pr.Penale, neneve 30, pika 2 dhe 36 të Kodit Penal dhe Ligjit nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, janë pranuar 10 kërkesa, 1 (një) është rrezuar dhe 1 (një) është vendosur pushimi, për shkak të heqjes dore nga kërkuesi.

Tabela: Sekuestro Preventive

Shoqëri tregtare / Operatorë ekonomikë	Vlera monetare	Apartamente / Vila	Pasuri të paluajtshme / Njësi	Automjete	Llogari bankare / Asete / Kripto valuta
18	14,323,125.93 Leke	4 Ap - me sip. Totale = 1155 m2	22	4	9 - llogari
	15,542 EU				
	42,318.19 \$	4 Vila me sip. Totale = 837.94 m2			
	10 Paund				

⁴⁰ Referuar vendimeve: Nr. 14 Datë 05.03.2024; Nr. 19 Datë 19.03.2024, Nr. 20 Datë 25.03.2024; Nr. 42 Datë 01.07.2024; Nr. 56 Datë 09.10.2024; Nr. 59 Datë 16.10.2024; Nr. 61 Datë 18.10.2024; Nr. 67 Datë 06.11.2024; Nr. 72 Datë 05.12.2024

II. VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

1. VEPRIMTARIA E ORGANEVE DREJTUESE

Parimet themelore të aplikuara për organizimin e gjyqësorit mbështeten në parimin universal të pavarësisë gjyqësore. Në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, pavarësia e gjyqësorit kuptohet si *pavarësi substanciale*, që do të thotë “liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit”; *pavarësi strukturale* që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; *pavarësi organizative* që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave; *pavarësi financiare* që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit të shtetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e sovranitet në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara; si dhe *pavarësi personale*, që kërkon emërim në bazë të kriterëve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor.⁴¹ Gjithashtu, pavarësia e brendshme e pushtetit gjyqësor është po aq e rëndësishme sa edhe pavarësia e jashtme e tij. Një organizim hierarkik i gjyqësorit, përbën një cenim të pastër të këtij parimi.⁴²Pikërisht në respektim të parimit të pavarësisë organizative të gjykatave, me Ligjin Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar janë parashikuar organet drejtuese të gjykatave që merren me menaxhimin e brendshëm të saj, të cilat janë: **i)** Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtareve; **ii)** Këshilli i Gjykatës; **iii)** Kryetari i Gjykatës dhe Kancelari.

Më poshtë do të paraqitet puna e organeve drejtuese të GJKKO për vitin 2024.

1. MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E GJYQTARËVE

Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve mbledhet rregullisht dhe ushtron kompetencat e mëposhtme: a) zgjedh një gjyqtar si zëvendëskryetar me shumicën e votave nga radhët e gjyqtarëve të gjykatës; b) diskuton dhe jep mendim për raportin vjetor të gjykatës; c) diskuton çështje të natyrës juridike, vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e gjykatave të tjera, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktet e kontrollit dhe inspektimit të ushtruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe akte përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe çdo çështje tjetër në lidhje me gjykatën në tërësi; ç) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.⁴³Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve kontribuon në çështjet thelbësore që lidhen me veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës, dhe të organeve të saj drejtuese.

⁴¹ Shih vendimin Nr. 11, datë 06.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese.
⁴² Shih vendimin Nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese.
⁴³ Shiko nenin 40 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 5 (pesë) Mbledhje të Përgjithshme të Gjyqtarëve, të cilat kanë pasur për objekt diskutimi tema të tilla si: Përzgjedhja e temave të propozuara për trajnimin vazhdues nga Shkolla e Magjistraturës; Fillimi i procedurave për pajisjen e gjyqtarëve me certifikatë sigurie personeli; analiza vjetore e gjykatës për vitin 2023; zgjedhja e Zëvendëskryetarit të GJKKO-së; ndarja e trupave gjyquese; rishqyrtimi i procedurës së regjistrimit të letërporosive dhe ankimeve kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit.

Lidhur me ndarjen e trupave gjyquese, në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve është vlerësuar se caktimi dhe ndarja e trupave gjyquese, do të ishte jo efëcente, kjo referuar faktit që GJKKO mbetet e paplotësuar në organikën e saj, duke pasur aktualisht 11 gjyqtarë nga 16 të tillë dhe nëse do bëhej kjo ndarje me trupa gjyquese të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë, 2 (dy) prej gjyqtarëve të GJKKO-së nuk do të përfshiheshin dot në një trupë gjyquese treshe. Për këtë arsye në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve u çmua e arsyeshme që kjo ndarje të bëhej në një moment të dytë.

2. KËSHILLI I GJYKATËS

Në çdo gjykatë ngrihet dhe funksionon Këshilli i Gjykatës. Këshilli i Gjykatës përbëhet nga tre anëtarët e mëposhtëm, a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës dhe c) kancelari i gjykatës. Në rastet kur Këshilli i Gjykatës vendos për çështje të tjera të ndryshme nga ato disiplinore në lidhje me kancelarin, ai përbëhet nga: a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës; c) gjyqtari i renditur më pas, i zgjedhur në përputhje me parashikimet e nenit 26, pika 5, të Ligjit nr. 98/2016. Në rastet kur Këshilli i Gjykatës vepron si komision disiplinor në procedimin ndaj nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, ai përbëhet nga: a) kryetari i gjykatës, i cili vepron si kryetar i Këshillit të Gjykatës; b) zëvendëskryetari i gjykatës; c) një nëpunës i lartë civil gjyqësor i Këshilli të Lartë Gjyqësor, i caktuar nga ky i fundit. Këshilli i Gjykatës ka kompetencat e mëposhtme: a) miraton përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve të shërbimit civil gjyqësor dhe punonjësve të gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe kriteret e vendit të punës; b) merr vendime në lidhje me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç përcaktohet në këtë ligj; c) miraton strukturën dhe organikën e administratës së gjykatës, sipas modelit të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dhe në raste të veçanta i përshtat me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë; ç) miraton strukturën e gjykatës dhe cakton gjyqtarët në seksione dhe trupa gjyqes pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, duke ndjekur rregullat e përgjithshme të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; d) shqyrton ankesa në lidhje me çështje të infrastrukturës së gjykatës, shërbimet ndihmëse në gjykatë dhe çështje të tjera që nuk lidhen me ushtrimin e detyrave të administratës gjyqësore dhe i raporton Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi ankesat dhe masat e marra në përputhje me rregullat e

miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; dh) vlerëson dhe shqyrton projektbuxhetin e përgatitur nga nëpunësi i financës përpara paraqitjes në Këshillin e Lartë Gjyqësor; e) jep informacion, mendime ose raporte të kërkuara nga institucione shtetërore sipas ligjit; ë) bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor për çështje që lidhen me formimin fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve dhe nëpunësve civilë gjyqësorë; f) organizon rregullisht takime me përdoruesit e gjykatës për rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së drejtësisë; g) miraton rregulla të veçanta të gjykatës për çështje të ruajtjes dhe sigurisë në gjykatë; gj) ushtron detyra të tjera të caktuara me ligj.⁴⁴

Këshilli i Gjykatës pranë GJKKO përbëhet nga Zv/Kryetari i gjykatës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit z. Erjon Bani në kushtet kur vendi i kryetarit është vakant, nga gjyqtari vijues me numrin më të madh të votave në mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve për zgjedhjen e Zv/Kryetarit, z. Erjon Çela dhe Kancelari i gjykatës z. Saimir Shyti.

Gjatë muajit qershor 2024 Këshilli i Gjykatës shqyrtoi këto çështje: **1)** Rishikimin e strukturës dhe organigramës të Gjykatës të miratuar me vendimin nr. 6, datë 07.07.2023 të Këshillit të Gjykatës, me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në dokumentin “Auditim Përputhshmërie” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Janar 2024 lidhur me numrin e punonjësve për njësitë strukturore/sector apo drejtori, si dhe për ta përshtatur me nevojat e veçanta të gjykatës; **2)** Analizimin e statusit të pozicioneve të punës “Nëpunës gjyqësor” dhe “Specialist të Shërbimeve Mbështetëse” në përputhje me kuadrin ligjor që ka rregulluar statusin e tyre ndër vite, për të konkluduar më pas nëse duhet të marrin statusin e nëpunësit gjyqësor civil. Në këtë rast Këshilli i Gjykatës mbajti në konsideratë jo vetëm kuadrin ligjor kushtetues mbi “pavarësinë organizative të gjykatave” por edhe përgjigjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me shkresën Nr. 6526/1 Prot., datë 28.12.2023, ku është theksuar se është në kompetencën e Këshillit të Gjykatës për të vlerësuar nëse një punonjës i gjykatës i plotëson kushtet apo jo për të marrë statusin e nëpunësit civil gjyqësor; **3)** Shqyrtimin e kërkesës së disa punonjësve të GJKKO mbi zbatimin e gabuar të kategorisë së pagës si dhe analizimin kryesisht nga Këshilli i Gjykatës nëse nëpunësit gjyqësor civil dhe punonjësit e tjerë të gjykatës marrin kategorinë e pagës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Pasi shqyrtoi çështjet e mësipërme me vendimin **nr. 7, datë 13.06.2024** “Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 07.07.2023, “Për miratimin e Strukturës dhe Organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe për miratimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për

⁴⁴ Shih nenet 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, Këshilli i Gjykatës i GJKKO morri vendim për çështjes si vijon:

(i) Miratimin e strukturës, organigramën dhe përshkrimet e punës për të gjithë nëpunësit civil gjyqësor.

Këshilli i Gjykatës në ndryshimin e strukturës së gjykatës mbajti në konsideratë dokumentin Raport Auditimi “Auditim Përputhshmërie” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Janar 2024 të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në faqen 131 të Raportit të Auditit ndër të tjera citohet: “7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organike në Këshillat e Gjykatave rezultoi se. 7.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Këshilli i Lartë Gjyqësor/Drejtoria e Burimeve Njerëzore që në bashkëpunim me Këshillat e Gjykatave, të plotësohen vendet vakante në administratën gjyqësore, ku për njësitë strukturore/sector apo drejtori, të respektohet numri i parashikuar në VKM Nr. 893, datë 17.12.2014, pika 22, duke i përshtatur ato dhe me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë.”.

Në strukturën e GJKKO, Këshilli i Gjykatës konstatoi se Sektori i Protokoll/Arkive përbëhet nga Shefi i Sektorit dhe një Specialist Arkiv/Protokoll. Kjo bën që të mos plotësohet standardi numerik për krijimin e sektorit sipas VKM-së Nr. 893, datë 17.12.2014, i cili duhet të ketë një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Ndodhur në këto kushte, Këshilli i Gjykatës duke e konsideruar të rëndësishëm këtë sektor për funksionimin normal të gjykatës, çmoi të suprimojë një vend sekretar gjyqësor, i cili është vakant për shkak të emërimit të sekretares gjyqësore znj.D. D në pozicionin e punës “Specialist Statistike” dhe të krijojë pozicionin “Specialist Protokoll”. Këto dy pozicione kanë të njëjtën kategori page IV-1. Nëpërmjet kësaj vendimmarrje nuk ndryshon numri total i punonjësve dhe arrijnë të krijohet sektori në përputhje me kuadrin ligjor duke pasur: i) një pozicion “Shef sektori Protokoll/Arkive”; ii) një pozicion “Specialist Protokoll” dhe iii) një pozicion “Specialist Arkive”.

Gjithashtu, në strukturën e Gjykatës, Këshilli i Gjykatës konstatoi se Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar përbëhet nga një “Drejtore Drejtorie”, një “Specialist Buxheti/Finance” dhe një “Magaznier”, pra tre punonjës. Kjo bën që të mos plotësohet standardi numerik për krijimin e “Drejtorisë” sipas VKM-së Nr. 893, datë 17.12.2014, i cili duhet të ketë minimumi 5 (pesë) punonjës ose të paktën dy sektorë. Në rastin konkret, Këshilli i Gjykatës çmoi se, është në kushtet e pamundësisë për zbatuar rekomandimin e KLSH-së me ndryshimin e strukturës aktuale për këtë drejtori. Për të zbatuar këtë rekomandim me vendimin Nr. 1, datë 08.04.2024 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm për vitet 2025 – 2027” të Këshillit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar i është kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor shtim punonjësish për Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Me shtimin e personit do të reflektohet në strukturën organizative të gjykatës.

Nga Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ende nuk ishin miratuar përshkrimet e punës për të gjitha kategoritë e nëpunësve

të shërbimit civil gjyqësor, pasi nga Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka pasur një vendimmarrje për Gjykatat e Posaçme. Pavarësisht këtij fakti **me emailin e datës 23.04.2024** nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është përcjellë informacioni si më poshtë vijon: “*Lidhur me përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësi, bashkëlidhur, ju përcjellim vendimin nr. 148/2023 "Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi", vendim i cili merret si referencë dhe model, për atë që është i zbatueshëm për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si gjykatë e kategorisë së parë.*”.

Këshilli i Gjykatës në hartimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u mbështet në vendimin nr. 148/2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi” të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu, në respektim të parimit të pavarësisë organizative të gjykatave, Këshilli i Gjykatës, bazuar në nenin 38 germa “a”, “b” dhe “c” të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përshtati përshkrimet e punës me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë, konkretisht për pozicionet e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore” dhe “specialist pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve”, të cilët hynë në kategorinë e nëpunësve civil gjyqësorë.

(ii) Shqyrtoi ankesat për zbatimin e gabuar në përcaktimin e kategorisë së pagës dhe shtesave për vështirësi në punës e për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin të disa punonjësve të gjykatës.

Këshilli i Gjykatës çmoi se për pozicionin e punës “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist” pranë gjykatave të kategorisë së parë, ku bën pjesë dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është përcaktuar më shumë sesa një klasë page. Për të përcaktuar klasën e pagës VKM-ja Nr. 325, datë 31.5.2023 thekson se klasat e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së secilit institucion, që në rastin konkret është kompetencë e Këshillit të Gjykatës. Për këtë arsye, Këshilli i Lartë Gjyqësor në shkresën Nr. 4622/3 Prot., datë 28.07.2023, me lëndë “Mbi ndryshimin e strukturës dhe nivelit të pagave për Administratën Gjyqësore”, i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar që të marrë masa të miratoi klasat e pagave për të gjithë punonjësit duke u mbështetur në VKM-në Nr. 325, datë 31.5.2023 dhe VKM-në nr. 326, datë 31.05.2023, duke garantuar kështu pavarësinë organizative të çdo gjykate të elaboruar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Këshilli i Gjykatës çmoi se për pozicionin e punës “*Shef Sektori, në Sektorin Protokoll/Arkivës*” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet të aplikohet klasa e pagës **III-1**, sipas lidhjes 6/1 të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023, ndërsa për pozicionin e punës “*Specialist Protokoll/arkive*” çmon se duhet të aplikohet klasa e pagës **IV-1**, sipas lidhjes 6/1 të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023. Kjo për këto arsye:

Së pari, roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. E konsideruar nga ligjvënësi si pjesë integrale e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe e interpretuar në jurisprudencën kushtetuese si pjesë organizative dhe funksionale e këtij pushteti, administrata gjyqësore gëzon të njëjtën mbrojtje po njëllor siç parashikohet për pushtetin gjyqësor.⁴⁵ Kjo merr një vlerë në veçantë kur bëhet fjalë për institucionet e luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, ku bën pjesë dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, Këshilli i Gjykatës për përcaktuar nivelin e trajtimit financiar të punonjësve të institucioneve për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, mban në konsideratë qëllimin e ligjvënësit në relacionin dhe raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut që shoqëroi miratimin e Ligjit Nr. 47/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, ku ndër të tjera arsyetohet se, nisur nga detyra që kryejnë punonjësit e këtyre institucioneve, sistemi i pagave e shpërblimeve dhe kujdesi social e shëndetësor për ta duhet t’i përgjigjet domosdoshmërisë së trajtimit financiar adekuat dhe dinjitoz të tyre. Paga dhe trajtimi financiar i tyre mban parasysh dinjitetin e detyrës e të profesionit, natyrën e përgjegjësisë të funksionit, shkallën e vështirësive në përmbushjen e tij, numrin e larte të papajtueshmërive, ndalimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligj, nevojën për t’u mbrojtur nga presionet dhe ndikimet në veprimtarinë e tyre, si edhe nevojat e integritetit social të tij dhe familjes në shoqëri. Trajtimi dinjitoz financiar i këtyre strukturave synon që t’i shërbejë: - garantimit të pavarësisë dhe objektivitetit të personelit gjatë kryerjes së detyrës; - trajtimit dinjitoz të tij duke marrë në konsideratë shkallën e lartë të vështirësisë së punës së kryer dhe të nevojës për shmangien e ndikimeve të paligjshme mbi ta; nevojës për të nxitur të gjithë ata kandidatë që do të stepeshin për t’u bërë pjesë e personelit të këtyre institucioneve për shkak të kufizimit të së drejtës së privatësisë së personelit dhe familjarëve të tyre; shpërblimit të personelit dhe familjarëve të tyre që do të gjendet përballë monitorimit të vazhdueshëm të komunikimeve dhe llogarive bankare të tyre. Është detyrë e Këshillit të Gjykatës që në interpretimin e kuadrit ligjor përfshirë këtu dhe aplikimin e klasës së pagave të mbajë në konsideratë qëllimin e ligjvënësit si interpretuesi origjinal i normës juridike.

⁴⁵ Shiko vendimin nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Së dyti, Këshilli i Gjykatës çmoi se për të përcaktuar nivelin e trajtimit financiar të punonjësve të kësaj gjykate, mban në konsideratë detyrimet që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë nga instrumentet ndërkombëtar të ratifikuara. Kështu, mbështetur në nenin 20 të **Konventës Penale për Korrupsionin**⁴⁶ dhe në nenin 36 të **Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit**⁴⁷ rezulton se punonjësit që punojnë në institucionet kundër korrupsionit duhet të kenë trajtim financiar të posaçëm për t’i mbrojtur nga presionet dhe ndikimet e paligjshme në veprimtarinë e tyre. Pra, kjo kategori punonjësish duhet të ketë pavarësi financiare dhe një pagë që i përgjigjet dinjitetit të detyrës e të profesionit. Gjithashtu, në nenin 9 të **Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar** dhe dy protokolleve shtesë të saj⁴⁸, nën titullin “**Masat kundër korrupsionit**” parashikohet shprehimisht se: “1. *Përveç masave të parashikuara në nenin 8 të kësaj Konvente, secili Shtet Palë duhet të adaptojë, në masën e duhur dhe në pajtim me sistemin e tij ligjor, masa legislative, administrative ose masa të tjera efektive për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar korrupsionin e zyrtarëve publikë. 2. Secili Shtet Palë duhet të marrë masa për të siguruar veprimtarinë efektive të autoriteteve të tij në parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e korrupsionit të zyrtarëve publikë, përfshirë dhënien e pavarësisë së duhur këtyre autoriteteve, me qëllim ndalimin e përpjekjeve për të influencuar në mënyrë të padrejtë në aktivitetin e tyre.*” Pra, sipas kuadrit ligjor ndërkombëtar që është bërë pjesë e rendit tonë të brendshëm juridike vihet theksi tek pavarësia e institucioneve që merren me luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Prandaj, kërkohet nga shtetet palë që të tregohet kujdes i veçantë në trajtimin e tyre financiar me qëllim ndalimin e përpjekjeve për të influencuar në mënyrë të padrejtë në aktivitetin e tyre.

Së treti, rezulton se Kushtetuta i ka dhënë Gjykatave të Posaçme, Prokurorisë së Posaçme dhe Njësisë së Posaçme Hetimore (Byroja Kombëtare e Hetimit) një personalitet juridik kushtetues, duke e njohur kompetencën kushtetuese për gjykimin dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës. Pra, këto institucione bëjnë pjesë në kategorinë e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, veprimtaria e të cilëve rregullohet me Ligjin Nr. 95/2026 “Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar. Natyra e punës në këto institucione është e njëjtë, kanë të njëjtën lëndë dhe të njëjtin personalitet kushtetuese. Për rrjedhojë në respektim të parimit të barazisë përpara ligjit, Këshilli i Gjykatës çmon se edhe trajtimi financiar i punonjësve të këtyre institucioneve që kryejnë të njëjtën detyrë duhet t’i përgjigjet të njëjtës kategori page. Gjithashtu, Këshilli i Gjykatës çmon se, punonjësit e administratës gjyqësore pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duhet minimalisht të trajtohen njësoj me të njëjtën kategori page për pozicion pune me gjykatat e kategorisë së

⁴⁶ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8778, datë 26.04.2001.

⁴⁷ Ratifikuar me Ligjin Nr. 9492, datë 13.03.2006.

⁴⁸ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8920, datë 11.7.2002

parë të miratuar me vendimin Nr. 147, datë 29.03.2023 “PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË GJYKATAVE”, Këshilli i Lartë Gjyqësor. Nga verifikimet e bëra nga Këshilli i Gjykatës rezultoi se: **i)** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; **ii)** Byroja Kombëtare e Hetimit; **iii)** Gjykata e Lartë; **iv)** Gjykata Administrative e Apelit; **v)** Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; **vi)** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë,⁴⁹ për pozicionin e punës “*Shef Sektori, në Sektorin Protokoll/Arkivës*” dhe “*Specialist Protokoll/arkive*” aplikojnë përkatësisht klasën e pagës **III-1** dhe **IV-1** sipas VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023. Po ashtu, të njëjtën kategori page për këto pozicione punë kanë edhe disa institucione të tjera të parashikuara në kushtetutë si: Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës.

(iii) Lidhur me klasifikimin e pagave për punonjësit mbështetës pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Këshilli i Gjykatës konstatoi se, për punonjësit mbështetës pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është duke u zbatuar pika 1, germa “b” e VKM-së Nr. 326, datë 31.05.2023 “*Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike*”. Pra, kjo dispozitë është interpretuar duke e konsideruar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si institucion varësie i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për këto arsye, pranë kësaj gjykate për klasifikimin e pagave po zbatohet lidhja II, Kreu II/1 i VKM-së Nr. 326, datë 31.05.2023 për të gjithë punonjësit mbështetës.

Ndodhur në këto kushte, Këshilli i Gjykatës analizoi nëse Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mund të konsiderohet institucion varësie i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nëse kjo gjykatë mund të konsiderohet një institucion i nivelit rajonal apo vendor. Për t’i dhënë zgjidhje kësaj situate faktike-jurike, Këshilli i Gjykatës mbajti në konsideratë jurisprudencën kushtetuese lidhur me interpretimin e parimeve kushtetuese, ku bën pjesë dhe parimi i pavarësisë së gjyqësorit dhe parimet e interpretimit të normave juridike.

Mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Gjykatës çmoi se, pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave në dhënien e drejtësisë, e garantuar nga Kushtetuta, duhet të mbrohet dhe të mos cenohet nga ligjet dhe aktet e tjera ligjore. Roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor. E konsideruar nga ligjvënësi si pjesë integrale e organizimit dhe funksionimit të pushtetit gjyqësor dhe e

⁴⁹ Kjo parashikohet shprehimisht në Aneksin A/1 të vendimit Nr. 298, datë 30.05.2023 “*Mbi miratimin e rregullave standarde për organigramën dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisve të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për këtë gjykatë është vetë KLGJ-ja që ka orientuar që klasa e pagës do të jetë me e larta në kategori që parashikon VKM-ja Nr. 325, datë 31.5.2023.

interpretuar në jurisprudencën kushtetuese si pjesë organizative dhe funksionale e këtij pushteti, administrata gjyqësore gëzon të njëjtën mbrojtje po njëjllë siç parashikohet për pushtetin gjyqësor.⁵⁰ Gjithashtu, pavarësia e brendshme e pushtetit gjyqësor është po aq e rëndësishme sa edhe pavarësia e jashtme e tij. Një organizim hierarkik i gjyqësorit, përbën një cenim të pastër të këtij parimi. Pra, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese gjykatat nuk veprojnë sipas parimit të varësisë hierarkike në raport me Këshillin e Lartë Gjyqësor, pasi kjo do të cenonte në thelb pavarësinë e brendshme të pushtetit gjyqësor. Ndodhur në këto kushte, Këshilli i Gjykatës çmoi se, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk kualifikohet si “*institucion varësie apo degë territoriale e Këshillit të Lartë*” në kuptim të parimit të pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të gjyqësorit eleboruar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, Këshilli i Gjykatës çmon se, çdo dispozitë e akteve ligjore dhe nënligjore duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme. Po ashtu, Këshilli i Gjykatës çmon të theksoj se, Këshilli i Ministrave në miratimin e akteve nënligjore që lidhen me pagat e administratës gjyqësore, ka mbajtur në konsideratë respektimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit (pavarësia e brendshme), duke mos i klasifikuar gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit si institucione varësie të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë përfundim arriti Këshilli i Gjykatës duke bërë interpretimin literal, logjik dhe sistematik të dispozitave të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023. Nga analiza e pikës 1, germa “a” dhe pikës 6/1 dhe 11 të kësaj VKM-je, Këshilli i Gjykatës, arriti në përfundimin se nëse Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë do të konsideroheshin si degë territoriale apo institucione varësie të Këshillit të Lartë Gjyqësor, atëherë në pikën 1, germa “a” të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023 nuk do të përmendeshin gjykatat por do të përmendesh vetëm Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe nuk do të parashikohej lidhja nr. 7/1 e pagave për pozicionet e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë. Në këtë rast pozicionet e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, do përmendeshin vetëm në lidhjen nr. 12 të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023.

Gjithashtu, Këshilli i Gjykatës çmoi se, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatave të Posaçme, një personalitet juridik kushtetues, duke i njohur kompetencën kushtetuese për gjykimin e çështjeve që lidhen me veprat penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës. Pra, këto institucione hynë në kategorinë e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, veprimtaria e të cilëve rregullohet me Ligjin Nr. 95/2026 “*Për organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”, i ndryshuar. Gjithashtu, në bazuar nenin 11 të Ligjit Nr. 98/2016 “PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, i

⁵⁰ Shiko vendimin nr. 10, datë 6.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

ndryshuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar organizohet dhe funksionon për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, për rrjedhojë nuk ka sens logjik dhe juridik të kualifikohet institucion i administratës shtetërore apo institucion i pavarur, në nivel rajonal/vendor në kuptim të pikës 1, germa “b” të VKM-së Nr. 326, datë 31.05.2023.

Sa më sipër u arsyetua, Këshilli i Gjykatës çmoi se, për punonjësit mbështetës pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet aplikuar pika 1, germa “a” e VKM-së Nr. 326, datë 31.05.2023, *“Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”*, pra duhet trajtohen me sistemin e pagës bazë për klasë, sipas lidhjes I të këtij vendimi dhe jo sipas lidhjes II sikurse është zbatuar që nga fillimi i funksionimit të kësaj gjykate. Gjithashtu, për të përcaktuar pozicionet e përgjithshme të punës për çdo klasë të punonjësve mbështetës pranë kësaj gjykate, Këshilli i Gjykatës çmoi se, duhet zbatuar Kreu I/1 i VKM-së Nr. 326, datë 31.05.2023 dhe jo Kreu II/1 i kësaj VKM-je.

(iv) Lidhur me analizimin e statusit të pozicioneve të punës “Nëpunës gjyqësor” dhe “Specialist të Shërbimeve Mbështetëse” në përputhje me kuadrin ligjor që ka rregulluar statusin e tyre ndër vite.

Këshilli i Gjykatës pasi analizoi kuadrin ligjor çmoi se pozicioni i punës “Nëpunës gjyqësor” ka plotësuar dhe plotëson kushtet për t’u konsideruar pjesë e shërbimit civil gjyqësor, për rrjedhojë punonjësit që janë rekrutuar me arsim të lartë për këtë pozicion pune, konsiderohen për efekt të akteve ligjore dhe nënligjore ndër vite si dhe ato në fuqi “Nëpunës civil gjyqësor”. Kështu, nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi duke respektuar rreptësisht vendimet dhe urdhrat e nxjerra nga gjyqtarët brenda kompetencave të tyre gjyqësore. Gjithashtu, nëpunësi gjyqësor është pjesë e shërbimeve gjyqësore, pra pjesë e shërbimeve gjyqësore të gjykatës dhe gjatë ushtrimit të detyrës ai bashkëpunon me kryesekretarin gjyqësor dhe sekretarin gjyqësor. Pra, nëpunësi gjyqësor nuk ka qenë asnjëherë pjesë e shërbimeve mbështetëse si strukture apo pjesë e zyrës administrative. Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëpunësi gjyqësor kryen të njëjtat funksione që kanë kryer që prej vitit 2001. Në kuadrin e interpretimit historik të legjislacionit që ka rregulluar statusin e administratës gjyqësore, konkretisht sipas Ligjit Nr. 109/2013 “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, nëpunësi gjyqësor kryen detyra procedurale dhe detyra të tjera me natyrë administrative, të përcaktuara në legjislacionin procedural gjyqësor në fuqi, sipas parimeve të ligjshmërisë, paanshmërisë, si edhe të unitetit të veprimit e të varësisë hierarkike.

Në respektim të parimit të ligjshmërisë, parimit të drejtësisë dhe e paanësisë, parimit të objektivitetit dhe parimit të marrjes së vendimeve, i cili duhet të udhëheq organin publik në ushtrimin e funksioneve të tij, Këshilli i Gjykatës, mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, çmon

se, pozicioni i punës “Nëpunës gjyqësor” që në interpretim të gabuar të kuadrin ligjor është konsideruar si punonjës administrative apo mbështetës, duhet të trajtohet si pozicion pune, pjesë e shërbimit civil pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke u konsideruar këta punonjës si “Nëpunës civil gjyqësor”. Gjithashtu, me qëllim harmonizimin e emërtimeve të pozicioneve të punës pranë kësaj gjykate me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, konkretisht VKM -në Nr. 325, datë 31.05.2023 që parashikon klasat e pagave vetëm për kategorinë e punonjësve “Kancelar”, “Drejtore Drejtorie me funksion nëpunës zbatues”, “Ndihmës ligjor”, “Drejtore i drejtorive mbështetëse”, “Kryesekretar”, “Përgjegjës/Shef sektori”, “Sekretar gjyqësor” dhe “Specialist”, Këshilli i Gjykatës çmoi se duhet ndryshuar emërtimi i pozicionit të punës nga “Nëpunës Gjyqësor” në “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”. Po ashtu, duke qenë se natyra e punës që kryejnë aktualisht “Nëpunësit gjyqësorë” lidhet drejtpërdrejtë me shërbimet gjyqësore, në strukturën e re, “Nëpunësit gjyqësorë”, duhet të transferohen pranë shërbimeve gjyqësore e cila duhet të përbëhet nga: **1) Kryesekretaria; 2) Sekretarët gjyqësorë; dhe 3) Specialistët e Shërbimeve Gjyqësore.** Ndërkohë, për pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore” pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet të aplikohet klasa e pagës **IV-1**, sipas lidhjes 6/1 të VKM-së Nr. 325, datë 31.5.2023.

Gjithashtu, Këshilli i Gjykatës pasi analizoi kuadrin ligjor çmoi se pozicioni i punës “specialist pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve”, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka plotësuar dhe plotëson kushtet për t’u konsideruar pjesë e shërbimit civil gjyqësor, për rrjedhojë punonjësit që janë rekrutuar me arsim të lartë për këtë pozicion pune, konsiderohen për efekt të akteve ligjore dhe nënligjore ndër vite si dhe ato në fuqi “Nëpunës civil gjyqësor”. Për këto arsye, në strukturën e re këta punonjës duhet të kategorizohen si pjesë e shërbimeve mbështetëse që ushtrohen nga “Nëpunës civilë gjyqësorë”.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2024 Këshilli i Gjykatës është mbledhur dhe ka marrë gjithsej 18 Vendime. Konkretisht:

- Vendimi nr. 1, datë 08.04.2024** “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitet 2025 – 2027”.
- Vendimi nr. 2, datë 07.05.2024** “Për miratimin e modelit të Formularit të Ankesës së nëpunësit Civil Gjyqësor”.
- Vendim nr. 3, datë 13. 06. 2024** “Për revokimin e vendimit të Këshillit nr. 23, datë 14.12.2023 “Për rezultatet e konkurrimit sipas procedurës së lëvizjes paralele për kategorinë ekzekutive Specialist për Statistikat Gjyqësore, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”.
- Vendim nr. 4, datë 13. 06. 2024** “Për emërimin e përkohshëm të znj. Dila Doçi, në detyrën “Specialist për Statistikat Gjyqësore”, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave dhe Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”.

5. **Vendim nr. 5, datë 13.06.2024** “Për revokimin e vendimit të Këshillit nr. 19, datë 13.11.2023 “Për emërimin e znj. Çiljeta Prifti, për një periudhë prove 1 vjeçare, në detyrën e “Drejtor, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.
6. **Vendim nr. 6, datë 13.06.2024** “Për emërimin e përkohshëm të znj. Çiljeta Prifti, për një periudhë prove 1 vjeçare, në detyrën e “Drejtor, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
7. **Vendimi nr. 7, datë 13.06.2024** “Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 07.07.2023, “Për miratimin e Strukturës dhe Organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe për miratimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.
8. **Vendim nr. 8, datë 13.06.2024** “Për caktimin përkohësisht të z. Elton Sulollari, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
9. **Vendim nr. 9, datë 13.06.2024** “Për caktimin përkohësisht të z. Adonis Mema, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
10. **Vendim nr. 10, datë 13.06.2024** “Për caktimin përkohësisht të z. Ardi Treska, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
11. **Vendim nr. 11, datë 13.06.2024** “Për caktimin përkohësisht të z. Griselt Marku, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Gjyqësore”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
12. **Vendim nr. 12, datë 13.06.2024** “Për caktimin përkohësisht të z. Petrit Meçani, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Mbështetëse”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
13. **Vendim nr. 13, datë 13.06.2024** “Për caktimin përkohësisht të z. Ilia Koçollari, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Shërbimeve Mbështetëse”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
14. **Vendim nr. 14, datë 13.06.2024** “Për caktimin përkohësisht të z. David Nikaj, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i

Shërbimeve Mbështetëse”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

15. **Vendimi nr. 15, datë 15.07.2024** “Për transferimin e përhershëm të znj. Dinora Aleksi, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Protokollit”, në Sektorin e Protokoll/Arkivit”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
16. **Vendimi nr. 16, datë 15.07.2024** “Për transferimin e përkohshëm të znj. Elsa Lita, për të ushtruar detyrën e “Nëpunësit Civil Gjyqësor”, në pozicionin e punës “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
17. **Vendimi nr. 17, datë 15.07.2024** “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm për vitet 2025 – 2027 faza e dytë, teknike”.
18. **Vendimi nr. 18, datë 16.07.2024** “Për caktimin e pikës së kontaktit me Këshillin e Lartë Gjyqësor për monitorimin dhe zbatimin e planit të komunikimit”.

3. KRYETARI

Kryetari i gjykatës ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor dhe ushtron këto detyra: a) përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët; b) në fillim të çdo viti miraton një listë, e cila përditësohet kur është e nevojshme, që përcakton gjyqtarët për gjykimet e rasteve urgjente, siç përcaktohet me ligj, sipas rendit alfabetik me bazë mbiemrin, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; c) mban kontakt me grupet e kontrollit të institucioneve të tjera shtetërore, njihet me qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijon atyre mundësi për ushtrimin e detyrës; ç) mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore dhe të solemnitetit, si dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve; d) mbikëqyr disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe kërkon fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre; dh) kujdeset për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jogjyqësore nëpërmjet kancelarit, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj; e) thërret, përgatit dhe drejton mbledhjet e përgjithshme të gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj; ë) udhëzon dhe mbikëqyr kancelarin; f) verifikon ankesat, heton shkeljet disiplinore dhe propozon fillimin e procedimit disiplinor ndaj kancelarit; g) kryen veprimet dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë, siç parashikohet në këtë ligj; gj) garanton zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në veçanti në lidhje me masat që kanë për qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve gjyqësore; h) garanton qasjen dhe mënyrën e përdorimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë së informacionit dhe rregullave të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; i) ushtron çdo detyrë tjetër që lidhet me

veprimtaritë jogjyqësore të gjykatës, siç përcaktohet me ligj ose vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.⁵¹

Më 25 Mars 2024 u zhvillua mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, me rend dite “Zgjedhja e Zv/Kryetarit të GJKKO-së”, në kushtet që gjyqtarës Irena Gjoka i përfundonte mandatit 3 vjeçar si Zv/Kryetare e kësaj gjykate. Në këtë mbledhje, në përfundim të procesit të votimit, gjyqtari Erjon Bani u zgjodh me shumicë votash në detyrën e Zv/Kryetarit të gjykatës.

Gjatë vitit 2024, Zv/Kryetarja, Znj. Irena Gjoka dhe Zv/Kryetari, Z. Erjon Bani kanë udhëhequr dhe mbikëqyrur realizimin e një sërë masash të rëndësishme organizative dhe administrative, që kanë kontribuar në funksionimin e suksesshëm të këtij institucioni.

Në kuadër të menaxhimit të brendshëm të gjykatës, Zv/Kryetarët kanë nxjerrë 306 (treqind e gjashtë) urdhëra, të cilët përfshijnë: 130 (njëqind e tridhjetë) urdhëra formim trupi gjykues/kalim për shqyrtim; 15 (pesëmbëdhjetë) urdhëra ngritje grupe pune për mbarëvajtjen e institucionit; 100 (njëqind) urdhëra të karakterit ekonomik; 9 (nëntë) urdhëra për Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës; 52 (pesëdhjetë e dy) urdhëra të natyrës administrative.

Po ashtu, gjatë këtij viti Zv. Kryetarët kanë dhënë: 61 (gjashtëdhjetë e një) vendime mbi kërkesat e gjyqtarëve për heqje dorë nga gjykimi, nga të cilat në 49 (dyzet e nëntë) raste është pranuar kërkesa për heqje dorë dhe 12 (dymbëdhjetë) raste nuk është pranuar kërkesa për heqje dorë; 11 (njëmbëdhjetë) vendime për mbarëvajtjen administrative të Gjykatës dhe 59 (pesëdhjetë e nëntë) vendime për dhënie leje.

Në ndryshim nga viti i kaluar, në vitin 2024 Zv/Kryetari i Gjykatës në funksion të rritjes së efijencës dhe balancimit të ngarkesës së punës, i ka deleguar Kancelarit⁵², kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor, për kryerjen e detyrave dhe nënshkrimin e akteve për të gjitha procedurat e prokurimit. Për këtë arsye, për vitin 2024 rezulton një numër më i reduktuar i urdhërave të karakterit ekonomik të nxjerra nga Zv/Kryetari i Gjykatës, në krahasim me vitin e kaluar (100 urdhëra për vitin 2024 dhe 170 urdhëra për vitin 2023).

Gjatë vitit 2024, Zv/Kryetari i Gjykatës, në funksion të menaxhimit të përgjithshëm gjyqësor dhe në respektim të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 të KLGJ-së “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”⁵³, duke pasur si qëllim ndarjen e ngarkesës së punës në mënyrë të barabartë ndërmjet gjyqtarëve, për shkak të çështjeve me natyrë komplekse, numrit të të

⁵¹ Shih nenin 37 tw Ligjit Nr. 98/2026 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

⁵² Referuar vendimit nr. 120, datë 12.04.2024 i Kryetarit të Gjykatës “Për delegimin e kryerjes së detyrave që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit publik”.

⁵³ Në pikën 5, të kapitullit V “Përjashtimi i gjyqtarit nga shorti” të Vendimit nr. 554, datë 29.12.2022, të KLGJ-së, parashikohet se: “Në rast nevojë të diktuar nga ngarkesa e pabarabartë e punës midis gjyqtarëve, kur mekanizmi i rindarjes së çështjeve nuk mund të realizohet, kryetari me vendim të arsyetuar, përjashton plotësisht ose pjesërisht gjyqtarin nga ndarja me short e çështjeve, deri në sigurimin për aq sa është e mundur, e një ngarkese pune të barabartë midis gjyqtarëve”.

pandehurve dhe akuzave të përcjella nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e ka vlerësuar të nevojshme nxjerrjen e 3 (tre) vendimeve për “Përjashtimin e përkohshëm të gjyqtarëve nga shorti” për një periudhë një mujore.⁵⁴

VENDIME TË KRYETARIT - VITI 2024			
Mbi kërkesën për heqje dorë nga gjykimi		Për mbarëvajtjen administrative të Gjykatës	Për dhënie leje
Të pranuar për heqje dorë nga gjykimi	Të papranuar për heqje dorë nga gjykimi		
49	12	11	59

URDHËRA TË KRYETARIT - VITI 2024				
Formim trupi gjykues / Kalim për shqyrtim	Ngritje grupe pune për mbarëvajtjen e institucionit	Të karakterit ekonomik	Për mbledhjen e përgjithshme të gjyqtarëve dhe të Këshillit të Gjykatës	Të natyrës administrative
130	15	100	9	52

Nën drejtimin e Zv/Kryetares, Znj. Irena Gjoka dhe Zv/Kryetarit, Z. Erjon Bani, gjykata ka realizuar të gjithë objektivat dhe pritshmëritë e saj, në drejtim të mbarëvajtjes së punës, si në aspektin administrativ, organizativ dhe atë vendimmarrës, me gjithë vështirësitë dhe ngarkesën e krijuar për shkak të vakancave të gjyqtarëve në gjendjen faktike të organikës së saj.

GJKKO, si institucion i specializuar në trajtimin e çështjeve penale të lidhura me korrupsionin dhe krimin e organizuar, ka vijuar gjatë vitit 2024 angazhimin dhe bashkëpunimin e saj me partnerët ndërkombëtare, me synim zhvillimin më tej të kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e eksperiencave me institucione homologe jashtë vendit.

Përmes angazhimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë, GJKKO synon të garantojë standarde të larta profesionale dhe të përmbushë detyrimet e saj në kuadër të reformës në drejtësi dhe procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. KANCELARI

Kancelari luan një rol kyç në menaxhimin dhe administrimin e veprimtarisë gjyqësore, duke siguruar funksionimin efikas dhe të organizuar të strukturave administrative të gjykatës. Në këtë aspekt, ai është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së përditshme të sekretarisë gjyqësore, si dhe të sektorëve dhe zyrave të tjera që përfshihen në strukturën organizative të gjykatës. Kancelari mbikëqyr funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe procesin e mbledhjes, përpunimit dhe administrimit

⁵⁴ Referuar vendimeve nr. 100, datë 07.10.2024; nr. 106, datë 18.10.2024 dhe nr. 128, datë 26.12.2024 të Kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

të të dhënave gjyqësore, duke respektuar në mënyrë rigorozë kuadrin ligjor në fuqi që rregullon teknologjinë dhe sigurinë e informacionit. Po ashtu, Kancelari kujdeset për zbatimin e normave etike nga ana e administratës gjyqësore, duke kërkuar përmbushjen e detyrimeve në përputhje me ligjin si gjatë procesit gjyqësor ashtu edhe jashtë tij.

Gjatë vitit 2024, është rritur kërkesa e llogarisë dhe janë përmirësuar proceset e punës në administratën gjyqësore. Nga ana e Kancelarit janë ndërmarrë masa konkrete për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së administratës, duke përdorur metoda efektive dhe produktive për të garantuar funksionimin optimal të strukturave gjyqësore. Në funksion të këtij qëllimi, janë zhvilluar mbledhje periodike me stafin administrativ, duke inkurajuar shkëmbimin e mendimeve dhe ideve të reja për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Përveç takimeve të përgjithshme me stafin, Kancelari ka organizuar edhe takime të veçanta me grupe pune, si dhe takime individuale me punonjës të administratës gjyqësore, me qëllim adresimin e problematikave specifike dhe gjetjen e zgjidhjeve më efektive për mbarëvajtjen e punës së përditshme. Këto iniciativa kanë kontribuar në rritjen e performancës së administratës gjyqësore, dhe në rritjen cilësisë së shërbimit të saj.

Në zbatim të Urdhrit të Zëvendëskryetarit të Gjykatës, nr. 120, datë 12.04.2024 “Për delegimin e kryerjes së detyrave që kanë të bëjnë me procedurat e Prokurimit Publik”, gjatë vitit 2024, Kancelari ka ushtruar funksionin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor për gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjatë vitit 2024, janë realizuar të gjitha procedurat e prokurimit të parashikuara duke bërë të mundur realizimin e fondeve buxhetore në masën 100%.

Kancelari gjithashtu kryeson Komisionin për Kthimin dhe Asgjësimin e Provave Materiale dhe mbikëqyr procesin e ruajtjes dhe asgjësimit të tyre, sipas urdhërimeve të vendimeve gjyqësore.

Kancelari ka një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe kontrollin e realizimit të detyrave nga ana e nëpunësve civilë gjyqësorë, veçanërisht në lidhje me kryerjen e njoftimeve procedurale dhe zbatimin e urdhërimeve të gjykatës për zhvillimin e proceseve gjyqësore. Në këtë drejtim, është ndjekur zbatimi i plotë i legjislacionit në fuqi dhe rregullores së brendshme të gjykatës, duke siguruar që çdo veprim të kryhet në përputhje me standardet profesionale dhe etike. Në rastet kur janë konstatuar shkelje ose moszbatim i detyrave nga ana e administratës gjyqësore, janë ndërmarrë masa përkatëse disiplinore, në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet rregullatorë përkatëse.

Përmirësimi i vazhdueshëm i standardeve të punës dhe rritja e performancës së stafit administrativ në GJKKO mbetet një prioritet kryesor. Kjo synon krijimin e një mjedisi pune të sigurt dhe profesional, duke reflektuar besueshmëri dhe transparencë në shërbimin ndaj publikut. Administrata gjyqësore është udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, paanësisë, transparencës, përgjegjshmërisë dhe korrektësisë në zbatimin e detyrave.

Gjatë vitit 2024, Kancelari ka vijuar raportimin periodik pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë, duke paraqitur të dhëna të detajuara mbi administrimin e gjykatës, menaxhimin e burimeve dhe treguesit statistikorë lidhur me çështjet gjyqësore.

2. VEPRIMTARIA E STRUKTURAVE ADMINISTRATIVE

1. KRYESEKRETARIA

Kompetencat e Kryesekretarisë dhe sekretarisë gjyqësore parashikohen shprehimisht në nenin 43-44 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu me vendimin nr.7, datë 13.06.2024, të Këshillit të Gjykatës, Për një ndryshim në vendimin nr.6, datë 07.07.2023, “Për miratimin e Strukturës dhe Organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe për miratimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësisë të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, nga Këshilli i gjykatës janë përcaktuar dhe specifikuar Misioni i Kryesekretarisë, Administrimi, Detyrat, Përgjegjësitë Kryesore, Detyrat teknike, Planifikimi dhe objektivat e zyrës së kryesekretarisë.

Misioni i kryesekretarisë është të bashkërendojë, organizojë dhe ndajë punën e zyrës së sekretarisë gjyqësore nën drejtimin e kancelarit të gjykatës, duke kryer veprimtari/aktivitete që synojnë organizimin dhe garantimin e funksionimit të duhur të shërbimeve të gjyqësore të gjykatës.

Kryesekretaria përgjigjet për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarisë së kryesekretarisë si një nga strukturat kyçe për dhënien e shërbimit ndaj qytetarit dhe ecurinë e rrjedhës së punës në tërësi në gjykatë. Kryesekretari në ushtrimin e detyrave të tij udhëhiqet nga parimet e parashikuara në ligjet procedurale dhe në Ligjin për Pushtetin Gjyqësor. Drejtimi (administrimi) i ndarjes së punës së të gjithë sekretareve gjyqësore dhe/ose nëpunësve të tjerë gjyqësor pranë shërbimeve gjyqësore; administrimin e veprimtarisë së përditshme të sekretarisë gjyqësore të gjykatës, duke u bërë e mundur përballimi i gjithë punës administrative në kohë.

Puna e kryesekretarisë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rezultatet e performancës së sekretarisë gjyqësore në tërësi dhe në veçanti, në efikasitetin dhe efikasitetin e veprimtarisë gjyqësore të gjykatës. Sekretaria gjyqësore ka qenë e mbingarkuar për vitin 2024, për shkak të dosjeve voluminoze të ardhura për gjykim, ndarjeve të çështjeve me vendime të ndërmjetme të gjykatës, por gjithmonë është bërë e mundur fotokopjimi dhe njehsimi i akteve në kohë, për ti dërguar dosjet në gjykatat kompetente.

Rezulton se për vitin 2024, Kryesekretaria në bashkëpunim me sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë përballuar një ngarkesë të madhe pune krahasuar me gjithë vitet e tjera, gjë që vërehet nga

statistikat e çështjeve të ardhura për gjykim, kërkesave penale të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, si dhe kërkesat e tjera të paraqitura nga palët e tjera në proces, kërkesa që rezultojnë në rritje të dukshme krahasimisht me vitet e kaluara, si dhe nga natyra e zhvillimit të seancave gjyqësore me shume të pandehur dhe shumë akuza, seanca që rezultojnë që fillojnë në fillim të ditës dhe që zgjasin tej orarit zyrtar.

Një tjetër ngarkesë e kryesekretarisë është se vendimet e GJKKO-së në tërësinë e tyre janë voluminoze, si pasojë të specifikës që ato kanë, qoftë lidhur me numrin e lartë të të pandehurve, apo numrin e madh të akuzave për të cilat janë hetuar dhe gjykuar këta të pandehur dhe me ndryshimet ligjore të vitit 2021, çdo vendim i arsyetuar i njoftohet palëve në proces, e kjo sjell një ngarkesë të madhe pune për kryesekretarinë, e cila është përballuar me sukses dhe palët janë njoftuar konform afateve.

Kryesekretaria ka siguruar raportimin dhe informimin në kohë të gjyqtarit/trupës gjykuese në lidhje me aspekte që kanë të bëjnë me gjykimin e çështjes si dhe ka ndihmuar në lehtësimin e komunikimit midis aktorëve proceduralë, për marrje-dhënien e informacioneve të lejuara, duke vepruar si një ndërlidhës kyç midis trupës gjyqësore, përfaqësuesve ligjorë, palëve në proces, personave të interesuar etj.

Nga stafi i kryesekretarisë ofrohet shërbim gjatë orarit zyrtar 08.00-16.00, si dhe ofrohet shërbim në kohe reale nëpërmjet emailit zyrtar të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pasi rezulton që një pjesë e kërkesave të palëve dhe të avokatëve gjatë gjykimit të çështjeve dhe seancave gjyqësore paraqiten nëpërmjet emailit zyrtar dhe nga kryesekretaria menjëherë bëhet shpërndarja e emaileve dhe kërkesave me qëllim zhvillimin në kohë të seancave gjyqësore.

Gjatë vitit 2024, rezulton se janë trajtuar dhe është kthyer përgjigje brenda afateve ligjore konform dispozitave, një numri të madh kërkesash për informacion nga institucionet e ndryshme, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykatave dhe Prokurorive të Rretheve, Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve etj.

Përgjatë këtij viti, është konstatuar se ka në rritje të dukshme të kërkesave të qytetareve të paraqitur në kryesekretarinë e gjykatës për informacione të ndryshme, për marrje kopje aktesh, kopje vendimi dhe nga kryesekretaria është bërë e mundur në kohe reale dhe efikase dhënia e informacionit të kërkuar si dhe plotësimi i kërkesave të palëve për kopje aktesh dhe studim dosjesh.

Gjithashtu në çdo kohë nga kryesekretaria është bërë orientimi i drejtë i palëve dhe publikut lidhur me procedurat gjyqësore penale apo administrative, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit si dhe kryesekretaria ka gjithmonë në vëmendje dhe objektiv të lehtësoje dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe palët në procese gjyqësore si dhe rritjen e transparencës në ofrimin e shërbimeve administrative gjyqësore.

Nga stafi i kryesekretarisë ofrohet shërbim efikas për palët gjatë orarit zyrtar 08.00-16.00, si dhe ofrohet shërbim në kohe reale nëpërmjet emailit zyrtar të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, www.gjp.gov.al, pasi rezulton që një pjesë e kërkesave të palëve dhe të avokatëve gjatë gjykimeve të çështjeve dhe seancave gjyqësore paraqiten nëpërmjet emailit zyrtar.

Nga kryesekretaria, menjëherë bëhet shpërndarja e emaileve dhe kërkesave me qëllim zhvillimin në kohë të seancave gjyqësore dhe informimin e trupave gjykues si dhe jepet informacioni i kërkuar në kohe reale nga palët, nëpërmjet numrit të telefonit të sekretarisë gjyqësore, të publikuar në webin e GJKKO.

Një bashkëpunim për tu theksuar është edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, pasi një pjesë e shkresave zyrtare për shoqërimin e të pandehurve/personave nën hetim dërgohen nëpërmjet emailit, për kërkesat e karakterit të ngutshëm.

Përgjatë këtij viti, është konstatuar se ka në rritje të dukshme të kërkesave të qytetareve të paraqitur në kryesekretarinë e gjykatës për informacione të ndryshme, për marrje kopje aktesh, kopje vendimi dhe nga kryesekretaria është bërë e mundur në kohe reale dhe efikase dhënia e informacionit të kërkuar si dhe plotësimi i kërkesave të palëve për kopje aktesh dhe studim dosjesh.

Kërkesa të ardhura nëpërmjet emailit zyrtar për vitin 2024	1800 (njëmijë e tetëqind)
Kthim përgjigje nga sekretaria gjyqësore, nëpërmjet emailit zyrtar për vitin 2024	400 (katërqind)

Për vitin 2024, rezulton se pranë GJKKO, janë paraqitur për gjykim dosje hetimore shumë voluminoze, me një numër të konsiderueshëm të pandehurit, sipas akuzave përkatëse. Gjithashtu gjatë gjykimin të çështjeve penale të mbartura edhe nga vitet e mëparshme, nga trupat gjykues, në çështjet komplekse, me shume të pandehur, në rastet kur ka pasur gjykim të shkurtuar apo me marrëveshje të palëve, në shumë raste nga trupa gjyqësore është vendosur ndarja e çështjeve dhe krijimi i dosjeve të reja, në funksion të gjykimin. Nga sekretaria gjyqësore është detyrë funksionale të fotokopjohen të gjitha aktet e dosjes gjyqësore dhe hetimore, deri në momentin e ndarjes së çështjes nga trupi gjykues dhe krijimin e një dosjeje të re.

Gjithashtu, nënvizojmë faktin se me ndryshimet që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale në vitin 2021, ku parashikohet njoftimi i vendimit të arsyetuar palëve në proces, është rritur ndjeshëm volumni i punës në sekretarinë gjyqësore dhe konsumimit të letrës nga ana e administratës. Kjo ngarkesë shpjegohet si rezultat i faktit se, vendimet e GJKKO-së në tërësinë e tyre janë voluminoze, si pasojë të specifikës që ato kanë, qoftë lidhur me numrin e lartë të të pandehurve, apo numrin e madh të akuzave për të cilat janë hetuar dhe gjykuar këta të pandehur. E njëjta gjë vlen edhe për masat e sigurimit dhe kërkesat penale, informacionet

dy mujore të marra në shqyrtim nga gjykata, me shumë persona nën hetim, gjë që krijon një volum të madh pune për fotokopjimin e vendimeve të gjitha palëve në proces.

Më poshtë, po bëjmë një parashtrim të volumeve të fotokopjuara nga sekretaria gjyqësore gjatë vitit 2024, në zbatim të urdhërimeve të gjykatës:

Dosje penale të ndara me vendim gjykate	~ 40 dosje
Numri i volumeve të fotokopjuara	~ 2150 volume

Numri i vendimeve të komunikuar	Numri i palëve në proces të cilëve i është komunikuar vendimi
~ 1150	~ 2800

Për realizimin e shërbimeve të mësipërme në zbatim të urdhërimeve të gjykatës, si dhe për veprimtari të tjera administrative të GJKKO, gjatë vitit 2024, është nevojitur përdorimi i ~3000 risma, (1,500.000 fletë), për shërbimet e printimit dhe fotokopjimit, me 2.000.000 printime/fotokopjime.

Gjithashtu, nga sekretaria gjyqësore në bashkëpunim me sektorin i IT, CD-të, shoqëruese të akteve hetimore bëhen kopje e bashkëngjiten dosjes së veçuar me vendim gjykate si e

dhe nga palët në proces bëhen kërkesa për pajisjen me CD-audio të seancave gjyqësore si dhe kopjeve të CD që shoqërojnë dosjen.

Në GJKKO ndodhen gjithsej 5 (pesë) salla gjykimi, të cilat janë të pajisura me sistem regjistrimi audio, ndërkohë që salla 1 është e pajisur edhe me sistem video regjistrimi.

Më poshtë paraqitet tabela me numrin e seancave audio të zhvilluara, për çdo gjyqtar, për vitin 2024. Paraqitja në përqindje e numrit të seancave gjyqësore, që regjistrohen në sistemin audio dhe shkaqeve, për të cilat procesverbalet mbahen me mjete të tjera (kompjuter apo dorëshkrim).

Tabela: Përdorimi i sistemit të regjistrimit audio në periudhën 10.01.2024 – 31.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Nr.	Gjyqtar / e	Seanca të regjistruara audio	Seanca të paregjistruara audio	Gjithsej Totali	Në % Sasi / Total
1	Erjon BANI	328	310	638	51%
2	Erjon ÇELA	485	329	814	60%
3	Irena GJOKA	399	334	733	54%
4	Flora HAJREDINAJ	456	307	763	60%
5	Etleva DEDA	213	395	608	35%
6	Atalanta ZEQRIRAJ	102	366	468	22%
7	Flojera DAVIDHI	341	207	548	62%
8	Elsa ULLIRI	296	127	423	70%
9	Rudina PALLOJ	363	230	593	61%
10	Bib NDRECA	139	60	199	70%
11	Ardit MUSTAJ	73	68	141	52%
12	Albert MEÇA (i deleguar)	5	1	6	83%
13	Alfred KONOMI (i deleguar)	2	2	4	50%
14	Artan ÇUPI (i deleguar)	14	0	14	100%
15	Artan JAHOLLARI (i deleguar)	3	1	4	75%
16	Aurel ARAPI (i deleguar)	16	0	16	100%
17	Diamela GOXHA (e deleguar)	4	0	4	100%
18	Eglantina MIKANI (e deleguar)	11	5	16	69%
19	Engjëllushe TAHIRI (e deleguar)	10	0	10	100%
20	Esmeralda XHILI (e deleguar)	8	4	12	67%
21	Kujtim VRANIÇI (i deleguar)	7	4	11	64%
22	Luljeta KOLE (e deleguar)	8	1	9	89%
23	Matilda LLANGOZI (e deleguar)	36	2	38	95%
24	Migena LASKA (e deleguar)	2	0	2	100%
25	Paulin ÇERA (i deleguar)	16	4	20	80%
Totali		3337	2757	6094	55%

Vlen për t’u theksuar fakti se seancat gjyqësore që i përkasin çështjeve të themelit, seancave paraprake, kërkesat penale, kërkesave për sekuestrim e konfiskim sipas Ligjit Antimafia dhe Aktit Normativ, masave të sigurimit regjistrohen nëpërmjet sistemit audio. Seancat, të cilat nuk regjistrohen në sistemin audio pranë GJKKO-së, i përkasin kryesisht kërkesave për lejim/vleftësim/autorizim/zgjatje përgjimi, kërkesave me objekt ekzekutim letërporosie, si dhe kërkesave për caktim mase sigurimi në mungesë. Kjo, për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Në këtë kontekst, theksojmë faktin se kjo është arsyeja që regjistrimi i të gjitha seancave audio nuk është në masën 100%.

2. DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar e GJKKO-së përbëhet nga Drejtori i Drejtorisë dhe specialisti i financës dhe magazinieri. Detyrat e këtij sektori janë të përcaktuara shprehimisht në nenin 41/b, të Ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 “Për organizimin e

pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku sipas nenit 45 të ligjit të sipërcituar, parashikohet se “Shërbimi financiar ushtron dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar, në aktet në zbatim të tyre si dhe në Vendimin e KLGJ nr. 148 datë 29.03.2023 “Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësiive të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”. Kjo Drejtori është përgjegjëse për hartimin e Raportit Financiar për vitin 2024.

I. Raporti Financiar për Vitin 2024

Vështrim i përgjithshëm

Buxheti i miratuar me vendimin nr. 743, datë 28.12.2023 “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për Sistemin Gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vitin 2024 ka qenë në shumën 259,600 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024, në buxhetin e Gjykatës, sipas kërkesave të paraqitura nga ana jonë janë bërë ndryshimet e mëposhtme:

- Artikulli 600, shpenzime paga, është pakësuar në shumën 17,000 mijë lekë me Vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”. të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Artikulli 601, shpenzime sigurime, është shtuar në shumën 4,000 mijë lekë
- Artikulli 602, shpenzime për mallra dhe shërbime, është shtuar në shumën 5,285 mijë lekë me Vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Artikulli 606, shpenzime për transf. buxh. familjare & ind., është shtuar në shumën 366 mijë lekë për dhënie ndihme në rast fatkeqësie dhe në zbatim të VKM-së nr. 846, datë 26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”.
- Artikulli 230, shpenzime kapitale (studime dhe projekte) është shtuar në shumën 2,200 mijë lekë me Vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Artikulli 231, shpenzime kapitale (investime), është shtuar në shumën 10,100 mijë lekë konfirmuar me shkresën nr. 10548/1, datë 06.08.2024, nga Ministria e Financës, shkresën nr. 9448/1, datë 26.07.2024, nga Ministria e Financës si dhe Vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Buxheti i rishikuar, i vitit 2024 është në shumën 264,551 mijë lekë dhe krahasuar me buxhetin e miratuar në fillim të vitit është rritur në shumën 4,951 mijë lekë ose në masën 1.9%.


Realizimi për vitin 2024 është në shumën 248,207 mijë lekë ose në masën 94% e buxhetit të rishikuar.

Fondet buxhetore të gjykatës, të rishikuara së bashku më realizmin e tyre 12-mujor, sipas grup shpenzimeve paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

në 000 lekë


Nr.	Emërtimi	Buxheti i miratuar për vitin 2024	Ndryshime gjatë vitit 2024	Buxheti i rishikuar për vitin 2024	Realizimi për vitin 2024 në vlerë	Realizimi për vitin 2024 në %
01	Shpenzime paga	215,900	-17,000	198,900	186,979	94%
02	Shpenzime sig. shoqërore	18,000	4,000	22,000	17,728	81%
03	Shpenzime për mallra dhe shërbime	24,000	5,285	29,285	29,285	100%
04	Shpenzime trans fam	0	366	366	366	100%
05	Shpenzime kapitale	1,700	12,300	14,000	13,850	99%
	Totali	259,600	4,951	264,551	246,047	93%

Fondet buxhetore të miratuara, të rishikuara dhe realizimi i tyre, sipas grup shpenzimeve, për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, grafikisht paraqiten si më poshtë:



Pesha specifike sipas grup shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2024, paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Pesha specifike e artikujve të buxhetit në realizimin faktik në %, viti 2024



Analiza e shpenzimeve për vitin 2024

Në mënyrë më të detajuar buxheti dhe realizimi për këtë gjykatë, paraqitet si më poshtë:

1. Artikulli 600 & 601 “Shpenzime Personeli”

Buxheti i rishikuar në shpenzime personeli është 220,900 mijë lekë, i ndarë përkatësisht në shumën 198,900 mijë lekë në shpenzime paga dhe 22,000 mijë në shpenzime sigurimi. Ky fond është përlogaritur dhe miratuar për 65 punonjës sipas numrit të punonjësve në strukturën organizative. Realizimi fondeve të rishikuara në shpenzime personeli (shpenzime paga dhe sigurime shoqërore) është në masën **93%**, për numrin 58 punonjës sipas organikës faktike.

Organika faktike e gjykatës, gjatë vitit 2024, u plotësua me 2 gjyqtarë, duke çuar numrin e gjyqtarëve në 11. Mbeten ende 5 gjyqtarë të tjerë që duhet të emërohen pranë kësaj gjykate (Struktura organike parashikon 16 gjyqtarë).

Në lidhje me administratën e gjykatës struktura organike parashikon 49 punonjës, ndërsa organika faktike është 47.

Gjatë vitit 2024, janë shlyer të gjitha detyrimet në lidhje me diferencën e pagave të gjyqtarëve të kësaj gjykate për periudhën 01.01.2019 – 08.01.2023, si dhe pagesën diferencave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që lindën si rezultat i reflektimit në sistemin e tatimeve të pagës së re të gjyqtarit.

Realizimi në këtë masë vjen si rrjedhojë e mosplotësimit 100% të strukturës organizative të kësaj gjykatë.


2. Artikulli 602 (Shpenzime për mallra dhe shërbime).

Lidhur me shpenzimet për mallra e shërbime të tjera (operative) është fondi buxhetor i miratuar në fillim të vitit ka qenë në shumën 24,000 mijë lekë. Në këtë fond u përfshinë nevojat në shpenzimet operative për aktivitetin e përditshëm të Gjykatës, referuar kërkesave të përcaktuara në fazën e projektbuxhetit sipas zërave të shpenzimeve si dhe realizimit të vitit 2023. Ky fond gjatë vitit 2024 është shtuar në shumën 5,285 mijë lekë, duke e çuar buxhetin e rishikuar për këtë artikull në shumën 29,285 mijë lekë.

Realizimi i fondeve të rishikuara në shpenzimeve operative është në masën 100%. Në këtë zë të shpenzimeve janë realizuar shpenzimet për aktivitetin e përditshëm të gjykatës.

Në vijim, paraqitet grafiku i përqindjes (%) që zënë nën artikujt e shpenzimeve operative analitike në realizimin faktik total të shpenzimeve për mallra e shërbime të tjera (operative) për vitin 2024.

Pesha specifike e nënartikujve në realizimin e shpenzimeve operative



Sikurse vihet re nga grafiku i mësipërm, pjesën kryesore të shpenzimeve për mallra dhe shërbime të tjera në artikullin 602 e zënë **shpenzimet për shërbime nga të tretët (6022)** ku përfshihen, shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzime postare, shpenzime telefonike dhe celulare, të cilat zënë **26%** të artikullit 602.

Shpenzimet për detyrime dhe kompensime (6027) kanë një peshë prej 25% në totalin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime. Ky nënartikull përfshin shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjatë vitit 2024 janë kryer të gjitha pagesat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe ato me ekzekutim të përkohshëm për gjyqtarë

dhe nëpunësit civilë gjyqësor të kësaj gjykate deri në 31 Dhjetor 2024. Në total janë ekzekutuar 23 vendime gjyqësore në shumën prej 7,727,396 lek. Në zbatim të ligjit nr. 29/2023 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, dhe të Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 26, datë 08.09.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, është llogaritur dhe zbritur nga shuma e paguar tatimi mbi të ardhurat në masën 15% të pagesës bruto të përfituar, kur ka qenë e aplikueshme. Ndërsa për disa nga nëpunësit civilë gjyqësore, në zbatim të vendimit të gjykatës do të reflektohet ndryshimi i pagës në listëpagesat e muajve përkatës dhe të kryhet pagesa e detyrimeve të lindura për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe TAP gjatë vitit 2025.

Shpenzimet për shërbime transporti, (6023) ku përfshihen blerje pjesë këmbimi, goma, bateri dhe mirëmbajtje mjete transporti, paraqiten në masën 19%.

Shpenzimet për materiale zyre dhe të përgjithshme (6020) ku përfshihen shpenzimet për letër, kancelari materiale pastrimi, lëndë djegëse kaldaje, gjenerator, abonime, etj., paraqiten në masën **12.5%** të artikullit 602.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme(6025) ku përshihen shpenzimet për mirëmbajtje godine, sistemin e ngrohjes dhe të ftohjes, mirëmbajtje elektrike teknike dhe elektronike, zënë **7.7 %** të shpenzimeve faktike vjetore.

Shpenzimet e tjera operative (6029), ku përfshihen shpenzimet për avokatë kryesisht, ekspertë, psikologë, etj., zënë **7.5 %** të shpenzimeve vjetore.

Prokurimet e realizuara për shpenzime operative janë të pasqyruara hollësisht dhe të detajuara më poshtë.

Pasqyra: Prokurimet e realizuara në artikullin 602 “Shpenzime për mallra dhe shërbime”, viti 2024

Nr.	Emërtimi	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH	Operatori ekonomik fitues	Periudha e zhvillimit
01	Blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar	100,000	66,560	EXP TRAVEL & TOURS	13/03/2024
02	Tonera	50,000	59,500	Dhimiter Vasi	18/12/2024
03	Abonime (fletore zyrtare ,libra publikime)	30,000	20,000	Posta Shqiptare	
04	Shtypshkrime	400,000	463,250	I T Gjergji kompjuter	04/01/2024
				OLSONI	30/04/2024
				ANI PRINT	21/11/2024
05	Letër A4, A3 Kancelari	1,566,667	1,155,000	Marketing&Distr.	19/03/2024
			398,160	Infosof Office	19/03/2024
			1,000,790	Marketing&Distri	21/11/2024
06	Materiale Pastrimi, dezinfektimi anticovid,	400,000	468,000	HEP 2012	11/07/2024
				ALPEN PULITO	20/09/2024
				PL-97 GROUP	11/12/2024
				HEP 2012	01/01/2024
07	Furnizime me materiale te tjera te përgjithshme	100,000	119,760	3V ASLLANI	23/04/2024
				Sokol Rrokaj	17/07/2024
				BENNETT	17/07/2024
				Sokol Rrokaj	08/10/2024
08	Blerje karburanti /vaji	4,233,333	1,975,026	A&T SHA	15/03/2024
			2,884,620	A&T SHA	15/03/2024
09	Pjese Këmbimi Goma, Bateri	1,000,000	1,137,569	Telia Kurti	20/06/2024
				Erbolina Beqiri	22/07/2024
				FRATELI	25/04/2024

				CLASSIC	11/03/2024
				O & A	10/06/2024
				EKM Konstruksion	15/05/2024
				Besnik Meci	20/06/2024
				FRATELI	16/02/2024
				Blerim Ajdinaj	11/03/2024
				CLASSIC	30/04/2024
				TELIA KURTI	11/10/2024
				TELIA KURTI	12/06/2024
				Erbolina Beqiri	26/12/2024
				C L A S S I C	12/12/2024
				O & A	23/10/2024
				C L A S S I C	21/11/2024
				TELIA KURTI	04/12/2024
10	Shërbime te tjera transporti	400,000	399,240	O & A	12/03/2024
11	Shërbime te printimit dhe publikimit	1,000,000	1,186,440	AMAR 17	26/01/2024
		1,000,000	1,007,640	AICOM	26/01/2024
12	Mirëmbajtje Pajisje elektronike	400,000	466,800	AICOM	07/11/2024
				AICOM	21/11/2024
13	Shërbim Mirëmbajtje mjete transporti/ Riparime	100,000	111,298	CSP	30/10/2024
				CSP	25/11/2024
				Lubjana Baci	23/07/2024
				TAG Albania	22/07/2024
				Lubjana Baci	09/09/2024
				CLASSIC	10/10/2024
				Telia Kurti	10/10/2024
				MASGLAS	07/11/2024
				Lubjana Baci	10/12/2024
				INSIG SH.A	07/03/2024
14	Shërbim i siguracioneve të mjeteve të transportit	820,000	811,125	INSIG SH.A	10/06/2024
				INSIG SH.A	11/09/2024
				INSIG SH.A	11/09/2024
15	Mirëmbajtje rrjeteve hidraulike ,elektrike ,	1,000,000	1,101,400	T&p shpk	26/06/2024
				Frateli	20/06/2024
				Prompt Adriatic	23/07/2024
				AMI ARLI	21/11/2024
				FRATELI	18/09/2024
				T&p shpk	03/12/2024
16	Mirëmbajtje lulishte	100,000	119,991	Ervin Corbaxhi	10/10/2024
				Telia Kurti	20/09/2024
17	Mirëmbajtje Godine(Lyerje, riparim dyer dritare pllaka)	1,000,000	291,684	AL - Dok	02/04/2024
				Telia Kurti	19/12/2024
				SHAGA	18/11/2024
				Telia Kurti	04/12/2024
				CSM CONSTRUCTION	11/11/2024
18	Të tjera materiale dhe shërbime speciale (të personalizuara)	100,000	119,996	Fitore Lami	09/04/2024
				Alban Kardashi	28/08/2024
				Blendi Seferi	18/12/2024
				Vjollca Osmani	30/12/2024
19	Blerje inventari i imët	100,000	119,900	Vjollca Osmani	30/12/2024
20	Mirëmbajtje faqe WEB	300,000	348,000	Electron Albania 2008	17/09/2024
21	Shpenzime për pritje përcjellje Institucioni	60,000	68,900	ARK IT	26/01/2024
22	Shpenzime te tjera materiale dhe shërbime operative	125,000	135,000	Lajthiza	10/12/2024
Totali		16,470,472	16,035,649		

Realizimi i shpenzimeve korrente në masën 100%, tregon për një menaxhim të mirë dhe me efektivitet të fondeve buxhetore nga ana e Gjykatës.

3. Shpenzime për transfertat për buxhetet familjare dhe individët

Shpenzimet në këtë artikull në shumën 366,000 lekë, janë përdorur kryesisht për raste të dhënies së ndihmës së menjëhershme për raste fatkeqësie dhe raste të tjera (sëmundje dhe

pension pleqërie). Gjithashtu, në zbatim të VKM nr. 846, datë 26.12.2024 “ Për dhënien e një ndihme të menjëhershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”, për të gjithë punonjësit, sipas përcaktimeve të kësaj VKM-je, është dhënë ndihma e menjëhershme financiare në shumën 15,000 lekë.

4. Artikulli 230 & 231 “Shpenzime Kapitale”, (Investime)

Buxheti i miratuar në fillim të vitit në artikullin 230 & 231 “Shpenzime kapitale” (investime) për këtë gjykatë ishte në shumën prej 1,700 mijë lekë, të cilat ishin parashikuar për blerje orendi e pajisje zyre si dhe për pajisje të tjera teknike.

Gjatë vitit në këtë artikull, me kërkesë të Gjykatës, KLGJ – ja, ka miratuar fondet buxhetore shtesë si më poshtë:

- Artikulli 230, shpenzime kapitale (studime dhe projekte) është shtuar në shumën 2,200 mijë lekë me Vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- Artikulli 231, shpenzime kapitale (investime), është shtuar në shumën 10,100 mijë lekë konfirmuar me shkresën nr. 10548/1, datë 06.08.2024, nga Ministria e Financës, shkresën nr. 9448/1, datë 26.07.2024, nga Ministria e Financës si dhe Vendimin nr. 761, datë 27.12.2024, “Mbi ndryshimin (pakësim dhe shtesa) e buxhetit në sistemin gjyqësor, për vitin buxhetor 2024”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Buxheti i rishikuar në fund të vitit në këtë artikull është në shumën 14,000 mijë lekë.

Realizmi i këtij artikulli është në masën 99%, ose në shumën 13,850 mijë lekë.

Fondet buxhetore shtesë u përdorën për:

- Hartimin e Projektit për Building Management System (BMS) nga ekspertë të fushës elektrike, elektronike dhe kondicionimi për të gjithë godinën, duke përfshirë edhe gjykatën e apelit, ndriçimet e sallave të gjyqit për të dy gjykatat, dhe ndriçimin e jashtëm të gjithë godinës përfshirë edhe SPAK. Ky sistem do të menaxhojë elektronikisht gjithë sistemin elektrik, ndriçimin, sistemin e ajrimit, sistemin e kondicionimit, sistemin e kaldajës dhe pompat shkarkuese të ujërave të bardha e të zeza. Ky sistem do të ketë në monitorim dhe komunikim të drejtpërdrejtë çdo sistem kyç elektrik.
- Hartimin e projektit për sistem të ri të ngrohje, ftohje, ventilim të godinës ku ushtrojnë aktivitetin dy gjykatat e posaçme, të tipit VRF.
- Blerje dhe montim ashensorësh – Në godinën e GJKKO që nga ndërtimi dhe vënia e saj në përdorim, në vitin 2009, janë të montuar tre ashensorë. Si pasojë e viteve në funksionim dhe mungesës së pjesëve të këmbimit për këto tipa ashensorësh, gjendja e tyre teknike ishte jo e mirë dhe shpesh ata shfaqin defekte dhe koha për riparim e tyre zgjatej për shkak të mungesës së pjesëve të këmbimit. Për shkak të gjendjes së tyre teknike dhe kostos të lartë të riparimit, si dhe për të rritur kushtet e sigurisë në punë u kërkua blerja dhe montimi i tre ashensorëve të rinj.

Pasqyra e mëposhtme jep të dhëna mbi projektet e realizuara në artikullin “Shpenzime Kapitale” (investime)

Nr.	Emërtimi	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH	Operatori ekonomik fitues	Periudha e zhvillimit
1	Orendi zyre	500,000	600,000	Shaga	25/10/2024
2	Blerje pajisje kondicionerë	750,000	887,200	Altec Shpk	06/02/2024
				Ervin Corbaxhi	16/07/2024
				Keta Elite	23/10/2024
3	Blerje pajisje te tjera (pompe drenazhi, Pompë kaldaje)	166,667	180,000	ZGA SHPK	13/09/2024
4	Blerje dhe vendosje ashensorësh	8,416,667	10,022,400	Kleo ashensor	25/10/2024
5	Projekt Sistemi BMS	1,000,000	1,162,425	TOWER	18/11/2024
6	Projekt sistemi VRF	833,333	998,007	TOWER	26/11/2024
	Totali	11,666,667	13,850,032		

II. Situata buxhetore e GJKKO ndër vite

Në pasqyrën e mëposhtme paraqiten fondet buxhetore të miratuara dhe të realizuara sipas grup shpenzimeve, për 3 vitet e fundit, për GJKKO.

Pasqyra: Fondet buxhetore të miratuara dhe realizuara për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKO për 3 vitet e fundit

Nr.	Emërtimi	2022		% e realizimit	2023		% e realizimit	2024		% e realizimit
		Plan	Realizimi		Plan	Realizimi		Plan	Realizimi	
01	Shpenzime paga	96,000	93,536	97%	177,938	173,870	98%	198,900	186,979	94%
02	Shpenzime sigurime	9,750	9,746	100%	14,600	13,767	94%	22,000	17,728	81%
03	Shpenzime për mallra dhe shërbime	17,400	17,398	100%	23,530	21,210	90%	29,285	29,285	100%
03.1	Shërbime nga të tretët	3,537	3,354	95%	5,210	4,909	94%	29,285	29,285	100%
03.2	Shpenzime për detyrime dhe komp	6,100	6,457	106%	8,080	6,805	84%	8,350	7,682	92%
03.3	Shërbime transporti	3,683	3,408	93%	3,380	3,615	107%	4,006	7,177	179%
03.4	Materiale zyre dhe të përgjithshme	200	552	276%	360	72	20%	7,744	5,698	74%
03.5	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	1,980	1,462	74%	1,780	1,868	105%	4,220	3,664	87%
03.6	Shpenzime të tjera operative	1,900	2,165	114%	4,720	3,941	83%	2,940	2,265	77%
03.7	Materiale dhe shërbime speciale							1,509	2,184	145%
03.8	Shpenzime udhëtimi							396	375	95%
04	Shpenzime për transf buxh fam & ind	821	821	100%	288	288	100%	366	366	100%
05	Shpenzime Kapitale	4,342	4,342	100%	8,400	7,821	93%	14,000	13,850	99%
	Totali	127,492	125,022	98%	224,468	216,667	97%	264,185	247,841	94%

Sikurse vihet re nga të dhënat e mësipërme, ka një tendencë në rritje të buxhetit të miratuar për këtë Gjykatë në masën 18% ose në shumën 47,518 mijë lekë, krahasuar me vitin e mëparshëm 2023. Peshën më të madhe në këtë rritje e zë buxheti i miratuar në shpenzime kapitale, në masën 67%, duke vijuar më tej në shpenzime për mallra dhe shërbime në masën 24% dhe në shpenzime personeli në masën 15%.

Rritja në shpenzime personeli reflekton plotësimin e vendeve vakante në këtë gjykatë gjatë vitit 2024.

Rritja në shpenzime për mallra dhe shërbime në një pjesë të saj vjen si rezultat i rritjes së aktivitetit të kësaj gjykate dhe të disa zërave të shpenzimeve të cilat lidhen drejtpërsëdrejti më numrin e çështjeve të gjykuara. Ndërsa një pjesë e kësaj rritjeje reflekton rritjen e çmimeve të mallrave të prokuruar, rritjen e nevojave për mirëmbajtje, etj.

Rritja në shpenzime kapitale pasqyron nevojën që ka kjo gjykatë për investime në infrastrukturën ndërtimore të saj. Godina ku ushtron aktivitetin Gjykata e Posaçme është e ndërtuar në vitin 2008. Gjatë viteve në këtë godinë nuk ka pasur investime të rëndësishme por të gjitha ndërhyrjet janë bërë në nivel mirëmbajtje. Për shkak të amortizimit në kohë të godinës si dhe ndryshimeve të teknologjisë përsa i përket sistemeve operative të kësaj gjykate, është e domosdoshme kryerja e investimeve si në infrastrukturën ndërtimore ashtu dhe në sistemet (BMS dhe VRF) të kësaj gjykate.

Duhet të theksojmë se, pavarësisht rritjes se buxhetit në shpenzime kapitale për vitin 2024, nevojat e kësaj gjykate ngelen ende të larta, për të arritur garantimin e kushteve të punës dhe gjykimit si dhe solemnitetin gjatë procesit të gjykimit. Sjellja e infrastrukturës së gjykatës në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e Bashkimit Evropian është në vëmendje tonë, gjatë ndërmarrjes së projekteve të ndryshme të investimeve në vitet në vijim. Ky synim i joni është në përputhje dhe me objektivin e Këshillit të Lartë Gjyqësor që është “Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë që garantojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale”.

1. Të ardhurat

Në pasqyrën e mëposhtme paraqiten të detajuara të ardhurat e realizuara nga gjykata, nga shitja e fotokopjeve dhe pullave të taksës për dhënien e vendimeve gjyqësore për vitin 2024. Këto të ardhura janë derdhur plotësisht në buxhetin e shtetit.

Artikulli	Emërtimi	Viti 2024
7081006	Taksa e akteve dhe të pullës (10% i të ardhurave nga pullat)	11,480
7115401	Gjoba Gjyqësore	308,195
7111008	Të ardhura nga fotokopja	2,110,000
	<i>Shuma e klasës 7</i>	<i>2,429,675</i>
4665100	90% e të ardhurave nga pullat	103,320
4665100	90% i të ardhurave nga 1%	5,400
	<i>Shuma e Klasës 4</i>	<i>108,720</i>
	Totali	2,538,395

Ndërsa në pasqyrën e mëposhtme jepen të dhënat mbi të ardhurat e krijuara nga Gjykata për 3 vitet e fundit.

Të ardhura dytësore që kalojnë nëpërmjet degës së thesarit				
Artikulli	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
7081006	Taksa e akteve dhe të pullës (10% i të ardhurave nga pullat)	13,420	10,400	11,480
7115401	Gjoba Gjyqësore	163,470	-	308,195
7111008	Të ardhura nga fotokopja	529,930	299,830	2,110,000
	<i>Shuma e klasës 7</i>	<i>706,820</i>	<i>310,230</i>	<i>2,429,675</i>
4665100	90% e të ardhurave nga pullat	120,780	93,600	103,320
4665100	90% i të ardhurave nga 1%			5,400
	<i>Shuma e Klasës 4</i>	<i>120,780</i>	<i>93,600</i>	<i>108,720</i>
	Totali	827,600	403,830	2,538,395

Sikurse vihet re nga pasqyra e mësipërme ka një shtim të të ardhurave dytësore të krijuara nga gjykata. Kjo vjen kryesisht për shkak të rritje së kërkesave për fotokopje aktesh si dhe për faktin se aktet e fotokopjuara janë voluminoze.

Gjatë vitit 2024, Gjykata nuk ka qenë objekt auditimi.

III. Nevojat buxhetore

Për vitin buxhetor 2025 buxheti i miratuar për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë KKO, me vendimin nr. 762, datë 27.12.2024 “Mbi detajimin e buxhetit vjetor për vitin 2025 dhe të buxhetit për vitin 2026 dhe vitin 2027, për Sistemin Gjyqësor”, është në shumën 341,000 mijë lekë. Nevojat e evidentuara nga kjo Gjykatë për rrjedhojë të paraqitura prej saj si kërkesa buxhetore për vitin pasardhës, pasqyruar në dokumentin e projekt-buxhetit afatmesëm PBA-së 2025 – 2027 kanë qenë në shumën 443,300. Një pjesë e këtyre kërkesave janë plotësuar gjatë vitit 2024.

Megjithatë, Gjykata ka realizuar një analizë të situatës aktuale të infrastrukturës ndërtimore dhe është duke përgatitur planin e ndërhyrjeve të nevojshme dhe kostot përkatëse, e cila do të përcillet pranë KLGJ-së, për të bërë të mundur sigurimin e burimeve financiare të nevojshme për realizmin e këtij plani.

Fondet buxhetore të miratuara për vitin 2025 në shpenzime kapitale janë në shumën 71,200 mijë lekë.

Fokusi në investimet e parashikuara për vitin 2025, do të jetë në vazhdimësinë e projekteve ekzistuese sikurse janë realizimi i sistemit BMS dhe VRF, për të cilat gjatë vitit 2024 kanë përfunduar projektet përkatëse.

Disa nga projektet e reja të parashikuara për t’u realizuar gjatë vitit 2025 janë:

- Hartimi i projekteve për rikonstruksionin e 2 sallave të gjykimit dhe sallës së mbledhjeve të gjyqtarëve
- Blerja e pajisjeve për sistemin e sigurisë, pajisje për mbrojtjen kundër zjarrit, etj.
- Blerja e licencave për programet kompjuterike, etj.

3. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE

Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve, gjatë vitit 2024 ka realizuar me sukses një sërë prej objektivave të vendosura, si ato afatshkurta, afatmesme dhe afatgjatë, referuar nevojave të institucionit për këtë vit, të cilat përfshijnë, por pa u kufizuar:

- Përmirësimin e procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së administratës gjyqësore dhe stafit mbështetës, duke siguruar transparencë dhe meritokraci.
- Zhvillimi i mekanizmave për të rritur ndërgjegjësimin mbi standardet etike.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe logjistikës.
- Menaxhimi i riskut dhe i sigurisë.
- Sigurimi i transparencës dhe efijencës në prokurime etj.

Konkretisht, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2024, kishte të miratuar në organikën e saj, gjithsej 65 punonjës prej të cilëve 16 gjyqtarë dhe 49 punonjës të administratës. Risia e këtij viti që analizojmë për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është rishikimi i Strukturës, Organigramës, përshkrimi i detyrave si dhe përcaktimi i kategorisë së pagave për punonjësit.

Gjithashtu përgjatë vitit 2024 u krijua dhe implementua praktika e orëve shtesë për punonjësit e administratës në zbatim të VKM-së nr. 732, datë 13.11.2019 “Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, orët jashtë orarit dhe shpërbimin e tyre si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë” dhe Udhëzimit nr. 48, datë 08.02.2022 “Për mënyrën dhe procedurën e kompensimit, për orët shtesë të kryera mbi kohën normale të punës, nga nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë administrativë në gjykatë”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kërkesë të titullarit të Gjykatës, nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve u hartua një relacion në lidhje me mënyrën dhe procedurën e rekrutimit për “*specialistët*”, e Shërbimeve Mbështetëse dhe “*nëpunësve gjyqësor*”, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përgjatë viteve. Në këtë kuadër, disa punonjës të gjykatës, paraqitën disa kërkesa lidhur me zbatimin e gabuar të kategorisë së pagës.

Me Vendimin e Këshillit të GJKKO-së **nr. 7, datë 13.06.2024** “Për një ndryshim në vendimin nr. 6, datë 07.07.2023, “Për miratimin e Strukturës dhe Organigramës së Gjykatës

së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe për miratimin e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civil gjyqësor të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, Këshilli i Gjykatës morri në analizë dhe u shpreh lidhur me këto çështje: **1)** Rishikimin e strukturës dhe organigramës të Gjykatës të miratuar me vendimin nr. 6, datë 07.07.2023 të Këshillit të Gjykatës, me qëllim zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në dokumentin “Auditim Përputhshmërie” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Janar 2024 lidhur me numrin e punonjësve për njësitë strukturore/sector apo drejtori, si dhe për ta përshtatur me nevojat e veçanta të gjykatës; **2)** Analizimin e statusit të pozicioneve të punës “*Nëpunës gjyqësor*” dhe “*Specialist të Shërbimeve Mbështetëse*” në përputhje me kuadrin ligjor që ka rregulluar statusin e tyre ndër vite, për të konkluduar më pas nëse duhet të marrin statusin e nëpunësit gjyqësor civil. Në këtë rast Këshilli i Gjykatës mbajti në konsideratë jo vetëm kuadrin ligjor kushtetues mbi “*pavarësinë organizative të gjykatave*” por edhe përgjigjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor me shkresën Nr. 6526/1 Prot., datë 28.12.2023, ku është theksuar se është në kompetencën e Këshillit të Gjykatës për të vlerësuar nëse një punonjës i gjykatës i plotëson kushtet apo jo për të marrë statusin e nëpunësit civil gjyqësor; **3)** Shqyrtimin e kërkesës së disa punonjësve të GJKKO mbi zbatimin e gabuar të kategorisë së pagës si dhe analizimin kryesisht nga Këshilli i Gjykatës nëse nëpunësit gjyqësor civil dhe punonjësit e tjerë të gjykatës marrin kategorinë e pagës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.⁵⁵

Gjatë vitit 2024 janë paraqitur 2 kërkesa për dorëheqje nga detyra dhe konkretisht: 2 punonjës në pozicionin “*Shofer*”.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 ka plotësuar moshën e daljes në pension një punonjës me detyrë “*Sanitare*”.

Gjatë vitit 2024 u zhvillua edhe procesi për rekrutimin e 3 (tre) punonjësve të emëruar me Kod Pune dhe konkretisht: 2 punonjës në pozicionin “*Shofer*”; dhe 1 punonjës në pozicionin “*Sanitare*”.

Numri i punonjësve, sipas strukturës organizative të GJKKO-së për vitin 2024, është 65 punonjës, nga të cilët 16 gjyqtarë dhe 49 administratë gjyqësore.

Në dhjetor të vitit 2024, numri total i gjyqtarëve faktik në GJKKO ishte 11 gjyqtarë (nga 16 të përcaktuar). Për sa i përket numrit faktik të punonjësve të administratës gjyqësore, për GJKKO, në dhjetor të vitit 2024 rezulton të jenë në total 47 punonjës nga 49 punonjës sipas strukturës organizative.

⁵⁵ Shih nw mwnyrw mw tw detajuar analizwn tek pjesa e veprimtarisw sw Kwshillit tw Gjykatws pwr vitin 2024.

Informacion mbi punën e kryer nga SSHM për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.

Gjatë periudhës 01.01.2024 deri 31.12.2024 vëmendja kryesore i është kushtuar kontrollit dhe mirëmbajtjes së sistemit të ngrohjes dhe ftohjes qendrore të godinës së GJKKO, sistemit elektrik, sistemit të ajrimit, funksionimit normal të sistemit të drenazhit, sistemeve hidraulike, sistemit MKZ, si dhe gjendjes teknike të ashensorëve.

Duke qenë se sistemi ngrohje-ftohje funksionon vetëm gjatë orarit zyrtar, 08.00 – 16.00, për punonjësit të cilët për arsye të ngarkesave në punë, janë të detyruar të qëndrojnë jashtë orarit zyrtar, ose për arsye gatishmërie punojnë edhe në ditët e pushimeve ose të festave zyrtare, për të krijuar kushte të përshtatshme pune në zyrat S206, S213 dhe S214 është bërë montimi i kondicionerëve 12 DTU, ndërsa në zyrën S203 u bë montimi i një kondicioneri 24 DTU.

Gjithashtu, pas kërkesës së bërë nga punonjësit e policisë së burgjeve për kushtet e temperaturës dhe të ajrosjes në ambientin e qëndrimit të të paraburgosurve në sallën e gjyqit N023, duke qenë se ky ambient ndahet nga salla me një panel xhami të blinduar, për arsye të sigurisë fizike, është i pamundur depërtimi i ajrit të trajtuar me temperaturë dhe pastërtinë e duhur, u bë montimi i një kondicioneri 12 DTU.

Pas kontrollit në hollin N0004, për shkak të përthithjes së rrezeve të diellit nga fasada e hollit, fasadë masive xhami me gjatësi 20 metra dhe lartësi 4 metra, si dhe për shkak të mungesës së sistemit të ftohjes që nga projektimi dhe ndërtimi i godinës së GJKKO, temperaturat arrijnë vlera shumë të larta 42°C – 44°C duke e bërë të pamundur qëndrimin dhe ushtrimin e detyrës së tyre nga ana e punonjësve të Gardës së Republikës, punonjësit të sigurisë si dhe specialistëve të sallave të gjyqit, qëndrimin e gjyqtarëve të GJKKO dhe të punonjësve të tjerë me detyrë në këtë ambient dhe për këtë arsye u bë montimi i dy kondicionerëve 48 DTU secili.

Duke qenë se në dhomën e paneleve të tensionit të mesëm, ndodhen sistemi qendror UPS i godinës, blloku i baterive të sistemit UPS, panelet e tensionit 380v të rrjetit kryesor elektrik, si dhe ky ambient nuk është i lidhur me sistemin qendror të ngrohje – ftohjes së godinës, çlirimi i temperaturave të larta nga pajisje e sipër përmendura u bë blerja e një kondicioneri të ri, për të siguruar kushte pune në përshtatje me kërkesat teknike në këtë ambient.

Për të ruajtur funksionimin normal të sistemit të drenazhit dhe të shkarkimit të ujërave të zeza, për të shmangur përmytjen e ambienteve në katin -1, nën hollin e publikut ku gjenden magazina, depozitat e ujit sanitar si dhe arshivat me dokumentacionin e Gjykatës së Lartë është bërë montimi i dy pompave të reja grirëse.

Duke qenë se pajisjet dhe mobilet e zyrës S203, me kalimin e viteve ishin amortizuar dhe bërë të papërdorshme, ishte i nevojshëm një rimodelim dhe rinovim i këtyre pajisjeve. Për këtë arsye nga ana e specialistëve të SBNJSHMP dhe sekretares gjyqësore përgjegjëse për zyrën u hartua një projekt funksional për pajisje të përshtatshme për funksionimin normal të aktivitetit në zyrë duke bërë rinovim dhe ri mobilim total të saj i si më poshtë:

Duke qenë se ambientet e zyrave të godinës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ishin lyer prej një periudhe të gjatë u bë lyerja dhe riparimi i suvasë së mureve në disa prej ambienteve të godinës si **S115, S116, S214, S222, S226**.

U bë shërbim dezinfektimi DDD i ambienteve nëntokësore me sipërfaqe 800 m².

Gjatë gjithë periudhës janë mbajtur nën kontroll dhe janë riparuar sistemet e sigurisë në të dy anët e godinës së GJKKO.

Për gjatë gjithë vitit është mbajtur nën kontroll të përditshëm, në përputhje me grafikun e kontrollit dhe të shërbimeve sistemi MKZ dhe ashensorët të cilëve u është bërë shërbim profilaktik i përmuajshëm, ndërrimi i kavove, ndërrimi i inverterave, butonave dhe kontakteve të dyerve.

Për të përmirësuar cilësinë e shërbimit ndaj trupës gjyqësore dhe administratës së GJKKO u bë hartimi i specifikimeve teknike dhe më pas edhe procedura e prokurimit për blerjen e tre ashensorëve të rinj për godinën me kapacitet mbajtës 480 kg dhe 630kg, montimi i të cilëve përfundoi në fund të muajit Dhjetor 2024.

Në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës në godinë u hartuan specifikimet teknike dhe përfundoi faza e hartimit të projekteve teknike përkatëse për Sistemin e ri Ngrohje – Ftohje (VRF) dhe Sistemin e Menaxhimit të Kontrolluar (BMS) të godinës.

Shërbimi i transportit të gjyqtarëve dhe personelit për lëvizje administrative ka qenë një nga prioritetet e specialistëve të SBNJSHMP. Është bërë kontrolli teknik dhe riparimi i auto veturave në pronësi të GJKKO, dhe administrimi i sistemit të shpërndarjes së karburantit.

Në zbatim të urdhrave “Për shpërndarjen e automjeteve dhe limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjetet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” dhe ”Mbi ngritjen e komisioneve për hartimin e kërkesave për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2024”, të Zëvendëskryetarit të gjykatës dhe Titullarit të AK, janë bërë në vazhdimësi planifikimet për shpenzimet operative dhe investime për nevojat e sektorit dhe mirëmbajtjen e godinës, hartimi dhe zbatimi i kërkesave për blerje materiale për nevojat e sektorit, shërbimet e ndryshme, furnizimet me karburant për mjetet e transportit, kaldajën dhe gjeneratorin.

Gjatë gjithë periudhës vjetore është mbajtur nën kontroll dhe është riparuar sistemi elektrik, dyert, dritaret, ambienti rrethues si dhe zona e gjelbër e godinës.

Problem i mbetur pa zgjidhje ka qenë vetëm pamundësia e riparimit të gjeneratorit të godinës i cili vazhdon të jetë me defekt. Pavarësisht përpjekjeve nga specialistët e SBNJSHMP si dhe zhvillimit të dy procedurave prokurimi, asnjë nga OE pjesëmarrës në to nuk ka mundur të bëjë riparimin e tij.

4. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË.

Mbështetur në nenin 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 6, datë 07.07.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në GJKKO, sektori për Teknologjinë e Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, është i përbërë nga një shef sektori, një specialist IT, një specialist për marrëdhëniet me publikun median dhe me jashtë dhe një specialist për statistikat.

Gjatë vitit 2024 u ndryshua specialistja për marrëdhëniet me publikun dhe u emërua specialistja për statistikat.

Teknologjia e Informacionit (IT)

Për sa i përket teknologjisë së informacionit, sektori, sikurse edhe në vitet e kaluara, vazhdon instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve teknologjike të renditura si më poshtë:

- Sistemi ARK IT, ÇMIS/ICMIS, sistemi për menaxhimin e informacionit të gjykatës
- Sistemi RDA (FTR audio), sistemi për regjistrimin audio/video të seancave gjyqësore
- Sistemi i ndërlidhjes në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore me persona jo të pranishëm fizikisht në seancë gjyqësore
- Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun
- Sistemi kompjuterik për çdo përdorues
- Sistemi i printim/fotokopje
- Sistemi “ÇTV”, për regjistrimin e pamjeve filmike të sigurisë fizike
- Sistemi i skanimit dhe detektimit të hyrjes së personave të tretë
- Sistemi i dhomës teknike
- Sistemi i detektimit/shuarjes së zjarrit në ndërtesë dhe mjedise të posaçme
- Sistemi i qendëruar BMS i ndërtesës dhe mjediseve të posaçme
- Sistemi i telefonisë
- Sistemi i aksesimit të sigurtë në mjediset e ndërtesës
- Ndërlidhja me internet
- Rrjeti kompjuterik
- Sistemet Back-up

Këto sisteme të instaluar dhe përditësuara ndër vite, nevojiten të monitorohen, përditësohen në vijimësi, (Update/Upgrade) duke ruajtur dublikate me qëllim mirëmbajtjen e punës në momente kyçe (backup).

Më poshtë ju rendisim një përshkrim të hollësishëm mbi secilin sistem, duke shfaqur gjendjen dhe ecurinë përgjatë vitit 2024.

1. Menaxhimi i çështjeve gjyqësore kryhet nëpërmjet sistemit ARKIT.

Ky sistem u zhvillua dhe përditësua posaçërisht për gjykatën qysh në krijimin e saj, ish-Gjykata e Krimeve të Rënda. Me krijimin e GJKKO-së, sistemi u përshtat me nevojat e ndryshimeve të reja që pësoi legjislacioni në fushën e drejtësisë. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022 u instalua versioni i përditësuar i tij, me modelin bashkëkohor klient-server, me ndërfaqe “web” dhe bazën e të dhënave të përditësuar.

Në këtë sistem u realizua importimi i të dhënave të gjykatës së mëparshme “Gjykata e Krimeve të Rënda”, ashtu sikundër edhe çdo informacion tjetër i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjatë vitit 2024, u raportuan 31 problematika për këtë sistem, kryesisht në lidhje me raportet e statistikave. Në pjesën e dytë të vitit u integrua sistemi për hedhjen e shortit elektronik për anëtarët e trupës së gjykimit të dosjeve. Gjithashtu u integrua sistemi ARKIT me faqen zyrtare të gjykatave, www.gjykata.gov.al ekzaktësisht subdomaini:

<https://gjykata.gov.al/krimet-e-r%C3%ABnda/gjykata-e-posa%C3%A7me-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-p%C3%ABr-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/>

Nëpërmjet këtij integrimi u realizua shfaqja në portal e:

- orarit të proceseve gjyqësore,
- listës së shortit për kryesues,
- vendimeve të çështjeve të themelit,
- informacion mbi ecurinë e çështjeve.

Nga ky integrim u eliminua afishimi manual ditor ose javor në portalin e gjykatës www.gjp.gov.al

Vlen të ritheksohet se sistemi i ri nuk realizon akoma gjenerimin automatik të statistikave standarde të KLGJ-së, si tabela 47 vjetore ose ato të raportit tremujor të gjykatës, apo edhe ato vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, si pasojë nevojitet përpunim manual i të dhënave duke rritur kohën e punës për përpunimin e tyre, çka mund të sjellë edhe gabime njerëzore në pasqyrimin e saktë të statistikave. Kjo problematikë duhet të marrë zgjidhje nga KLGJ-ja.

Sistemi i përditësuar është në kontratë mirëmbajtjeje nënshkruar nga KLGJ-ja dhe vijon të përditësohet apo zhvillohet sipas kërkesave të ndryshme e të nevojshme.

2. Sistemi RDA (FTR Audio)

Ky sistem është mjaft i rëndësishëm për gjykatën pasi nëpërmjet tij realizohet regjistrimi audio për çdo seancë gjyqësore, duke siguruar transparencë në gjykim. Gjykata ka 5 (pesë) salla gjyqi, secila prej të cilave është e pajisur me këtë sistem. Gjatë vitit 2024 u aktivizua regjistrimi i seancave me audio dhe video.

Sistemi është konfiguruar për të kryer regjistrimin në vendndodhjen Workstation dhe të dhënat të kalojnë edhe në server-in qendror të gjykatës. Ky konfigurim realizon jo vetëm mbrojtjen e të dhënave, por gjithashtu aksesimin paralelisht të tyre nga çdo njësi kompjuterike të ndërlidhur dhe me akses në mjediset e gjykatës, duke lehtësuar punën e sekretareve gjyqësore në plotësimin dhe zbardhjen e saktë të procesverbalit të seancës, po ashtu edhe gjyqtarëve në hartimin e vendimeve.

Gjithashtu, nëpërmjet këtij sistemi realizohen kopje të seancave vetëm audio në CD/DVD për personat e tretë, si avokat apo palë që kërkojnë të njihen me ecurinë e procesit.

Ky sistem është i certifikuar nga institucioni i KLGJ-së, nënshkruar me kontratë mirëmbajtje të qendërzuar nga kompania përkatëse.

3. Sistemi i komunikimit në distancë

Në sallat e gjyqit të GJKKO-se janë instaluar 4 sisteme për komunikimin në distancë, të cilat në varësi të palës pritëse kanë protokolle kompjuterike të ndryshme duke realizuar video konferencë të enkriptuar jo vetëm për nevojat e gjykatës, por edhe për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, duke realizuar seanca marrjesh në pyetje dhe marrje dëshmish për të pandehurit që jetojnë në shtete të tjera të BE-së, në kuadër të bashkëpunimit juridiksional me autoritetet e huaja.

Pjesë përbërëse e sistemit është edhe kërkesa për të vëzhguar pamje filmike, audio, foto digjitale, të provave materiale gjatë seancave gjyqësore. Në përmbushje të kësaj kërkesë janë vënë në dispozicion monitorë të madhësisë 50” në 4 (katër) salla gjyqësore.

Duhet theksuar se këto sisteme kanë shfaqur problematika të shumta në komunikim për arsye se janë sisteme të vjetruara, të pa mundura për përditësim dhe, si të tillë janë të domosdoshëm të zëvendësohen me të reja.

4. Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun

Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun përbëhet nga faqja e internetit dhe kioska ndërvepruese (Touch-screen) me program të posaçëm për informimin e publikut, e cila gjendet në mjediset e publikut të GJKKO-së.

Nga raportet e hollësishme të mëposhtme, evidentohet se gjatë vitin 2023 ka pasur ~900.000 (nëntëqind mijë) aksesime të faqes së internetit, ku kërkesa më e lartë është tek menu-të “Urdhër thirrje për gjykim”, “Njoftime”, “Kalendari i Çështjeve” dhe “Njoftime për Shtyp”, me të njëjtën tendencë të kërkesave për informacion.

Gjatë vitit 2024 u rinovua dhe plotësua me dokumentacionin e nevojshëm menu-ja “Programi i Transparencës” sipas formatit të unifikuar për çdo institucion nga “Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale”.

Edhe kioska elektronike në hollin e publikut vazhdoi të ofronte shërbimin për publikun dhe gazetarët për menu-të “Orari sipas datave” dhe “Lista e Shortit” informacion mbi çështjen. Vlen për tu theksuar se kioska është me teknologji të vjetër touchscreen contact dhe jo kapacitiv, si e tillë publiku shpesh konfuzohet pse nuk përgjigjet rrjedhshëm, gjithashtu edhe HË i vjetër i kompjuterit ndikon në performancë të ulët të ekzekutimit të komandave.

Problematikë e mbartur nga viti i mëparshëm është ajo e integritit të faqes së web-it me menu-të e statistikave të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Si rrjedhojë orari i gjyqeve raportohet në mënyrë manuale vetëm për javën në vazhdim sikurse lista e shortit është konvertuar në raportim manual. Informacionet e tjera, të tipit “detaje të çështjes”, “çështje në gjykim”, “kohëzgjatja e çështjes”, “informacion mbi seancën”, janë totalisht jashtë pune.


Për sa më sipër në bashkëpunim me KLGJ-në (firmës së kontraktuar për rinovimin dhe mirëmbajtjen e programit), u realizua në fund të vitit kalendarik 2024 integrimi me portalin e Gjykatave, www.gjykata.gov.al, shfaqjen e informacionit të nevojshëm për rritjen e transparencës ndaj publikut dhe medias, duke ofruar shkarkimin e Vendimeve të Themelit në format PDF drejtpërdrejtë nga portali.

Më poshtë paraqiten tabelat përmbledhëse të detajuara bashkë me grafikët për aksesin e faqes së WEB-it.


Tabela: Akses i faqes së internetit

Menu	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
www.gjp.gov.al	80668	75580	72081	88898	82424	79121	85211	71555	79412	85228	82482	35612	918272
Kendi Informativ	4374	3668	3482	7844	3911	2959	3492	1949	3642	4332	3681	1850	45184
Kalendari i çështjeve	578	479	515	482	476	360	439	226	390	589	494	260	5288
Çështe në gjykim	629	524	499	496	460	336	459	307	430	653	517	255	5565
Çështje të përfunduara	417	379	292	355	348	289	229	204	265	364	336	165	3643
Evidencat statistikore	142	166	128	119	113	95	119	92	88	126	113	50	1351
Oraret e Gjyqeve	1658	1286	1369	1646	1595	1142	1061	489	1378	1453	1221	594	14892
Lista e Shortit	950	834	679	4746	919	737	1185	631	1091	1147	1000	526	14445
Gjykata e Posaçme	13311	11315	10590	14877	11405	12968	18521	11232	15725	17907	16606	8390	162847
Organizimi dhe struktura	250	289	254	229	236	177	222	121	200	288	227	99	2592
Orientimi në gjykatë	165	182	110	138	130	112	110	72	106	150	127	45	1447
Njoftime	2980	2489	2633	2921	2689	2534	6683	2225	3255	4493	3995	2093	38990
Vendime të Këshillit të Gjykes së Posaçme	1625	1211	1060	1460	1067	1247	1246	804	1178	1266	1254	542	13960
Urdhëra thirje për gjykim	8291	7144	6533	10129	7283	8898	10260	8010	10986	11710	11003	5611	105858
Programi i Transparences	1838	1749	1303	2128	1291	1785	3084	2957	1602	1406	1641	807	21591
Rregullore	531	522	348	410	274	738	276	240	279	290	356	120	4384
Programi i transparencës	135	144	81	103	99	142	79	55	89	81	85	39	1132
Koordinatori për të drejtën e informimit	134	141	100	85	79	74	79	47	62	66	67	42	976
Njoftime për shtyp gjyqtari i medias GJ.K.K.O	899	780	693	1440	741	761	2587	2579	1121	913	1056	553	14123
Formulari Elektronik i Aplikimit	139	162	81	90	98	70	63	36	51	56	77	53	976


Grafiku: Numri i aksesimit të faqes kryesore




Grafiku: Numri i aksesimit të Menu-ve kryesore




Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës “Këndi informativ”



Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës “Gjykata e Posaçme”



Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës “Programi i Transparencës”



5. Sistemi kompjuterik për çdo përdorues

Në sistemin kompjuterik në fund të vitin kalendarik 2024, u rinovuan 6 kompjuter të prokuruar nga KLGJ-ja, të cilët u konfiguruan me programet kompjuterike të përshtatshme për punën e përditshme, *Microsoft Windows 10, Paketa Office, Pdf, Sistemi i Gjykatës (ARK IT, i përditësuar), Sistemi FTR, driver printim-i, folder share për skanim dokumentesh, konfigurimi i kufjeve usb dhe kamera usb për trajnime në distancë.*

Gjithashtu në fund të vitin kalendarik 2024 u shtua një storage për përdorim të gjykatës i cili do të konfigurohet në vazhdim të vitit pasardhës për përdorim të kryerjes së procedurave të backup-ve.

6. Sistemi i printim/fotokopjes

Shërbimi i printimit përfshin pajisjet e printimit, fotokopjimit, skanimit dhe OCR. Ky shërbim është kontraktuar nga kompani e jashtme, e cila ofron çdo pajisje, bojë, shërbim fizik etj. Duke qenë se gjatë vitit kalendarik kërkesa për printim si rezultat i ndryshimit të ligjit për njoftimet e vendimeve dhe ndarjes së çështjeve me dosje voluminoze, kërkesa për printim/fotokopjim pati një rritje të paparashikuar, në fund të vitit u realizuan rreth 2 milion kopje, 60% me shumë se vitet e kaluara. Ky shërbim është realizuar nëpërmjet fotokopjeve profesionale dhe printerave. Të gjitha këto pajisje ndërlidhen në sistemin e rrjetit kompjuterik, duke ofruar mundësi që një përdorues të mund të printojë/skanojë informacionin e kërkuar për mbarëvajtjen e punës ditore.

7. Sistemi “camera station” për regjistrimin e pamjeve filmike të sigurisë fizike

Sistemi i sigurisë së kamerave për regjistrimin e pamjeve filmike, përbëhet nga kamera me teknologji të lartë IP, të shpërndara në dy regjistrues NVR. Kjo mundëson zgjatjen e kohës së mbajtjes dhe regjistrimit të të dhënave, sipas vendndodhjes dhe kërkesës së historikut.

Gjatë vitit 2024 u ndërruan HDD-të e njërit nga sistemeve dhe u përditësua versioni i programit si masë parandaluese për mos ndërprerjen e punës, duke qenë se HDD-të ekzistuese kishin me shumë se pesë vjet shkrim të vazhdueshëm. Gjithashtu, u shtuan dy kamera për monitorimin e ambienteve hyrëse të arkivës së gjykatës. Nuk ka pasur problematika të shfaqura nga ky sistem, vetëm kërkesa të ndryshme për ekstraktim informacioni nga institucionet përkatëse.

8. Sistemi i skanimit dhe detektimit të hyrjes së personave të tretë

Ky sistem është instaluar si mjeti i parë i sigurisë fizike, për të mundësuar kontrollin fizik të çdo individi që hyn në mjediset e gjykatës. Gjithashtu kryen regjistrimin e fytyrës/bustit në mënyrë elektronike së bashku me temperaturën e personit hyrës.

9. Sistemi i dhomës teknike

Dhoma teknike “server room” është rinovuar gjatë viteve të fundit duke instaluar dysheme teknologjike, kondicionim të alternuar për server room me ftohje të drejtpërdrejtë në rack, sistem BMS për detektim dhe lajmërim të parametrave të dhomës (*temperaturë, lagështirë, tym, voltazh të rrymës elektrike etj.*)

Gjatë vitit 2024 u krye mirëmbajtje për sistemin e kondicionimit, u ndryshuan filtrat, u zëvendësua një paketë elektronike dhe u rivendos në punë me redundance sistemi.

Gjithashtu u krye një sistemim dhe etiketim i portave të rrjetit në të gjithë godinën duke sistemuar kabllot në patchguide në rak-un e network-ut.

10. Sistemi i mbrojtjes/shuarjes së zjarrit në ndërtesë dhe mjedise të posaçme

Ndërtesa e gjykatës është e pajisur me sistem për mbrojtjen kundër zjarrit qysh nga krijimi i saj. Ky sistem është funksional dhe mirëmbahet nga stafi teknik i ndërtesës. Paralelisht me këtë sistem, funksionojnë edhe 5 (pesë) sisteme të tjera për mbrojtjen dhe shuarjen e zjarrit për mjedise të posaçme të cilat janë: dhoma teknologjike “*server room*”, tre mjediset e arkivës së gjykatës dhe një dhomë për ruajtjen e provave materiale.

Këto sisteme kryejnë mbrojtje kundër tymit, nxehtësisë me sensorët përkatës dhe janë të integruara me sistemin e shuarjes së zjarrit, i përbërë nga gaz inert, i posaçëm për këto mjedise. Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur problematike të evidentuara në këtë sistem.

11. Sistemi i qendërzuar BMS i ndërtesës dhe i mjediseve të posaçme

Sistemi BMS i ndërtesës është i integruar me sistemin ngrohje/ftohje, kaldajë, ndriçim etj. Ky sistem është amortizuar, instaluar në një sistem operativ *Windows XP*, dhe nevojitet të zëvendësohet. Meqenëse është sistem i integruar me mjaft komponentë të përmendur më sipër, është pothuajse e pamundur që sistemet e reja të integrohen me to. Ndaj vazhdon të mirëmbahet nga stafi teknik.

Duke qenë se ky sistem është jetik për mbarëvajtjen e godinës, gjatë vitit 2024 u prokurua projektimi i një sistemi të ri i cili do të kërkohet të realizohet vitin pasardhës.

Nga ana tjetër, të dhënat elektronike kanë përparësi të veçantë në “server room, rrjedhimisht është instaluar një sistem i veçuar BMS sikurse është përmendur tek paragrafi paraardhës, i cili ofron mjaft informacione të detajuara në monitorim dhe raportim në kohë reale.

12. Sistemi i telefonisë

Sistemi i telefonisë së gjykatës, është funksional dhe përbëhet nga një sistem i përzier i cili ofron si linja hyrëse *analoge, digjitale*, ashtu edhe hyrje nga *operator mobile*, por jo vetëm, pasi ofron edhe protokoll *interneti SIP*.

Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur problematike të evidentuara në këtë sistem.

13. Sistemi i aksesimit të sigurt në mjediset e ndërtesës

Në mjediset e ndërtesës së Gjykatës së Posaçme si dhe në mjediset e përbashkëta me institucionet e tjera është i instaluar sistem i kartave të aksesit, ku çdo përdorues i pajisur me kartën e vetë identifikuese, në varësi të rolit të tij, mund të aksesojë hyrje/daljet e autorizuara.

Pjesë integrale e këtij sistemi është edhe leximi i targave të automjeteve dhe hapja në mënyrë automatike e traut hyrës/dalës në parkimin e bodrumit të institucionit.

Gjatë vitit 2024, u përditësuan firmware-t e të gjitha pajisjeve të leximit të kartave.

Gjatë mirëmbajtjes se sistemit u krye edhe zëvendësimi i baterive të moduleve të kartave të cilat realizojnë hapjen dhe mbylljen e dyerve edhe në mungesë totale të energjisë elektrike.

14. Ndërlidhja me internet

Sikurse gjatë vitit 2023, edhe për vitin 2024 ndërlidhja në internet është realizuar nga shërbimi i qendërzuar i KLGJ-së. Problematikat me ndërlidhje kanë qenë sporadike, kryesisht në shkëputjen e ofrimit të shërbimit të DNS-së nga ISP, e cila e ka të kufizuar vetëm në përdorimin e serverëve të vet dhe jo ato open source.

Marrëdhëniet me Publikun, Median dhe me Jashtë

Gjatë vitit 2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vijuar angazhimin e saj për të garantuar transparencë dhe komunikim efektiv me publikun, median dhe organizatat e interesuara. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë masa konkrete për të përmirësuar qasjen ndaj informacionit dhe për të siguruar një komunikim të strukturuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe Vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të KLGJ-së “*Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median*”.

Në zbatim të detyrimeve ligjore, GJKKO ka përditësuar në mënyrë të vazhdueshme Programin e Transparencës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, duke synuar ndërtimin e marrëdhënieve aktive dhe të qëndrueshme me publikun dhe median.

Gjykata ka vijuar gjithashtu zbatimin e Planit Dyvjeçar të Komunikimit për periudhën 2022-2024, duke u fokusuar në modernizimin e strategjive të komunikimit dhe rritjen e transparencës institucionale. Specialisti për marrëdhëniet me publikun, median dhe me jashtë, nën udhëzimin dhe mbikëqyrjen e Gjyqtarit për Median ka përgatitur dhe dërguar në KLGJ raportin 3 (tre) mujor mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Komunikimit. Ky raport tremujor plotësohet në formën tabelore sipas aktiviteteve të planit të zbatimit dhe ka për qëllim të raportojë dhe vlerësojë progresin e zbatimit.


Sipas Planit të Komunikimit, një nga synimet kryesore për përmirësimin e transparencës dhe intesifikimin e marrëdhënieve me publikun ka qenë vendosja e një strategjie të mirëfilltë dhe efektive komunikimi. Ky objektiv ka synuar jo vetëm garantimin e aksesit të gjerë në informacion për qytetarët dhe mediat, por edhe krijimin e një procesi komunikimi të qëndrueshëm dhe të qartë.

Kërkuesi	Numri i kërkesave
Gazetarë	31
Organizata të Shoqërisë Civile	5
Gjyqtarë, Prokurorë & Avokatë	3
Qytetar	1
Totali	40

Në përmbushje të këtij objektivi, me kërkesë të Gjyqtarit për Median, në mënyrë periodike janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e mediave dhe gazetarët që mbulojnë fushën e drejtësisë, me qëllim zhvillimin e diskutimeve mbi çështje të ndryshme që lidhen me të drejtën e informimit.

Specialisti për marrëdhëniet me publikun dhe median tashmë punon ngushtësisht me Gjyqtarin për Median, duke marrë udhëzime mbi mënyrën e komunikimit me median dhe publikun, formatin e njoftimeve që publikohen, si dhe mënyrën dhe formën e trajtimit të kërkesave për informacion, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Në vitin 2024 janë regjistruar 40 (dyzet) kërkesa për informacion, nga të cilat 31 (tridhjetë e një) kërkesa janë paraqitur nga gazetarët, 5 (pesë) kërkesa nga organizata të shoqërisë civile, 3 (tre) kërkesa janë paraqitur nga gjyqtarë, prokurorë dhe avokat dhe 1 (një) kërkesë është paraqitur nga një qytetar. Këto kërkesa janë trajtuar nga Specialisti për marrëdhëniet me publikun, median dhe me jashtë, nën udhëzimin dhe mbikëqyrjen e Gjyqtarit për Median, në kohë optimale dhe gjithmonë brenda afatit të parashikuara nga neni 15 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.⁵⁶



Nga kërkesat për informacion të sipërcituara: 28 (njëzet e tetë) kërkesa kanë marrë përgjigje të plotë, 4 (katër) kërkesa kanë marrë përgjigje të pjesshme, 5 (pesë) kërkesa janë refuzuar, 1 (një) kërkesë është dërguar e plotë për trajtim tek autoriteti kompetent, ndërsa 2 (dy) kërkesa të tjera janë trajtuar pjesërisht nga GJKKO dhe pjesërisht u janë dërguar autoriteteve tjera kompetente. Për 2 (dy) kërkesat, të cilat janë deleguar pjesërisht për t’u trajtuar në autoritetet kompetente të tjera, për pjesën që ju është dhënë informacion nga GJKKO, përgjigja është dhënë e plotë.

⁵⁶ Neni 15, pika 1 e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën për informim", i ndryshuar, parashikon se: "Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe".

Për kërkesat për informacion të cilat janë refuzuar apo ju është dhënë përgjigje e pjesshme, refuzimi apo dhënia e pjesshme e përgjigjes është mbështetur në nenin 17, pika 2, germa “b” të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën për informim", i ndryshuar (parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale), ose në nenin 332/b pika 1, Kreu IX “Seanca paraprahe” të K.Pr.Penale (zhvillimi i seancës me dyer të mbyllura) dhe nenin 103 pika 3 të K.Pr.Penale (ndalimin e publikimit kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura).


Në një shtet ligjor, transparencja dhe aksesimi i informacionit janë elemente thelbësorë për mirëfunksionimin e institucioneve dhe për ndërtimin e besimit të qytetarëve tek drejtësia. Në këtë kontekst, komunikimi i gjykatës me median luan një rol të pazëvendësueshëm, pasi mediat janë mjeti kryesor për të informuar publikun mbi çështjet gjyqësore. Një komunikim i qartë, i rregullt dhe i strukturuar midis gjykatës dhe mediave ndihmon në transmetimin e informacionit të saktë, duke parandaluar keqinformimin dhe krijimin e perceptimeve të gabuara mbi drejtësinë.

Gjykata vijon angazhimin për transparencë dhe komunikim të hapur me publikun dhe median. Gjatë këtij viti është intensifikuar puna në drejtim të rritjes së transparencës përkundrejt mediave dhe publikut sidomos përmes faqes së re zyrtare, gjykata.gov.al, ku janë publikuar të plotë një pjesë e vendimeve të themelit të dhëna nga gjykata për vitin 2024, në zbatim të “Udhëzuesit Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median”, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023, të KLGj-së. Në vijim do të publikohen të plotë të gjitha vendimet e themelit të dhëna nga GJKKO që prej vitit 2020, duke u bërë të aksesueshme për publikun dhe median.

Po ashtu, janë përmirësuar mekanizmat e shpërndarjes së informacionit, përfshirë publikimin në kohë reale, në faqen zyrtare të Gjykatës, në rubrikën “Njoftime për mediat” të të gjitha njoftimeve mbi vendimet e shpallura dhe krijimin e një grupi të dedikuar komunikimi në rrjetin social “WhatsApp”, për të informuar median mbi zhvillimet më të fundit, duke përfshirë këtu jo vetëm njoftimet mbi dosjet penale të shpallura gjatë ditës, por edhe njoftime të tjera mbi çështjet të cilat paraqesin interes të lartë për publikun. Këto hapa kanë rritur ndjeshëm efikasitetin e komunikimit dhe kanë lehtësuar aksesin e gazetarëve në të dhëna të rëndësishme gjyqësore.

Më konkretisht, në grupin e komunikimit me mediat në Whatsapp janë dërguar në kohë reale 231 (dyqind e tridhjetë e një) njoftime, të cilat janë publikuar edhe në faqen zyrtare elektronike të gjykatës, sipas tabelës më poshtë:

Njoftime				
Viti kalendarik 2024	Mbi vendime dhe kërkesa penale të shpallura	Për informimin mbi ndalimin e publikimit të vendimit	Për datë seancë gjyqësore	Mbi respektimin e udhëzuesit standard për Marrëdhëniet të Gjykatave me mediat
Janar	6	-	-	-
Shkurt	9	-	-	-
Mars	5	-	1	-
Prill	2	-	-	-
Maj	15	1	-	-
Qershor	35	-	-	-
Korrik	38	-	1	-
Gusht	4	-	-	-
Shtator	12	-	-	-
Tetor	35	-	-	1
Nëntor	34	-	1	-
Dhjetor	31	-	-	-
Totali	226	1	3	1



GJKKO ka vijuar të mbajë dhe të forcojë komunikimin e rregullt dhe bashkëpunimin me të gjitha palët e interesuara, përfshirë organizatat vendase dhe ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri. Në përmbushje të detyrimeve ligjore, veçanërisht në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin procedural penal, Gjykata ka siguruar transparencën e duhur duke vënë në dispozicion informacionet dhe dokumentet e kërkuara nga institucionet e ndryshme, organizatat e shoqërisë civile, partnerët ndërkombëtarë dhe aktorët e tjerë të përfshirë në sistemin e drejtësisë.

Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat vlerëson bashkëpunimin dhe koordinimin me Gjyqtarin për Median, trupën gjyqësore të kësaj gjykate, si edhe sekretaret gjyqësore. Ky bashkëpunim i ngushtë ka sjellë përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të transparencës, lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe rritjen e aksesit të publikut dhe mediave në vendimet dhe veprimtarinë e Gjykatës.

Rëndësia e komunikimit për punën e Gjykatës është shumëdimensionale dhe përfshin një sërë aspektesh kyçe, të cilat synojnë të garantojnë informimin e vazhdueshëm të qytetarëve dhe të grupeve të interesit mbi veprimtarinë gjyqësore dhe funksionimin institucional. Në këtë drejtim, komunikimi me publikun dhe median është përqendruar në disa fusha kryesore:

- Informimi i vazhdueshëm dhe i plotë i publikut dhe mediave. Gjykata siguron që informacioni mbi çështjet gjyqësore që shqyrtohen në këtë gjykatë, si dhe mbi aktivitetet institucionale, të shpërndahet në mënyrë të saktë, të shpejtë dhe të kuptueshme për të gjithë aktorët e interesuar. Ky angazhim është reflektuar në publikimin e njoftimeve dhe të dhënave përkatëse për çdo çështje gjyqësore që po shqyrtohet pranë kësaj gjykate, në faqen zyrtare të Gjykatës, duke lehtësuar aksesin e publikut në të dhëna të sakta dhe të verifikuara.
- Përdorimi i teknologjive të reja informative dhe platformave të komunikimit. Në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, Gjykata ka avancuar në përdorimin e mjeteve moderne të komunikimit, përfshirë rrjetet sociale, për të siguruar një qasje më të shpejtë dhe më të drejtpërdrejtë me publikun dhe mediat.
- Përcaktimi dhe adresimi i audiencës së synuar për secilin lloj të komunikimit. Në funksion të rritjes së efektivitetit të komunikimit, Gjykata ka vijuar të zbatojë një qasje të diferencuar për secilin grup të audiencës së saj, duke përshtatur format dhe përmbajtjen e informacionit në përputhje me nevojat dhe interesat e çdo kategorie, të tilla si gazetarë, publik i gjerë, grupe të caktuara profesionale etj.

Përveç këtyre aspekteve, Gjykata ka forcuar edhe mekanizmat për marrjen dhe përpunimin e feedback-ut nga publiku dhe mediat, duke krijuar një proces të vazhdueshëm reflektimi dhe përmirësimi të strategjisë së komunikimit.

Në tërësi, gjatë këtij viti, përmes një strategjie të qartë dhe të mirëstrukturuar të komunikimit, GJKKO ka rritur ndjeshëm transparencën dhe ka garantuar informimin e vazhdueshëm të publikut dhe mediave mbi veprimtarinë e saj.

Në vijim, Gjykata do të vijojë të forcojë këtë strategji komunikimi, duke thelluar bashkëpunimin me median, zgjeruar përdorimin e platformave digjitale dhe garantuar informimin e vazhdueshëm të publikut mbi veprimtarinë dhe vendimet e saj, në funksion të një transparence më të lartë dhe të ndërtimit të besimit të qytetarëve tek drejtësia.

5. SEKTORI I PROTOKOLL/ARKIVËS

Me vendimin nr.7, datë 13.06.2024, Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vlerësoi se sektori i Protokoll-Arkivit është sektor i rëndësishëm për mirëfunksionimin dhe performancën e gjykatës duke krijuar pozicionin e ri të punës “Specialist protokollit” si pjesë e strukturës organike, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Objektivat e këtij sektori, për vitin 2024 u realizuan me efikasitet dhe përgjegjshmëri, jo vetëm drejt përmirësimit në dhënien e shërbimit duke respektuar afatet ligjore, përfshirë edhe shërbimin cilësor të dokumenteve arkivore në një kohë të shpejtë.

Ecuria e punës në këtë sektor është përmbushur sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si: ”Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 për "Arkivat", i ndryshuar, të "Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike" si dhe Vendimit nr.4, datë 19.06.2017 për miratimin e "Rregullores së Njësuar të Punës me dokumentet në Autoritetet Publike të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Lartë të Arkivave si dhe Vendimit Nr. 7, datë 13.06.2024 të Këshillit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Krahasuar me vitin 2023, këtë vit rezultoi se janë dhënë për shfrytëzim/shërbim një numër i konsiderueshëm i dokumenteve gjyqësor arkivore të njësuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, referuar kërkesave drejtuar gjykatës. Për nevoja të gjykimit, në disa raste janë vendosur në dispozicion të gjyqtarëve dosje gjyqësore të arkivuara, si dhe bazuar në legjitimitetin e palëve janë shërbyer kopje e akteve gjyqësore për personat e interesuar, avokatët dhe institucionet e tjera, të cilat janë evidentuar në mënyrë manuale me shkrim në regjistrin e dhënies dhe marrjes së dokumenteve nga vend-ruajtja përgjatë vitit 2024.

Një nga përparësitë e punës në këtë sektor ka qenë lirimi i hapësirave të ambienteve të Arkivit të GJKKO-së, edhe për këtë vit u morën masat e nevojshme që të merren punonjës mbështetës me kontratë të përkohshme të cilët ofrojnë ndihmesën e tyre për përpunimin tekniko-shkencor dhe inventarizimin e dosjeve gjyqësore të fondit arkivor të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Një nga arritjet e sektorit është se, për herë të parë në bashkëpunim me Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, kjo gjykatë dorëzoi fondin arkivor të dosjeve gjyqësore të themelit për periudhën **2004-2007**, duke mbyllur me sukses një nga proceset më të vështira të punës me përkushtim dhe profesionalizëm.

Në kuadër të krijimit të hapësirave, pas diskutimeve me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Gjykatën e Lartë u morën masa për lirimin e sallave në ambientet e GJKKO-së të cilat ishin

të zëna prej 5 vitesh me dosjet arkivore të Gjykatës së Lartë. Për të garantuar mbarrëvajtjen e veprimtarisë së arkivit të gjykatës, me Urdhrin nr.328, datë 03.10.2024, të Kancelarit të gjykatës, u ngrit grupi i punës për zhvendosjen e dosjeve gjyqësore në sallat e reja arkivore.

Gjatë këtij viti janë përgatitur vëllimet penale për vitet 2012-2022 sipas çdo njësie dosje, jo vetëm duke i hedhur në mënyrë kronologjike në inventarë elektronikë por edhe duke i sistemuar në kuti arkivore. Nga ana e specialistit të arkivës është krijuar edhe regjistri elektronik i këtyre vendimeve në të cilin do të evidentohen afatet e asgjësimit të dosjeve gjyqësore.

Një bashkëpunim të frytshëm sektori i Protokoll-Arkivit ka pasur me Këshillin e Lartë Gjyqësor, specialisti i arkivës si pjesë e grupit të punës të krijuar nga KLGJ, në cilësinë e ekspertit të punës me dokumentet arkivor ka sqaruar mendimin tonë në lidhje me evidentimin dhe përpunimin tekniko-shkencor për dosjet gjyqësore sipas aneksit nr.7 që i përket Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Me përfundimin e procesit të skanimit të vendimeve penale për vitet 2004-2022 sipas projektit për digjitalizimin e arkivës së gjykatës, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor u bë trajnimi i Shefes se Sektorit dhe Specialistit të Arkivit, mbi mënyrën e përdorimit të Sistemit të Arkivit Digjital si dhe pajisjen me kredencialet personale për aksesimin e programit (software) digjital arkivor.



Vlen të theksohet fakti se nga inspektimi i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, raporti për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka qenë pozitiv duke vlerësuar:

- Zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore arkivore për ruajtjen, administrimin, përpunimin, inventarizimin, transferimin dhe dorëzimin e njësive të ruajtjes tipologjike të dosjeve gjyqësore.
- Evidentimin e dokumentacionit arkivor që ka plotësuar afatin ligjor për shfrytëzim.
- Mënyrën e ruajtjes dhe kushtet e sigurisë të njësisë të ruajtjes tipologjike të dosjeve gjyqësore.

Risi për këtë vit ka qenë zbatimi i kartelës shoqëruese, e cila edhe pse ishte miratuar më herët, zbatimi i saj filloi pas emërimit në detyrë të gjyqtarit Erjon Bani, si Zv/Kryetar i Gjykatës. Përdorimi i kartelës shoqëruese solli rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë, pasi në të specifikohen afatet e zbatimit të shkresës, nga momenti i siglimit nga titullari deri në momentin e dhënies së zgjidhjes nga sektorët përkatës. Urdhërat e miratuar nga ana e Kryetarit të Gjykatës dalë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave “Për njësimin e dokumenteve në Republikën e Shqipërisë” janë respektuar me përpikmëri si gjatë kohës së ushtrimit të detyrave të sekretarisë ashtu edhe atyre të arkivit.

Më poshtë gjeni të dhëna krahasimore me grafik, të cilat pasqyrojnë ecurinë e sektorit të Protokoll-Arkivit.

Llojet e akteve / Viti	2023	2024	~ # në %
Nr. Korrespondencës	3675	4689	28%
Urdhëra Administrativ	441	477	8%
Vendime të Kryetarit	68	131	93%
Vendime të Këshillit të Gjykatës	23	18	-22%



III. AKTIVITETE BRENDA DHE JASHTË VENDIT
Vizitë e gjyqtarëve të GJKKO pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri - 14 Shkurt 2024.



Me datë 14 Shkurt 2024, disa prej gjyqtarëve të GJKKO-së zhvilluan një vizitë pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Takimi u zhvillua në kuadër të rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbështetjes së vazhdueshme që SHBA ofron për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Gjatë këtij takimi, gjyqtarët e pranishëm vlerësuan mbështetjen e palëkundur të Shteteve të Bashkuara, përkundrejt shtetit shqiptar, në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe terrorizmit. U nënvizua gjithashtu rëndësia e bashkëpunimit për rritjen e transparencës dhe efektivitetit të sistemit gjyqësor shqiptar, me qëllim garantimin e dhënies së drejtësisë për të gjithë qytetarët.

Gjyqtarët e pranishëm falenderuan Ambasadën e SHBA-së për mbështetjen e vazhdueshme që ofron në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe konsolidimit të pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të GJKKO në takimin e 15-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian –Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”

Në datat 20 dhe 21 mars 2024, GJKKO e përfaqësuar nga Kancelari dhe Kryesekretarja e gjykatës, mori pjesë në takimin e 15-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, i zhvilluar në Bruksel, Belgjikë. Ky takim kishte për qëllim vlerësimin e progresit të institucioneve shqiptare në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për vitet 2022 dhe 2023, në fushat e drejtësisë, luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar, të drejtave të njeriut, azilit dhe sigurisë.

Në këtë takim Kancelari dhe Kryesekretarja prezantuan raportin për veprimtarinë e institucionit për periudhën Janar 2023 – Shkurt 2024. Raporti u përgatit sipas formatit të përcaktuar nga autoritetet përkatëse dhe përfshinte të dhëna statistikore, informacione mbi ecurinë e çështjeve të trajtuara, si dhe masat institucionale të ndërmarra për përmbushjen e objektivave në kuadër të integritetit evropian.



Vizitë e delegacionit Britanik në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 28 Maj 2024



Më datë 28 maj 2024, GJKKO pati nderin të mirëpresë një delegacion të nivelit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar, në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve gjyqësore të dy vendeve dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e drejtësisë.

Pjesë e delegacionit ishin personalitete të sistemit gjyqësor britanik: Lord Justice Dingemans, gjyqtar i Gjykatës së Apelit në Britani dhe ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Mbretërisë së Bashkuar; Gjyqtari Martin Picton, drejtor i Trajnimit Ndërkombëtar për Kolegjin Gjyqësor; znj. Victoria James, përfaqësuese e Zyrës Gjyqësore; si dhe Sh.T.Z. Alastair King-Smith, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri.

Gjyqtarët e GJKKO-së i shprehën mirënjohje delegacionit britanik për këtë vizitë domethënëse dhe vlerësuan interesimin e delegacionit për funksionimin e kësaj gjykate. Gjatë takimit u paraqit një panoramë e shkurtër e kompetencave, funksionimit dhe

veprimtarisë së GJKKO-së, duke vënë theksin tek rëndësia strategjike e programeve të bashkëpunimit dypalësh, si nisma “Partneritet për Edukimin Gjyqësor në fushën e drejtësisë”.

Në vijim të bashkëbisedimit, palët zhvilluan një dialog të hapur mbi prioritetet, nevojat dhe sfidat ku mund të fokusohet ky bashkëpunim, me synimin për të ndërtuar ura më të forta bashkëpunimi institucional. U vlerësua rëndësia e shkëmbimit të përvojave mbi praktikën gjyqësore, si dhe mundësitë për organizimin e vizitave studimore dhe trajnimeve të specializuara për gjyqtarët e GJKKO-së.

Delegacioni britanik shprehu angazhimin për të mbështetur Gjykatën e Posaçme, veçanërisht në drejtim të ofrimit të ekspertizës teknike për veprimtarinë e rëndësishme pranë GJKKO-së, duke theksuar gatishmërinë për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe organizative të gjykatës.

Takim informues me gazetarët dhe përfaqësuesit e mediave – GJKKO, 3 Qershor 2024



Në kuadër të zbatimit të “Udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”⁵⁷, miratuar me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 3 qershor 2024, në ambientet e GJKKO, u zhvillua një takim informues me gazetarët e akredituar pranë kësaj gjykate.

Takimi u drejtua nga Zv/Kryetari i Gjykatës, i cili ushtron njëkohësisht funksionin e Gjyqtarit për Median pranë GJKKO-së. Gjatë aktivitetit, u prezantua roli thelbësor i medias në pasqyrimin korrekt dhe objektiv të proceseve gjyqësore, duke u theksuar rëndësia e respektimit të standardeve ligjore dhe etike në raportimin për opinionin publik. Zv/Kryetari paraqiti shembuj konkretë nga praktika, duke ilustruar mënyrat e zhvillimit të një komunikimi efektiv me median, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzuesin e miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Diskutimi u fokusua gjithashtu te çështjet praktike të koordinimit ndërmjet institucionit dhe përfaqësuesve të mediave, me qëllim garantimin e transparencës dhe respektimit të të drejtës së publikut për informim. U trajtuan teknika për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë etike dhe profesionale gjatë raportimit të veprimtarisë së gjykatës.

Ky takim shënoi një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të marrëdhënieve të qëndrueshme me median, si pjesë e angazhimit të gjykatës për të ndërtuar një komunikim të hapur dhe transparent me publikun. Në vijimësi, GJKKO ka vijuar me organizimin e takimeve periodike me gazetarët dhe përfaqësuesit e mediave, duke forcuar bashkëpunimin për pasqyrimin objektiv të veprimtarisë gjyqësore dhe për garantimin e së drejtës për informim, si një element kyç i shtetit të së drejtës.

Vizitë e delegacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në GJKKO – Korrik 2024

Në korrik 2024, GJKKO mirëpriti një delegacion të nivelit të lartë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i përbërë nga gjyqtarë dhe një prokuror federal. Vizita u zhvillua në kuadër të mbështetjes së pandërprerë që SHBA ofron për institucionet e drejtësisë në Shqipëri, me fokus të veçantë tek Gjykatat e Posaçme, duke synuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në trajtimin e çështjeve penale që lidhen me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Gjatë takimit, u zhvillua një diskutim konstruktiv mbi fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit, rëndësinë e garantimit të transparencës në proceset gjyqësore dhe rritjen e efektivitetit në trajtimin e çështjeve penale. Delegacioni vlerësoi përkushtimin e GJKKO-së në përmbushjen

⁵⁷ Në nenin 1, të Kapitullit I të “Udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, parashikohet se: “1. Udhëzuesi standard për marrëdhëniet e gjykatës me publikun e median përcakton rregullat dhe procedurat e informimit dhe komunikimit me publikun dhe median, me ose pa interesimin e tyre të drejtpërdrejtë, me qëllim përcjelljen e informacionit mbi veprimtarinë e gjykatës në mënyrë të drejtë, uniforme, të barabartë, të shpejtë dhe efikase. 2. Udhëzuesi synon rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore, nëpërmjet standardizimit të marrëdhënieve të gjykatës me publikun dhe median”.

e misionit të saj dhe shprehu gatishmërinë për të ofruar mbështetje të mëtejshme përmes shkëmbimeve profesionale dhe asistencës teknike



Vizitë studimore e organizuar nga OPDAT, me gjyqtarë dhe prokurorë në Distriktet Utah dhe Kolorado të SHBA-së, Shtator 2024



Nga data 21 deri më 28 shtator 2024, delegacioni i GJKKO-së, i përbërë nga 9 (nëntë) gjyqtarë dhe specialistja e Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, patën nderin dhe kënaqësinë që të merrnin pjesë në një vizitë studimore të organizuar nga OPDAT, dhe financuar nga INL (Byroja Ndërkombëtare për Narkotikët dhe Çështjet e Zbatimit të Ligjit),

në Denver, Kolorado dhe në Salt Lake City, Utah, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qëllimi i vizitës ishte njohja me sistemin amerikan të drejtësisë dhe shkëmbimi i përvojave me gjyqtarë dhe prokurorë mbi çështje të rëndësishme si pavarësia e gjyqësorit, korrupsioni i zyrtarëve të lartë, krimin e organizuar, etj.

Gjatë pesë ditëve të vizitës, gjyqtarët e GJKKO patën mundësinë të vëzhgojnë zhvillimin e seancave gjyqësore në Gjykatën Federale të Rrethit dhe Gjykatën e Apelit të Qarkut të Dhjetë, në Denver, Kolorado, si dhe në Gjykatën e Rrethit dhe në Gjykatën Supreme të Utah, me gjyqtarët e të cilave u zhvilluan diskutime mbi tema si: administrimi i çështjeve gjyqësore; pavarësia e gjyqësorit; korrupsioni i zyrtarëve të lartë; mbrojtja që ju ofrohet gjyqtarëve në raste kërcënimesh; impakti që ka pasur procesi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vendin tonë; zhvillimin e teknologjisë në drejtim të ruajtjes së të gjithë dokumentacionit të dosjeve gjyqësore që shqyrtohen në një gjykatë; ndikimi që ka media në çështjet që paraqesin interes publik, raporti ndërmjet gjykatës dhe mediave dhe sulmet personale përkundrejt gjyqtarëve.



Gjatë kësaj vizite, gjithashtu, u zhvilluan takime edhe me prokurorë të Departamentit të Drejtësisë, në Denver, Kolorado dhe prokurorë të Zyrës së Prokurorit të SHBA në Salt Lake City, Utah, ku në formë bashkëbisedimi, gjyqtarë dhe prokurorë shkëmbyen eksperiencat dhe mendimet e tyre për terrorizmin në nivel ndërkombëtar, krimin e organizuar në prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike (kartelet), mashtrimet financiare dhe skemat piramidale, korrupsioni publik (jakat e bardha), kërkesat për ndihmë juridike të ardhur nga shtete të ndryshme, sekuestrimin e aseteve të krijuara nga veprimtari kriminale, problematikat që hasen me palët e treta, të cilat përdoren për pastrimin e parave të përftuara nga veprimtari kriminale, identifikimin dhe kapjen e transaksioneve të jashtëligjshme të parave, që kryhen në platformat online, krimin kibernetik, etj.

Në përfundim të vizitës, gjyqtarët e GJKKO-së shprehën falënderime dhe mirënjohjen e tyre të sinqertë për përfaqësuesit e OPDAT-it, nën drejtimin e Z. David Backman, dhe INL, të cilët bënë të mundur organizimin e kësaj vizite studimore në SHBA, si dhe për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Distrikteve Kolorado dhe Utah, pjesëmarrës në këtë aktivitet, duke e vlerësuar këtë përvojë si një kontribut të çmuar në karrierën e tyre profesionale.

Takim me të Ngarkuarën me Punë të SHBA-së në Shqipëri, Znj. Nancy VanHorn – datë 13.12.2024.



Me datë 13.12.2024, Zv/Kryetari i Gjykatës, Z. Erjon Bani, zhvilloi një takim me të Ngarkuarën me Punë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Znj. Nancy VanHorn, në ambientet e gjykatës. Takimi kishte për qëllim riafirmimin e mbështetjes së plotë të Shteteve të Bashkuara ndaj Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe theksimin e rëndësisë së bashkëpunimit të vazhdueshëm për forcimin e drejtësisë. Gjatë takimit, u vlerësua roli i Gjykatës së Posaçme në drejtim të garantimit të një sistemi drejtësie të pavarur, të paanshëm dhe të qëndrueshëm, si dhe në rëndësinë e fitimit të besimit të publikut në institucionet e drejtësisë. Diskutimi gjithashtu u përqendrua në identifikimin e mënyrave dhe formave konkrete për të forcuar më tej bashkëpunimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me synim ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit në dhënien e drejtësisë.

VI. OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME

➤ Objektiva

Analiza vjetore e punës për vitin 2024 e GJKKO-së është një mënyrë efikase për të evidentuar veprimtarinë e kryer nga institucioni gjatë këtij viti, për të reflektuar progresin e kryer, mangësitë e konstatuara dhe mundësitë për të bërë përmirësime. Në këtë analizë gjen vend edhe përcaktimi i objektivave respektive për të ardhmen, me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës së gjithë secilit në funksion të ofrimit të shërbimeve dhe dhënies së drejtësisë.

Objektivat e GJKKO-së konsistojnë në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme dhe imediate me qëllim rritjen e performancës së këtij institucioni. Nëpërmjet tyre synohet në rritjen e kapaciteteve dhe efijencës në punë të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në dhënien e drejtësisë, si dhe ngritjen e standardeve aktuale drejt atyre evropiane.

Gjatë vitit të ardhshëm, GJKKO ka si synim, të marrë masa efektive në disa drejtime:

- Rritjen e cilësisë dhe profesionalizmit në funksion të dhënies së drejtësisë, si dhe shërbimeve gjyqësore në tërësi të ofruara pranë GJKKO-së;
- Rritjen e efektivitetit dhe efijencës së proceseve gjyqësore;
- Ofrimi i një shërbimi cilësor në të gjitha aspektet, me synim rritjen e besueshmërisë së publikut në procesin e dhënies së drejtësisë;
- Rritjen e aksesit të publikut dhe medias në gjykatë, nëpërmjet një procesi proaktiv;
- Ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e transparencës ndaj veprimtarisë së GJKKO-së, duke synuar njëkohësisht mbrojtjen e të dhënave personale të palëve në proces, në zbatim të legjislacionit përkatës;
- Forcimin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë në fushën e drejtësisë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare;
- Kryerjen e përmirësimeve të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore;
- Shtimin e burimeve njerëzore të gjykatës, si dhe trajnimin e tyre fillestar dhe vazhdues, me qëllim rritjen e cilësisë dhe performancës së shërbimeve të ofruara.

Objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm janë:

- Plotësimi në një kohë sa më të shpejtë i vakancave të gjyqtarëve në organikën e gjykatës, me qëllim shpërndarjen e barabartë të ngarkesës së çështjeve gjyqësore, që kanë gjyqtarët aktualë;
- Shtimi në një kohë sa më të shpejtë i organikës së administratës gjyqësore të GJKKO-së me punonjës të rinj sipas propozimit të Këshillit të Gjykatës.
- Përpunimi i dosjeve gjyqësore për ruajtje të përhershme/përkohshme, proces i cili do të vijojë të realizohet në bashkëpunim me KLGJ-në dhe Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor;

- Ngritja e platformës për komunikimet elektronike, në bashkëpunim me KLGJ dhe KE;
- Rritja e komunikimit me aktorët e tjerë në fushën e drejtësisë.
- Rritja e aksesit të publikut dhe medias në gjykatë;
- Monitorimi i vazhdueshëm mbi zbatimin e marrëveshjes me Postën Shqiptare sh.a., për sa i përket cilësisë dhe shpejtësisë së kryerjes së shërbimit të dorëzimit të dokumentacionit gjyqësor;
- Kryerja e trajnimeve për administratën gjyqësore e sidomos për sekretarinë gjyqësore në drejtim të përmirësimit të aftësive kompjuterike, etikës së komunikimit me publikun dhe zbatimit të ndryshimeve të reja ligjore, etj.
- Monitorimi i zbatimit të rregullave të funksionimit të teknologjisë së informacionit në gjykatë.

Për arritjen e këtyre objektivave rekomandojmë:

1. Rritja e bashkëpunimit të GJKKO-së me KLGJ-në për plotësimin sa më të shpejtë të pozicioneve vakante për gjyqtarë sipas organikës së GJKKO-së;
2. Rritja e bashkëpunimit me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, lidhur me çështje të trajnimit të administratës gjyqësore dhe çështje të tjera;
3. Angazhim i punonjësve të trajnuar dhe eksperteve të jashtëm për ato çështje ku vlerësohet e nevojshme;
4. Ngritje e grupeve të monitorimit për secilën nga objektivat dhe raportim mujor mbi ecurinë e tyre nga grupet e punës përpara Këshillit të Gjykatës;
5. Monitorim periodik nga Këshilli i Gjykatës në lidhje me objektivat e caktuara dhe ndjekjen e ecurisë të secilës prej objektivave;
6. Paraqitjen e raporteve periodike KLGJ-së, si dhe kërkesa kësaj të fundit në lidhje me problematikat që kërkojnë ndërhyrjen e KLGJ-së për zgjidhjen e situatave.

Në përfundim, duke përfutuar nga rasti, shprehim falenderime për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, si dhe gjithë stafin e gjykatës, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur përmbylljen e suksesshme të vitit 2024.

Falenderime të mëtejshme i takojnë edhe KLGJ-së për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe ndihmesën e dhënë prej saj në zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë kësaj periudhe, duke bërë të mundur, rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në punë të gjykatës sonë.

Gjykata e Posaçme e Shkallës Së Parë
për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar



WWW.GJP.GOV.AL